

LIGJI Nr. 05/L-088**PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor, kushtet bazë që duhet t'i plotësojnë rrugët nga aspekti i sigurisë rrugore, sistemin e sinjalizimit të trafikut rrugor, shenjat që i japin personat e autorizuar zyrtarë, detyrat në rast aksidenti në trafikun rrugor, kushtet për drejtim të mjetit, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen t'i kenë mjetet, dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkesën boshtore të mjetit, si edhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojë mjete në trafikun rrugor.

2. Ky ligj transponon pjesërisht Direktivën 2014/37/EU të datës 27.2.2014, e cila e amendamenton Direktivën e Këshillit 91/671/EEC në lidhje me përdorimin e detyrueshëm të rripave të sigurisë dhe sistemin e sigurisë për fëmijët në veturë, Direktivën 2014/47/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 3.4.2014 mbi inspektimet teknike në rrugë të automjeteve komerciale që qarkullojnë dhe e shfuqizon Direktivën 2000/30EEC, Direktivën 91/671/EEC të datës 16.12.1991 për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me përdorimin e detyrueshëm të rripave të sigurisë për automjete neni 3.5 T.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

1 Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, për subjektet e autorizuar dhe për pjesëmarrësit në trafik.

2 Institucionet shtetërore, njësitë qendrore dhe lokale të qeverisjes, personat fizikë dhe juridikë, si dhe pjesëmarrësit në trafik, janë të obliguar që, duke vepruar sipas dispozitave të këtij ligji, ta kenë parasysh sigurinë, ta zhvillojnë solidaritetin, humanitetin dhe marrëdhëniet etike ndërmjet pjesëmarrësve në trafik, ta mbrojnë shëndetin dhe jetën e personave të tjerë, në veçanti të fëmijëve, të personave me invaliditet, të moshuarve dhe të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të përkujdesen për mbrojtje të ambientit.

3 Ministria e Arsimit është e obliguar të zhvillojë programe edukativo-arsimore që kanë për qëllim aftësimin për pjesëmarrje të sigurt në trafik, si dhe ngritjen dhe zhvillimin e nivelit të kulturës së trafikut, dhe atë duke filluar nga institucionet parashkollore, e duke vazhduar me të gjitha grupmoshat, varësisht prej nivelit të tyre psikofizik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1.1. **Agim** – drita e parë e mëngjesit para lindjes së diellit;

1.2. **Aksident trafiku** – ngjarje në rrugë në të cilën merr pjesë së paku një mjet në lëvizje, në të cilin si pasojë një apo më shumë persona kanë vdekur deri tridhjetë (30) ditë pas aksidentit, ose janë lënduar, ose është shkaktuar dëm material. Aksident i trafikut nuk konsiderohet kur makina e punës, motokultivatori, traktori apo karroca gjatë kryerjes së punëve rrëshqet, rrokulliset, ndeshet me ndonjë pengesë natyrore gjatë lëvizjes nëpër rrugë të pa kategorizuar apo nëpër punishte ku nuk merr pjesë ndonjë mjet tjetër ose këmbësor dhe në këtë ngjarje personit tjetër nuk i shkaktohet dëm material;

1.3. **Anashkalim** - kalimi me mjet pranë një mjeti tjetër të ndalur a të parkuar, ose pranë një objekti që gjendet në shiritin e trafikut nëpër të cilin lëviz mjeti rrugor;

1.4. **Autobus** - mjet motorik që shërben për transport të udhëtarëve, dhe i cili përveç ulëses së shoferit i ka së paku edhe tetë ulëse të tjera;

1.5. **Autobus i shkollës** - mjet motorik që shërben për transport të fëmijëve, përkatësisht të nxënësve;

1.6. **Automjet** - çdo mjet që lëviz në rrugë me fuqi të motorit të vet, i cili sipas konstruksionit, pajisjeve, veglave e pajimeve është paraparë për transport të personave, përkatësisht të ngarkesave / mallit, për kryerje të punëve a për tërheqje të mjeteve të bashkëngjitura, përveç mjeteve që lëvizin nëpër binarë;

1.7. **Automjetet nën përcjellje** - automjetet të cilat përdorin pajisje sinjalizuese me drita të kuqe të kaltër dhe pajisje akustike me intensitet të ndryshueshëm, si dhe me automjete të zakonshme të policisë gjatë sinjalizimit kur bëjnë përcjelljen e personaliteteve shtetërore ose mjetet tjera të autorizuar të cilët bëjnë përcjelljen e personaliteteve;

1.8. **Automjet udhëtarësh** - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetë (8) ulëse;

1.9. **Autoudhë** - rrugë publike që shërben vetëm për lëvizje të mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut dhe e cila i ka dy shirita rrugorë të ndarë fizikisht për lëvizje nga kahe të kundërta. Shiriti rrugor duhet t'i ketë së paku dy shirita të trafikut me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit dhe me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autoudhës, me gjerësi së paku 2,5 metra;

1.10. **Bashkësi mjetesh** - mjet me veprim motorik dhe mjetet e bashkëngjitura, të cilat në trafikun rrugor marrin pjesë si tërësi;

1.11. **Biçikletë** - mjet rrugor që ka së paku dy (2) rrota dhe që lëviz me fuqinë e shoferit;

1.12. **Dëm material i vogël në aksident trafiku** – dëmi i shkaktuar në objekte dhe në mjet ku vlera maksimale e dëmit të vogël do të përcaktohet me një vendim nga organi kompetent;

1.13. **Dukshmëri e dobësuar** – rrethanë kur nuk mund të vihet re a të dallohet qartë ambienti në të cilin ndodhet pjesëmarrësi në trafik, në përgjithësi prej muzgut deri në agim, si dhe gjatë kushteve të vështira atmosferike nga agimit deri në muzg;

1.14. **Fushëpamje e kufizuar** – hapësira e kufizuar të cilën pjesëmarrësi në trafik mund ta shohë nga vendi ku gjendet, për shkak të rrugës me kthesa të padukshme, me kurrize apo për shkak të ndonjë pengesë fizike, të ndonjë objekti apo të ngjashme;

1.15. **Gjysmërimorkio** – mjet i bashkëngjitur pa boshtin e përparmë, i konstruktuar në atë mënyrë që një pjesë e masës së tërësishme të saj mbartet në mjetin tërheqës nëpërmjet pjesës së vet të përparme, me anën e së cilës mbështetet në mjetin tërheqës;

1.16. **Hapësirë në rrugë e caktuar për kontroll** - hapësirë e caktuar për kryerje të kontrollimit fillestar apo më të detajuar të rregullsisë teknike në rrugë, e cila mund të jetë e pajisur me pajisje të montuar në mënyrë të përhershme për testim;

1.17. **Ishull i këmbësorëve** - sipërfaqe e ngritur ose e shënuar në një mënyrë tjetër, e cila gjendet në rrugën qarkulluese dhe e cila është caktuar për qëndrim të përkohshëm të këmbësorëve të cilët kalojnë nëpër rrugën për hyrje ose dalje nga mjeti që kryen transport publik;

1.18. **Kamion/mjet transportues** - çdo automjet që shërben për transportim të ngarkesës;

1.19. **Kapacitet i mjetit** - masa e lejuar deri në të cilin mjeti rrugor lejohet të ngarkohet, sipas deklaratës së prodhuesit të mjetit;

1.20. **Katërçikletë** – mjet me veprim motorik me katër rrota, tek e cila, nëse lëviz me energji elektrike, masa e zbrazët pa bateri nuk i kalon katërqind (400) kg nëse është paraparë për transport të udhëtarëve, përkatësisht pesëqind e pesëdhjetë (550) kg nëse është e paraparë për transport të mallrave, ndërsa forca e motorit nuk i kalon pesëmbëdhjetë (15) kW;

1.21. **Katërçikletë e lehtë** - mjet me veprim motorik me katër rrota tek e cila, nëse lëviz me energji elektrike, masa e zbrazët pa bateri nuk i kalon treqind e pesëdhjetë (350) kg, kapaciteti i punës së motorit me benzinë nuk është më i madh se pesëdhjetë (50) cm³, kurse fuqia më e madhe e motorit nuk i kalon katër (4) kW; nëse ka të bëjë me lloj tjetër të motorit, në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se dyzet e pesë (45) km/h;

1.22. **Këmbësor** - pjesëmarrës në trafik që nuk drejton mjet rrugor, as që transportohet nga ndonjë mjet rrugor, apo person i cili me fuqinë e vet shtyn apo tërheq karrocë dore, qerre kafshësh apo ndonjë mjet me lëvizje me veprim motorik, ndonjë mjet transportues të fëmijëve, biçikletë apo karrocë lëvizëse për njerëz të paaftë, apo person me karrige lëvizëse, i cili e lëviz mjetin me fuqinë e vet ose me fuqinë e motorit nëse lëviz me shpejtësi të njeriut që ec, apo person i cili rrëshqet me patina, me ski, me sajë apo me rrotëza etj;

- 1.23. **Kokë tërheqëse** - mjet transportues që shërben për tërheqje të gjysmërimorkios;
- 1.24. **Kolonë e këmbësorëve** - grupi i organizuar i këmbësorëve të drejtuar nga udhëheqësi ose nga komanduesi i tyre;
- 1.25. **Kolonë e mjeteve** – vargu i së paku tri mjeteve, përveç biçikletave, traktorëve, makinave të punës a qerreve që tërhiqen nga kafshë, mjete që janë të ndaluara në rrugë apo që lëvizin në shirit të njëjtë të trafikut në të njëjtin kah gjatë të cilit shpejtësia e lëvizjes së tyre dhe veprimi i shoferëve janë të kushtëzuara në mes vete dhe në mes të cilave mjete nuk mund të hyjë në mënyrë të papenguar mjete tjetër;
- 1.26. **Kontraktues** – personi fizik ose juridik, i autorizuar nga Ministria apo komuna për mirëmbajtje të rrugëve, për zhvendosje të mjeteve apo për shërbime të tjera në kuadër të këtyre institucioneve;
- 1.27. **Kryqëzim** - çdo kryqëzim, bashkëngjitje apo ndarje e rrugëve në të njëjtin nivel;
- 1.28. **Kthim gjysmërrethor** – kthim i mjetit për njëqind e tetëdhjetë (180) shkallë nga kahu i deritashëm i lëvizjes me qëllim të ndërrimit të kahut të lëvizjes;
- 1.29. **Kujdes i veçantë** – kujdes i shtuar dhe përshtatje e sjelljes së pjesëmarrësit në trafikun rrugor sipas kushteve dhe situatave në rrugë;
- 1.30. **Lëshim i mjetit** - veprim të cilin në kushte të caktuara shoferi është i obliguar ta bëjë me ndalje të mjetit, me zvogëlim të shpejtësisë së lëvizjes ose me ndërprerje të veprimit të cilin e kryen me mjet dhe në atë mënyrë nuk e detyron shoferin e mjetit tjetër që ta ndërrojë drejtimin ose të frenojë me vull;
- 1.31. **Makinë pune** - mjet me veprim motorik, si: cilindri, kositësja, buldozeri, ngarkuesja me pirun, gërmuesi etj, që shërben për kryerje të punëve të caktuara me veglëri dhe me pajisje të veta, sipas vetive të tij konstruktive, i cili nuk mund të lëvizë me shpejtësi më të madhe se dyzet (40) km/h;
- 1.32. **Masë e mjetit të zbrazët** - masa e mjetit të zbrazët pa ekuipazh, pa udhëtarë, pa ngarkesë, me rezervar të plotë të karburantit, si dhe me veglat e pajimet e detyruara për mjetin;
- 1.33. **Masë e përgjithshme** - masa efektive e mjetit rrugor së bashku me masën e ngarkesës që transportohet me mjet, duke përfshirë edhe masën e personave që gjenden në mjet, si dhe masën e mjetit të bashkëngjitur me ngarkesë, në qoftë se i është shtuar mjetit tërheqës;
- 1.34. **Masë më e madhe e lejuar** - masa më e madhe e lejuar e mjetit bashkë me ngarkesën e mjetit;
- 1.35. **Ministria**- Ministria përkatëse për transport;
- 1.36. **Mjet bletarie**- automjet ose mjet i bashkëngjitur, i projektuar ose i konstruktuar vetëm për bartje të bashkësive të bletëve dhe të cilit nuk i lejohet të bartë asnjë ngarkesë tjetër;

1.37. **Mjet bujqësor** - mjet me ose pa veprim motorik që përdoret për qëllime bujqësore a pyjore;

1.38. **Mjet i bashkëngjitur** - mjet rrugor, i konstruktuar si rimorkio apo gjysmërimorkio, që shërben për tërheqje nga mjeti motorik;

1.39. **Mjet i kombinuar** – mjet që shërben për transport të personave dhe sendeve, masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk i kalon tremijë e pesëqind (3.500) kg;

1.40. **Mjet i vjetër** - mjet i cili është i regjistruar si objekt muzeu ose është i përfshirë në regjistrin qendror të materialeve kombëtare trashëgimore;

1.41. **Mjet i zjarrfikësve** - automjet apo/dhe mjet i bashkëngjitur, që shërben për fikje të zjarrit;

1.42. **Mjet nyjor** - bashkësia e mjetit e cila përbëhet nga mjeti tërheqës dhe nga mjeti i bashkëngjitur, të lidhura ndërmjet vete me një mekanizëm nyjor;

1.43. **Mjet për bartje të kafshëve** - mjet i cili shfrytëzohet për bartje të kafshëve;

1.44. **Mjet për kampim** - automjet ose mjet i bashkëngjitur, i konstruktuar veçanërisht në atë mënyrë që në të ketë pajisje të përforcuara për mjeti, një pjesë e të cilave kur nuk nevojiten, palosen për të zënë më pak hapësirë, si: karriget me tavolinë, krevati (i cili mund të fitohet me tërheqje të karrigeve, elementet e kuzhinës dhe hapësirën për vendosje të rrobave, dhe të cilat mundësojnë përdorimin si mjet kampimi;

1.45. **Mjet që lëviz ngadalë** - mjet që lëviz me ndihmën e fuqisë motorike dhe që nuk mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se njëzet e pesë (25 km/h);

1.46. **Mjet rrugor** - çdo mjet transporti që lëviz nëpër rrugë, përveç karrocave lëvizëse pa motor për persona me aftësi të kufizuara dhe mjeteve transportuese të fëmijëve;

1.47. **Mjet special** - mjet rrugor ose mjet i bashkëngjitur, i cili shërben për kryerje të punëve dhe tek i cili kërkohet konstruksion dhe pajisje speciale;

1.48. **Mjet turistik** - mjet apo mjet i bashkëngjitur për qëllime të veçanta, i konstruktuar ose i përshtatur vetëm për nevoja turistike;

1.49. **Moped** - mjet me dy ose me tri rrota, tek i cili pa marrë parasysh mënyrën se si vihet në lëvizje, shpejtësia e konstruksionit nuk i kalon dyzet e pesë (45) km/h, kapaciteti i punës së motorit me djegie të brendshme është deri në pesëdhjetë (50) cm³ ose me fuqi të vazhdueshme që vihet në lëvizje me elektromotor i cili nuk e kalon fuqinë katër (4) kW;

1.50. **Motoçikletë** - automjet me dy rrota me ose pa rimorkio anësore, i cili lëviz me fuqi të motorit të vet, me vëllim punues të motorit mbi pesëdhjetë (50) cm³ dhe me mundësi zhvillimi të shpejtësisë së lëvizjes mbi dyzet e pesë (45) km/h;

1.51. **Motokultivator** - mjet me veprim motorik i cili e ka vetëm një bosht të konstruktuar për tërheqje, për shtyrje a për bartje të veglave të ndërrueshme që shërbejnë për punë

të ndryshme bujqësore, përkatësisht për t'i vënë në lëvizje ato vegla, apo për tërheqje të rimorkios;

1.52. **Motoudhë** - rrugë publike e paraparë vetëm për lëvizje të automjeteve, e cila është e shënuar si e tillë me shenjë përkatëse të trafikut;

1.53. **Muzg**- koha pas përfundimit të diellit deri në errësim;_

1.54. **Ndalje** - çdo ndërprerje e lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje deri në tre minuta, pos ndërprerjes e cila bëhet për të vepruar sipas shenjës apo rregullës me të cilat rregullohet trafiku;

1.55. **Ndalje urgjente** - ndërprerje e lëvizjes kur mjeti është i papërdorshëm për shkak të avarisë ose kur duhet të ndalet për ndonjë arsye tjetër;

1.56. **Ndërrim i shiritit të trafikut** - kalim me mjet prej një shiriti në shiritin tjetër të trafikut për lëvizje në të njëjtin kah, për shkak të rreshtimit ose lëvizjes më të shpejtë;

1.57. **Ngarkesë boshtore** - pjesa e masës së përgjithshme të mjetit me të cilin boshti i mjetit e ngarkon sipërfaqen e rrugës kur mjeti rrugor ndodhet në gjendje të palëvizshme;

1.58. **Parkim** - çdo ndërprerje e lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje më shumë se tre minuta, pos ndërprerjes e cila bëhet për të vepruar sipas shenjës apo rregullës me të cilat rregullohet trafiku;

1.59. **Pengim i trafikut** - veprim në trafik në kundërshtim me dispozitat e trafikut, me të cilin një pjesëmarrës e detyron pjesëmarrësin tjetër ta ndërrojë mënyrën e deriatëhershme të pjesëmarrjes në trafik;

1.60. **Përballëkalim** - kalim me mjetin rrugor pranë mjetit tjetër i cili lëviz nga kahu i kundërt nëpër të njëjtën rrugë;

1.61. **Pjesëmarrës në aksident trafiku** - person i cili është i përfshirë në çfarëdo mënyre në aksident në trafikun rrugor;

1.62. **Pjesëmarrës në trafik** - person i cili në çfarëdo mënyre merr pjesë në trafikun rrugor;

1.63. **Qerre** - mjet rrugor që shërben për transport dhe që tërhiqet nga kafshët;

1.64. **Raporti evropian i aksidentit** - dokument publik i cili përdoret gjatë shkaktimit të aksidenteve në trafikun rrugor me dëme të vogla materiale, i cili lëshohet nga organi kompetent;

1.65. **Rimorkio e lehtë** - mjet i bashkëngjitur, masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk është më e madhe se shtatëqind e pesëdhjetë (750) kg;

1.66. **Rimorkio** - mjet rrugor i bashkëngjitur, i konstruktuar në atë mënyrë që masën e tërësishme nëpërmjet akseve të veta ta mbartë mbi rrugën qarkulluese;

1.67. **Rrezikim i trafikut** – mënyrë e sjelljes në trafik për shkak të së cilës vjen deri te rreziku i drejtpërdrejtë për të shkaktuar aksident në trafik;

1.68. **Rrip i sigurisë** - mekanizëm i cili e ka një shirit me kapëse të sigurt që lidhet me pajisje të bashkëngjitur e cila është e përforcuar në automjet. Është i konstruktuar në atë mënyrë që ta kufizojë lëvizjen e trupit në rast ngadalësimi të vullshëm të automjetit apo në rast të një aksidenti, duke e zvogëluar rrezikun e lëndimit të përdoruesit të tij;

1.69. **Rrjedhë e trafikut** - lëvizje e mjeteve të cilat nëpër rrugë lëvizin në të njëjtin kah;

1.70. **Rrugë e pashtruar / rrugë dheu** - rrugë pa sipërfaqe të ndërtuar rrugore dhe pa shtresë rruge, e cila madje as në pikën e lidhjes me rrugën publike nuk ka sipërfaqe të ndërtuar rruge;

1.71. **Rrugë qarkulluese** - pjesa e sipërfaqes rrugore që shërben në rend të parë për lëvizje të mjeteve rrugore;

1.72. **Sistem i mbajtjes** - sistemi i përbërë i ulëses e cila në mënyrë përkatëse është e përforcuar në konstruksion të automjetit dhe për rripi të sigurisë së paku me një kapëse në ulëse;

1.73. **Shenjat e trafikut rrugor** -sistemi i shenjave të trafikut, si: semaforët, sinjalet ndriçuese, shënimet në rrugë, pajisjet dhe pajimet e tjera për rregullim teknik dhe menaxhim të trafikut si sistem unik e të ngjashme;

1.74. **Shirit i biçikletave** - pjesa e rrugës që shërben për lëvizje të biçikletave dhe të mopedëve, e cila shtrihet përgjatë rrugës qarkulluese që është e shënuar me vijë gjatësore në rrugën qarkulluese;

1.75. **Shirit i trafikut** – sipërfaqja e paraparë për qarkullim, gjerësia e së cilës është e mjaftueshme për zhvillim normal të trafikut të një rendi mjetesh rrugore;

1.76. **Shirit i trafikut anësor** - pjesa e rrugës qarkulluese në rrugët nacionale ku shiritat rrugorë janë të ndarë fizikisht, që shërben për lëvizje të mjeteve pa motor dhe të mjeteve të ngadalshme me veprim motorik, si: traktori, makinat e punës, motokultivatori apo të ngjashme;

1.77. **Shirit i trafikut për mjete të ngadalshme** - pjesa gjatësore e shënuar, që shërben për mjete të rënda dhe për mjete të tjera, të cilat me lëvizje të ngadalshme e zvogëlojnë rrjedhën e trafikut;

1.78. **Shirit i trafikut për ngadalësim** - pjesa e rrugës qarkulluese që shërben për dalje të mjeteve nga rrjedha e trafikut në rrugë;

1.79. **Shirit i trafikut për ndalje të detyrueshme** - pjesa gjatësore e shënuar në autoudhë, në vende të caktuara në rrugët e një rangu më të lartë, si: në tunele, në galeri apo të ngjashme;

1.80. **Shirit i trafikut për nxitim** - pjesa e rrugës qarkulluese që shërben për hyrje të mjeteve në rrjedhën e trafikut nga një rrugë dytësore, përkatësisht nga rrugë të tjera

hyrëse, si: nga pompat e derivateve, nga vendet e caktuara për parkim, si dhe nga objekte të tjera pranë rrugës;

1.81. **Shirit rrugor** - pjesa gjatësore e rrugës qarkulluese që shërben për lëvizje të mjeteve rrugore në një kah me një apo me më shumë shirita të trafikut;

1.82. **Shofer** - pjesëmarrësi në trafik i cili e drejton mjetin rrugor;

1.83. **Shofer fillestar** - shoferi i cili e ka marrë patentën e shoferit të kategorisë A, A1, A2 ose B, B1 që jo më shumë se dy (2) vjet;

1.84. **Shofer i ri** - shoferi i moshës deri në njëzet e katër (24) vjeç, me përjashtim të shoferit i cili të drejtuarit e mjetit e ka profesion themelor;

1.85. **Shteg i biçikletave** - sipërfaqja e trafikut e ndërtuar posaçërisht për lëvizje të biçikletave dhe të mopedëve që shtrihet përgjatë rrugës qarkulluese, që është e ndarë nga rruga dhe që është e shënuar me shenjë të caktuar të trafikut;

1.86. **Shtojcë traktori** - veglëri e zëvendësueshme për kryerje të punëve bujqësore e të punëve të tjera, të cilat i tërheq, i shtyn ose i bart traktori;

1.87. **Tejkalim** - kalimi me mjet pranë mjetit tjetër rrugor që lëviz në të njëjtin kah;

1.88. **Trafik në rrugë** - lëvizje e mjeteve, e këmbësorëve, si dhe e pjesëmarrësve të tjerë që qarkullojnë në rrugë publike apo në rrugë të pakategorizuara që shfrytëzohen për trafik publik;

1.89. **Traktor bujqësor a pyjor** - mjet me veprim motorik që lëviz me rrota dhe që ka së paku dy boshte, funksioni kyç i të cilit qëndron tek fuqia tërheqëse dhe që në mënyrë të veçantë shërben për të tërhequr, për të shtyrë, për të bartur a për të operuar me mjete, me makina a me rimorkio që përdoren në bujqësi a në pylltari, ndërsa funksion dytësor e kanë shfrytëzimin e tyre për transport të personave e të mallrave në rrugë dhe për tërheqje në rrugë;

1.90. **Tramvaj** - mjet që lëviz mbi binarë me rrymë elektrike dhe që shërben për transport publik, i cili për t'i dhënë motorit energji elektrike është i lidhur me përçues elektrik;

1.91. **Triçikletë** - mjet me veprim motorik me tri rrota, i vendosur në mënyrë simetrike, tek i cili vëllimi i motorit është mbi pesëdhjetë (50) cm³ dhe i cili në rrugë të rrafshët mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se 45 km/h;

1.92. **Triçikletë e lehtë** - mjet me veprim motorik me tri rrota, i konstruktuar ashtu që shpejtësia nuk i kalon 45 km/h, pavarësisht nga mënyra e transmisionit, tek i cili vëllimi i motorit me djegie të brendshme me benzinë nuk është mbi pesëdhjetë (50) cm³ dhe fuqia më e madhe efektive e të cilit nuk i kalon katër (4) kW nëse mjeti ka motor me djegie të brendshme me lloj tjetër të karburantit ose tek i cili fuqia nominale e përhershme nuk i kalon katër (4) kW kur mjeti punon me energji elektrike;

1.93. **Trolejbus** - mjet që shërben për transport të personave i cili përveç ulëses së shoferit ka më shumë se tetë (8) ulëse dhe i cili për t'i dhënë motorit energji elektrike

është i lidhur me përçues elektrik;

1.94. **Trotuar** - sipërfaqja e rregulluar pranë rrugës posaçërisht për lëvizje të këmbësorëve, e cila nuk është në nivel me rrugën qarkulluese ose është e ndarë në mënyrë tjetër nga rruga;

1.95. **Ulëse** - struktura e cila mund të jetë pjesë e konstruksionit të automjetit dhe e cila së bashku me shtresën është e paraparë për ulje të një personi, si dhe pjesën e ulëses së sigurisë për fëmijë;

1.96. **Vendkalim hekurudhor** - pjesa e rrugës e cila kalon përtej binarëve hekurudhorë ose të tramvajit në të njëjtin nivel, e cila mund të jetë e siguruar fizikisht me mbrojtëse dhe gjysmë mbrojtëse, me shenja të trafikut apo e pasiguruar;

1.97. **Vendkalim për këmbësorë** - pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese që shërben për kalim të këmbësorëve nëpër këtë shtresë, e cila është shënjuar me shenja përkatëse;

1.98. **Vendkalim për biçikleta** - pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese që shërben për kalim të biçikletave dhe të mjeteve të tjera që lëvizin nëpër shiritin apo shtegun e biçikletave, e cila është e shënjuar me shenja përkatëse;

1.99. **Vendndalim i autobusit** - pjesa e një sipërfaqeje të rrugës që shërben për ndalje të autobusëve me qëllim që të hyjnë dhe të dalin udhëtarët dhe që është e shënuar me shenjë përkatëse të trafikut;

1.100. **Zonë e Forcës së Sigurisë së Kosovës** - sipërfaqe apo gjatësi rruge afër kazermave të FSK-së, ku ndalohet ndalja e mjeteve pa leje speciale apo pa autorizim të veçantë;

1.101. **Zonë e këmbësorëve** - sipërfaqe e ndërtuar e trafikut që shërben në rend të parë për lëvizje të këmbësorëve, në të cilën iu ndalohet lëvizja mjeteve me veprim motorik, përveç atyre me leje të veçantë;

1.102. **Zonë e shkollës** - pjesa e rrugës apo rrugë lagjeje, e cila gjendet në afërsi të shkollës dhe e cila duhet të jetë e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut;

1.103. **Zonë e trafikut të qetë** – zonë në një qendër të banuar, e shënuar me shenjë përkatëse të trafikut, në të cilën mjetet nuk duhet të lëvizin me shpejtësi më të madhe se lëvizja e këmbësorit dhe në të cilën lojërat për fëmijë janë të lejuara në tërë zonën;

1.104. **Zonë urbane** - vetëm territori i qytetit apo qytezës, në të cilin hyrjet dhe daljet duhet të jenë të shënuara me shenja përkatëse të trafikut.

2. Termat të cilët shfrytëzohen në këtë ligj dhe nuk janë të përkufizuar, e kanë kuptimin sipas përkufizimeve në ligjet e tjera.

Neni 4

Rregullimi teknik i trafikut

1. Ministria apo Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme Policia) dhe në konsultim me komunitetin, bëjnë rregullimin teknik të trafikut nëpër rrugët publike nën administrimin përkatës të tyre.

2. Rregullimi teknik i trafikut i përfshin të gjitha masat dhe aktivitetet që merren për të ofruar qarkullim të sigurt në trafikun rrugor, e të cilat përfshijnë:

2.1. rrugën me përparësi kalimi;

2.2. trafikun me një përkatësisht me dy drejtime;

2.3. mbylljen e rrugës ose një pjese të rrugës për qarkullim të mjeteve, me kohë të caktuar ose të pacaktuar;

2.4. sistemin teknik të rregullimit të trafikut;

2.5. kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes;

2.6. lëvizjen e këmbësorëve, të biçikletave, të mopedëve, të qerreve, grahjen dhe tërheqjen e kafshëve;

2.7. hapësirën dhe mënyrën e parkimit, zonën e trafikut të qetë, zonën e shkollës, zonën e kufizimit të shpejtësisë, pajisjet teknike për ngadalësim të shpejtësisë;

2.8. bllokimin e autobusëve, të mjeteve transportuese, të mjeteve të bashkëngjitura dhe makinave të punës në vende të cilat nuk janë të paracaktuara për parkim, si dhe mënyrën e zhblokimit;

2.9. vendosjen dhe mirëmbajtjen e rrethojës mbrojtëse për këmbësorë në vende të rrezikshme;

2.10. zonën e këmbësorëve, drejtimet e sigurta për lëvizje të fëmijëve shkollorë, masat e veçanta teknike për siguri të këmbësorëve dhe biçiklistëve në afërsi të institucioneve mësimore, shëndetësore dhe institucioneve të tjera, të fushave sportive, të çerdheve të fëmijëve, të kinemave e të ngjashme;

2.11. largimin e automjeteve të vjetruara, të dëmtuara, të paregjistruara ose të braktisura;

2.12. largimin e automjeteve për qëllim biznesi që pengojnë mbarëvajtjen e trafikut, si shitblerjen në vende publike, rrugë dhe trotuar;

2.13. hapësirat në të cilat kryhen teste të drejtimit të mjetit rrugor, drejtimi në terren, drejtimi jashtë rrugës, garat sportive dhe të ngjashme;

2.14. kushtet e lëvizjes së mjeteve për furnizim në zonat e trafikut të qetë dhe në zonat e këmbësorëve;

2.15. sistemin e rregullimit teknik të qarkullimit rrugor nëpërmes sistemit elektronik dhe të video mbikëqyrjes.

3. Zona e shkollës përcaktohet nga Ministria dhe Komuna, në konsultim me Ministrinë përkatëse të Arsimit.

4. Nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe, shpejtësia më e madhe e lejuar në zonën e shkollës, prej orës 07:00 deri në ora 20:00, është:

4.1. brenda zonës urbane tridhjetë (30)km/h;

4.2. jashtë zonës urbane pesëdhjetë (50) km/h.

5. Në rastet kur rrugët rajonale, nacionale, motoudhët dhe autoudhët kalojnë nëpër zona urbane, Ministria jep pëlqim për rregullimin e trafikut në to.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) deri në katërqind e pesëdhjetë (450) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni.

Neni 5

Mbikëqyrja dhe zhvendosja e mjeteve

Mbikëqyrjen dhe zhvendosjen e mjeteve të cilat janë parkuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji për parkimin, e kryen Policia. Mbikëqyrjen dhe zhvendosjen e mjeteve mund ta kryejnë edhe persona të autorizuar të Komunës, me kërkesë dhe me pëlqim të Policisë.

Neni 6

Njësitë shkollore të trafikut

1. Përfaqësuesit e Ministrisë apo të Komunës me kërkesë të Policisë organizojnë njësi shkollore të trafikut. Aftësimin e njësisë, mënyrën dhe kohën, i përcakton Policia.

2. Rregullimin e trafikut në kryqëzim dhe në vende të tjera, mbikëqyrjen e parkimit të mjeteve dhe përcaktimin e detyrave të tjera të mbikëqyrjes së mjeteve dhe të shoferëve mund t'i kryejnë edhe pjesëtarët e njësive shkollore të trafikut, nën mbikëqyrje të Policisë.

3. Në hapësirat e shkollave dhe në afërsi të tyre, sigurimin e fëmijëve gjatë kalimit nëpër rrugë dhe në vendkalimin e këmbësorëve mund ta kryejnë edhe përfaqësuesit e njësive shkollore të trafikut. Sipas nevojës, kërkohet asistenca e Policisë.

4. Gjatë kohës së kryerjes së detyrave nga ky nen, pjesëtarët e njësive shkollore të trafikut duhet të mbajnë rroba sipas dispozitave përkatëse. Programi, mënyra e aftësimin dhe veprimet e njësive shkollore të trafikut, rrobat dhe emblemat përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 7

Mbikëqyrja e kohëzgjatjes së parkimit

Mbikëqyrjen e parkimit të mjeteve në vendet në të cilën është e kufizuar kohëzgjatja, e kryejnë përfaqësuesit e autorizuar nga Komuna.

KAPITULLI II

AUTORIZIMET PËR MBIKËQYRJE DHE RREGULLIM TË TRAFIKUT

Neni 8

Organet për autorizim, mbikëqyrje dhe rregullim të trafikut

1. Mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut, të mjeteve, të shoferëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në trafikun rrugor e kryejnë pjesëtarët e policisë.

2. Mbikëqyrjen e kohëzgjatjes së përgjithshme të të drejtuarit të mjetit, pushimin e shoferit, tahografit, pajisjeve, mjeteve në pikëpamje të masës më të madhe të lejuar, dimensionet dhe ngarkesat boshtore, mjetet të cilat kryejnë transportin publik të udhëtarëve dhe mallit, mjeteve të cilat bartin materiet e rrezikshme, mjetet që transportojnë kafshët, veturat taksi e të ngjashme, përveç personit të autorizuar nga Policia e kryejnë edhe inspektori i autorizuar nga Ministria dhe Komuna në kuadër të kompetencave të tij të përcaktuara me ligj.

3. Autorizimet për mbikëqyrjen dhe rregullim të trafikut i kryejnë edhe këto institucione sipas fushëveprimit të tyre:

3.1. personat e autorizuar nga Dogana e Kosovës sipas legjislacionit doganor;

3.2. personat e autorizuar të KFOR-it e të FSK-së, nëse njësitë e tyre marrin pjesë në trafikun rrugor;

3.3. mbikëqyrësi ose mësimdhënësi i cili i udhëheq nxënësit në mënyrë të organizuar dhe i cili jep shenjë për ndalim të trafikut, me qëllim të kalimit të sigurt të fëmijëve nëpër rrugë;

3.4. personat e autorizuar të hekurudhës, në vendkalimet hekurudhore gjatë kohës së ardhjes së trenit.

4. Mbikëqyrjen e kohëzgjatjes së përgjithshme të drejtimit të mjetit i cili transporton kafshë dhe mbikëqyrjen e tahografit, përveç inspektorit të autorizuar dhe zyrtarit të policisë mund ta kryejë edhe njësi mobile e autorizuar e veterinarisë.

5. Mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut e bëjnë punëtorët e subjektit të kontraktuar nga Ministria, nga Komuna apo nga institucionet e tjera përkatëse, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria apo Komuna, në segmentin e rrugës ku zhvillohen punimet.

KAPITULLI III

INFRASTRUKTURA RRUGORE

Neni 9

Rrugët

1. Rruga në të cilën zhvillohet trafiku duhet të projektohet, të ndërtohet, të pajiset, të mirëmbahet dhe të mbrohet, në mënyrë që t'i përgjigjet qëllimit të vet dhe kërkesave të sigurisë së trafikut, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Rrugët dhe me dispozitat e këtij ligji.
2. Rrugët publike, pjesë të caktuara të tyre dhe objektet në to lëshohen për trafik vetëm pasi të konstatohet se në pikëpamje të sigurisë së trafikut rrugor i plotësojnë kushtet e caktuara teknike.
3. Me rastin e ndërtimit, rekonstruktimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, Ministria apo Komuna mund të konsultohet me komunitetin të cilit i shërben rruga për t'i përcaktuar kushtet dhe mënyrat e vendosjes së shenjave dhe të drejtuarit e trafikut rrugor.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, personi përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave i cili vepron në kundërshtim me rregullat që i përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e vendosjes, si dhe të mirëmbajtjes së shenjave me rastin e konstruktimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve publike.

Neni 10

Rruga publike

1. Rruga publike duhet të ketë hapësirë të lirë në tërë gjerësinë e vet, në lartësi prej së paku katër presje pesë (4,5) metra.
2. Në ura, tunele, galeri ose objekte të ngjashme të rrugëve publike, gjerësia e rrugës mund të mos jetë e njëjtë sikurse gjerësia e rrugës publike.
3. Vendndalimi i autobusëve për hyrje dhe dalje të udhëtarëve në rrugë publike jashtë zonës urbane në rrugët nacionale dhe rajonale duhet të jetë jashtë shiritit të trafikut.
4. Në rrugët publike dhe në brezin mbrojtës të rrugëve publike jashtë zonës urbane nuk mund të vihen mbishkrime ose reklama, në rrugët nacionale dhe rajonale në distancë më të vogël se pesë (5) metra, kurse në rrugët lokale në distancë më të vogël se tri (3) metra nga pika më e largët e profilit tërthor të rrugës.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni.

Neni 11

Shënimi i punimeve dhe pengesave në rrugë

1. Pjesa e rrugës në të cilën janë paraqitur pengesa që nuk mund të mënjahen menjëherë ose aty ku kryhen punime, duhet të shënohet në mënyrë të dukshme përmes materialeve retro-reflektuese, me qëllim që të sigurohen pjesëmarrësit në trafik. Nëse largimi i pengesave nga rruga është i pamundshëm, ato duhet të shënohen në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme ditën dhe natën.
2. Vendosjen e shenjave përkatëse në rrugë nga paragrafi 1. të këtij neni e bën personi i autorizuar nga Ministria apo nga Komuna.
3. Shenjat përkatëse duhet të jenë të ngjyrosura sipas standardeve të parapara. Në rast të dukshmërisë së dobësuar duhet të vendoset edhe drita vezulluese ngjyrë portokalli.
4. Personi i cili kryen punime në rrugë duhet të përdorë elemente retro reflektuese të cilat janë të dukshme për pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, personi fizik i cili kryen punime në rrugë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe në kuadër të autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar sipas paragrafit 5. të këtij neni.

Neni 12

Lëshimi alternativ i pjesëmarrësve në trafik

1. Në rast të punimeve në rrugë apo të rrethanave të tjera, si: ortekët e borës, shembjet, rrëshqitjet apo të ngjashme, personi i autorizuar është i detyruar të mundësojë qarkullim alternativ për pjesëmarrësit në trafik, duke vendosur shenja përkatëse, duke përfshirë edhe semaforë të përkohshëm.
2. Para çdo fillimi të punimeve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, personi i autorizuar duhet të marrë leje nga organet kompetente dhe ta informojë policinë. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet urgjente.
3. Derisa nuk vendosen përkohësisht shenja ndriçuese, lëshimin alternativ të mjeteve nga kahu i kundërt, të paraparë në paragrafin .1 të këtij neni, e bën personi i autorizuar i punëkryesit.
4. Në rast se rregullohet trafiku sipas paragrafit 3. të këtij neni, personi i autorizuar i punëkryesit duhet të përdorë elemente reflektuese të cilat janë të dukshme për pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej treqind (300) eurosh, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, personi juridik i cili gjatë kryerjes së punimeve në rrugë ose kur ekzistojnë rrethana të tjera, nuk e organizon lëshimin alternativ në pajtim me dispozitat e këtij neni ose nuk e ka lejen sipas paragrafit 2. të këtij neni.

KAPITULLI IV SHENJAT E TRAFIKUT RRUGOR

Neni 13 Shenjat në rrugë

1. Rrugët publike duhet të shënohen me shenjat përkatëse të trafikut rrugor, me të cilat pjesëmarrësit në trafik paralajmërohen për rrezikun që u kanoset në rrugën e caktuar publike ose në një pjesë të saj, njoftohen për kufizimet, për ndalimet dhe për obligimet të cilave duhet t'iu përmbahen dhe të cilat japin njoftime të nevojshme për zhvillimin e sigurt dhe të papenguar të trafikut.
2. Shenjat e trafikut duhet ta shënojnë edhe rrezikun me karakter të përkohshëm, sidomos ato rreziqe që dalin si rezultat i dëmtimit të papritur ose paaftësisht të rrugës, si dhe t'i përcaktojnë kufizimet, ndalimet dhe obligimet e përkohshme. Këto shenja duhet të largohen pasi të kalojnë arsyet e vendosjes së tyre.
3. Shenjat e trafikut janë: shenjat e rrezikut, shenjat e urdhrave të prera, shenjat e lajmërimit me ose pa tabelë plotësuese e cila përcakton më hollësisht domethënien e shenjës së trafikut, sinjalet me dritë, shenjat në sipërfaqen e rrugës, në trotuar dhe shenjat e tjera në rrugë.
4. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar t'iu përmbahen kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shprehura përmes shenjave të trafikut.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi i cili është përgjegjës për vendosjen e shenjave të trafikut në rrugë dhe i cili vendosjen e shenjave e bën në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, pjesëmarrësi në trafik i cili nuk u përmbahet kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shprehura përmes shenjave të trafikut sipas paragrafit 4. të këtij neni.

Neni 14 Vendosja dhe mirëmbajtja e shenjave të trafikut

1. Shenjat e trafikut rrugor vendosen në bazë të projektit të trafikut.
2. Shenjat e trafikut vendosen dhe mirëmbahen në atë mënyrë që pjesëmarrësve në trafik t'iu mundësohet që t'i vërejnë ato me lehtësi, sikur ditën, ashtu edhe natën, për të vepruar me kohë sipas domethënies së tyre.
3. Shenja e trafikut duhet të largohet, të plotësohet ose të ndërrohet nëse domethënia nuk iu përgjigjet ndryshimeve të trafikut në rrugë ose kërkesave të sigurisë. Ato duhet gjithashtu të zëvendësohen nëse janë të dëmtuara apo si të tilla nuk kryejnë funksionin për të cilën janë vendosur.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi

juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 15 **Elemente penguese në trafik**

1. Në shenjën e trafikut ose në shtyllën e saj në të cilën është e vendosur shenja e trafikut ndalohet vendosja e çdo gjëje që nuk ka të bëjë me shenjën e trafikut.
2. Personave të paautorizuar iu ndalohet të vendosin, t'i largojnë, t'i ndërrojnë ose t'i dëmtojnë shenjat e trafikut, të pajisjeve të rrugëve dhe t'ua ndërrojnë domethënien e shenjave të trafikut.
3. Është i ndaluar largimi i paautorizuar i kapakëve të rjetit të ujësjellësit, të kanalizimeve apo të ngjashme.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në dymijë (2000) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 16 **Ndalimi i vendosjes së simboleve çorientuese**

1. Në rrugë nuk lejohet të vendosen tabela, shenja, drita, shtylla ose sende të ngjashme me të cilat kufizohet ose pengohet fushëpamje e shenjave të trafikut apo të cilat me formën, ngjyrën, pamjen ose vendin ku janë të vendosura duken si shenja të trafikut, apo i verbojnë pjesëmarrësit në trafik apo ua tërheq vëmendjen deri në atë masë e cila mund të jetë e rrezikshme për sigurinë e trafikut.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 17 **Shenjat e rrezikut, urdhrat e prera dhe të lajmërimit**

1. Shenjat e rrezikut shërbejnë për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit në trafikun rrugor për rrezikun që u kanoset në ndonjë vend të caktuar, përkatësisht në një pjesë të rrugës, si dhe të njoftohen për natyrën e këtij rreziku.
2. Shenjat e urdhrave të prera i urdhërojnë pjesëmarrësit në trafikun rrugor për ndalimet, për

kufizimet dhe për obligimet të cilave duhet t'iu përmbahen.

3. Shenjat e lajmërimit u japin pjesëmarrësve në trafik njoftime të nevojshme për rrugën nëpër të cilën lëvizin dhe njoftime të tjera të cilat mund të jenë të dobishme.

4. Shenjat e lajmërimit për orientim të trafikut i lajmërojnë pjesëmarrësit në trafik mbi shtrirjen e kaheve në rrugë, mbi radhitjen e caqeve dhe mbi orientimin e trafikut në drejtim të atyre caqeve dhe atë në kryqëzime, në nyje ose nga pushimore të vende të caktuara të rrugës.

Neni 18

Materialet për punimin e shenjave të rrezikut dhe urdhrave të prera

1. Shenjat e rrezikut dhe të urdhrave të prera duhet të jenë të punuara nga materiale retroreflektuese ose me burim të vetin ndriçues, ndërsa në autoudhë dhe në motoudhë këto veçori duhet t'i kenë edhe shenjat e lajmërimit.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik apo institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i caktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 19

Shenjat ndriçuese të trafikut

1. Për rregullim të trafikut përdoren semaforët, të cilët emetojnë shenja ndriçuese me tri ngjyra, të vendosura vertikalisht njëra mbi tjetrën: drita e kuqe lart, drita e verdhë në mes, kurse drita e gjelbër poshtë.

2. Nëse semafori është i vendosur mbi shiritin e trafikut, drita mund të vendoset horizontalisht njëra pranë tjetrës: drita e kuqe majtas, drita e verdhë në mes, drita e gjelbër në të djathtë. Dritat kanë formë rrethi, ndërsa drita e gjelbër mund të jetë edhe në formë shigjete ose shigjetave të vendosura në një rreth me ngjyrë të zezë.

3. Dritat në semafor e kanë këtë kuptim:

3.1. drita e kuqe, ndalim kalimi;

3.2. drita e gjelbër, kalim i lirë;

3.3. drita e verdhë e ndezur e vetme pa ndërprerje do të thotë që mjeteve nuk iu lejohet ta kalojnë vijën e ndaljes dhe të hyjnë në kryqëzim nëse në momentin e ndezjes së dritës së verdhë gjendet në atë largësi nga semafori që mund të ndalet në mënyrë të sigurt.

4. Nëse semaforit në kryqëzim i është shtuar një dritë plotësuese ose drita plotësuese në formë shigjete, gjatë kohës derisa ato drita janë të ndezura, shoferi mund të kalojë me mjet në drejtim të shigjetave edhe gjatë kohës derisa është e ndezur drita e kuqe ose e verdhë, por me kusht

që t'i lëshojë mjetet të cilat lëvizin në rrugë ku ai është duke hyrë, si dhe këmbësorët të cilët e kalojnë atë rrugë.

5. Drita e gjelbër e ndezur në semafor në formë të shigjetave, shoferit me mjet i lejon lëvizje vetëm në drejtim të përcaktuar me shigjeta.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i cili nuk ndalet në shenjë e dritës së kuqe në vendin ku trafiku rregullohet me semaforë. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe tri (3) pikë negative. Identifikimi dhe dëshmia bëhen përmes pajisjes apo aparatit përkatës, si dhe nga persona të autorizuar.

Neni 20

Semafori për këmbësorë

1. Për rregullimin e trafikut të këmbësorëve mund të përdoret semafori me drita dyngjyreshe dhe pajisjet me zë.

2. Drita dyngjyreshe e kuqe dhe e gjelbër vendosen vertikalisht njëra nën tjetrën: drita e kuqe lart, kurse drita e gjelbër poshtë dhe në to është e vendosur figura e këmbësorit: drita me ngjyrë të kuqe në pozitë të ndalur, ndërsa ngjyra e gjelbër në pozitë të lëvizjes.

3. Dritat me ngjyra nga paragrafi 2. i këtij neni nuk lejohet të ndizen njëkohësisht.

4. Këmbësori i cili nuk ndalet në shenjë e dritës së kuqe në vendin ku trafiku rregullohet me semaforë, dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh.

Neni 21

Funksionimi i semaforëve

1. Në semafor dritat me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër nuk mund të ndizen njëkohësisht. Drita e verdhë e vetme pa ndërprerje ndizet prej kalimit të dritës së gjelbër në atë të kuqen, ndërsa njëkohësisht me të kuqen para se të ndizet drita e gjelbër.

2. Semaforit me drita tri ngjyreshe mund t'i shtohet një shenjë plotësuese me drita në formë shigjete ose disa shenja përkatëse, të cilat vendosen në anën e caktuar të semaforit në lartësinë në të cilën ndodhet drita e gjelbër.

3. Ndryshe nga paragrafi 2. i këtij neni, shenja plotësuese në semafor në formë shigjete me ngjyrë të gjelbër për kthim majtas mund të jetë e vendosur si dritë e veçantë e trafikut për dalje nga kryqëzimi.

4. Drita me ngjyrë të gjelbër me ndërprerje paralajmëron ndërprerjen e shpejtë të kalimit të lirë, përkatësisht paraqitjen e dritës me ngjyrë të verdhë pastaj të kuqe. Ndërsa drita me ngjyrë të verdhë me ndërprerje shërben për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit e trafikut të lëvizin me kujdes të shtuar.

5. Në rrugë me më tepër se dy shirita të trafikut të shënuar me shënime gjatësore, ku trafiku drejtohet me semafor për çdo shirit veçmas dhe të cilat janë të vendosura mbi shirita të trafikut, drita e kuqe ndalon trafikun përgjatë shiritit të trafikut mbi të cilin është e vendosur, drita e

gjelbër lejon kalimin e lirë nëpër shiritin e trafikut mbi të cilën është vendosur.

6. Drita e kuqe nga paragrafi 5. i këtij neni e ka formën e “x”, ndërsa drita me ngjyrë të gjelbër e ka formën e shigjetës me maje të kthyer poshtë.

7. Shoferi i cili nuk i respekton shenjat e semaforit sipas këtij neni dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik tre (3) muaj, si dhe tri (3) pikë negative. Identifikimi dhe dëshmia bëhet përmes pajisjes apo aparatit përkatës, si dhe nga persona të autorizuar.

Neni 22

Pajisjet dhe pajimet për shënim të rrugëve

1. Skajet e rrugës shënohen me sinjale drite dhe materie retroreflektuese, ndërsa kufizuesit e rrugës shënohen me elemente të pajisura me materie reflektuese dhe me shtylla ndriçuese.

2. Kufizuesit e rrugës të cilët janë të vendosur në rrugë nga ana e djathtë në drejtim të lëvizjes janë me ngjyrë të kuqe, ndërsa në anën e majtë me ngjyrë të bardhë.

3. Nëse kulmet e ishujve të këmbësorëve, ishujt për orientim të trafikut dhe objektet e tjera në rrugë, nuk janë të dukshme natën sa duhet, ato duhet të shënohen me drita, me materie retroreflektuese ose me materie reflektuese me ngjyrë të verdhë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi i cili është përgjegjës për vendosjen ose mirëmbajtjen e kulmeve të ishujve të këmbësorëve, të ishujve për orientimin të trafikut ose të objekteve të tjera në rrugë, të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen.

Neni 23

Shenjat në rrugë

1. Shenjat në rrugë shërbejnë për orientim, për lajmërim dhe për drejtim të pjesëmarrësve në trafikun rrugor.

2. Shenjat në rrugë mund të vendosen vetëm ose së bashku me shenja të tjera të trafikut nëse është e nevojshme që domethënia e këtyre shenjave të dallohet qartë, përkatësisht të përcaktohet ose të sqarohet në mënyrë më të plotë.

3. Shenjat në rrugë janë: vijat, shigjetat, mbishkrimet dhe shenjat e tjera.

4. Shenjat në rrugë duhet të kenë veti reflektuese.

Neni 24

Vendosja e shenjave në rrugë

1. Shenjat në rrugë vendosen në sipërfaqet e rrugëve bashkëkohore.

2. Në rrugë publike jashtë zonës urbane dhe në rrugë për trafik në dy drejtime ku ekzistojnë vetëm dy shirita të trafikut, shiritat duhet të jenë të ndarë me vijë përkatëse gjatësore në rrugë, kurse në rrugët rajonale dhe nacionale, duhet të jenë të shënuara edhe me vijë anësore.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëmijë (6000) eurosh, personi juridik përgjegjës për vendosjen e shenjave në rrugë, nëse nuk i vendos shenjat në pajtim me rregullat e përcaktuara në këtë nen.

Neni 25

Vendosja e shenjave në vendkalimin hekurudhor

1. Në pjesën e rrugës para vijës hekurudhore duhet të vendosen shenjat përkatëse të trafikut.

2. Ndryshe nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk është e domosdoshme të vendosen shenjat në vendin ku shtegu i këmbësorëve kryqëzohet me hekurudhën në nivel të njëjtë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik përgjegjës për vendosjen e shenjave të trafikut dhe të sinjaleve ndriçuese akustike para vendkalimit mbi hekurudhë, nëse nuk merr masa sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 26

Mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset në vendkalimet hekurudhore

1. Në qoftë se e kërkojnë dëndësia e trafikut ose rrethana të tjera, në vendkalimet hekurudhore përveç shenjave të trafikut të vendosura në bazë të nenit 25 i këtij ligji, vendosen edhe mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset, përkatësisht pajisje për dhënien e shenjave me të cilat paralajmërohet ardhja e trenit.

2. Kushtet në të cilat duhet të vendosen pajisjet nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik i cili është përgjegjës për vendosjen e mbrojtëseve dhe gjysmë mbrojtëseve para vendkalimit mbi hekurudhë, nëse nuk merr masa sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 27

Pajisjet ndriçuese dhe sinjalet me zë

1. Shenjat me drita me të cilat paralajmërohet ardhja e trenit në vendkalimin hekurudhor jepen duke u ndezur në mënyrë alternative dhe me ndërprerje dy drita të kuqe vezulluese në formë rrethi.

2. Në vendkalimet hekurudhore në të cilën ekzistojnë pajisjet për dhënien e shenjave me drita për paralajmërim të ardhjes së trenit, përkatësisht lëshimin e mbrojtëseve dhe gjysmëmbrojtëseve, këtyre pajisjeve mund t'i bashkëngjitet edhe pajisja për dhënien e sinjaleve me zë.

3. Në vendkalimet e rrugëve të pashtuara me trafik me intensitet të ulët dhe në shtigjet e këmbësorëve në nivel me vijën hekurudhore, sigurimi i pjesëmarrësve në trafik mund të bëhet vetëm me pajisje për dhënien e sinjalit me zë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik i cili është përgjegjës për vendosjen e shenjave dhe sinjaleve, nëse nuk merr masa sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 28

Dukja e mbrojtëseve dhe gjysmë mbrojtëseve

1. Në vendkalimet hekurudhore, mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset janë të ngjyrosura në mënyrë alternative më ngjyrë të kuqe dhe të bardhë.

2. Mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset, si dhe shenjat e trafikut të vendosura në pjesën e rrugës para vendkalimit hekurudhor, duhet të jenë të pajisura me materie reflektuese me ngjyrë përkatëse.

3. Mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset duhet të jenë të pajisura me drita të kuqe vezulluese.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik i cili është përgjegjës nëse nuk merr masa sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 29

Funksionimi i mbrojtëses dhe gjysmë mbrojtëses

1. Në vendkalimin hekurudhor në të cilin me rastin e ardhjes së trenit mbrojtëset dhe gjysmë mbrojtëset lëshohen automatikisht, lëshohen nga vendi nga i cili ato nuk shihen, apo lëshohen me dorë, duhet të vendosen pajisje për dhënie të sinjalit me drita ose me zë, me anën e të cilave pjesëmarrësit në trafik njoftohen për lëshimin e mbrojtëseve dhe gjysmë mbrojtëseve.

2. Ministria nxjerr akt nënligjor me të cilin rregullon ndaljen e trafikut në vendkalimin hekurudhor dhe lëshimin alternativ gjatë punimeve në rrugë si dhe çështje të tjera të lidhura me to.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik i cili është përgjegjës për vendosjen e shenjave ndriçuese të trafikut ose të sinjaleve me zë, nëse nuk merr masa sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 30

Personat e autorizuar

1. Pjesëmarrësit në trafik duhet të veprojnë sipas kërkesave të shprehura përmes shenjave apo sipas urdhrave të Policisë ose personave të autorizuar, të cilët e mbikëqyrin dhe e rregullojnë trafikun në bazë të këtij ligji.

2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të vendosen në vend të dukshëm dhe në largësi të mjaftueshme ditën edhe natën.

3. Personi i autorizuar me rastin e dhënies së shenjave, duhet të qëndrojë në rrugë në atë mënyrë që pjesëmarrësit në trafik të mund ta vërejnë lehtë dhe nga largësia e duhur.

4. Gjatë ndaljes të automjetit personi i autorizuar nga Policia, FSK-ja, Dogana, Inspektori i Ministrisë dhe Komunës obligohet ta përdorë tabelën "STOP" sipas institucionit përkatës.

Neni 31

Shenjat që japin personat e autorizuar

1. Shenjat që personi i autorizuar ua jep pjesëmarrësve në trafik janë shenjat që jepen me duar, me pozitë të trupit, sinjalet me zë dhe me shenja ndriçuese.
2. Shenjat nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të jepen në atë mënyrë që domethënia e tyre për pjesëmarrësit në trafik të jetë e qartë dhe e kuptueshme.
3. Shenjat nga paragrafi 1. i këtij neni mund të jepen edhe nga mjeti.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i cili nuk vepron sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrat të personit të autorizuar që kryen kontrollin dhe rregullimin e trafikut në rrugë. Atij shoferi i shqiptohet edhe një (1) pikë negative.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, pjesëmarrësi në trafik përveç shoferit të mjetit me veprim motorik i cili nuk vepron sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrat të personit të autorizuar që kryen kontrollin dhe rregullimin e trafikut në rrugë.

Neni 32

Aktet nënligjore për shenjat e trafikut rrugor

Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për Punë të Brendshme, nxjerr akt nënligjor për shenjat e trafikut rrugor dhe shenjat të cilat i jep polici, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

KAPITULLI V

RREGULLAT E TRAFIKUT

Neni 33

Obligimet themelore të pjesëmarrësve në trafik

1. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar t'iu përmbahen rregullave të trafikut, shenjave të trafikut të vendosura në rrugë, si dhe shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar.
2. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me shenjat e trafikut të vendosura në rrugë edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e përgjithshme të trafikut.
3. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me semaforët edhe kur kjo dallon nga dispozitat e trafikut për përparësinë e kalimit të shprehur në të njëjtin vend me shenjë tjetër të trafikut.
4. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave që i japin personat e autorizuar, edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e caktuara të trafikut ose nga domethënia e shenjave të trafikut të vendosura në rrugë ose në semaforë.

5. Pjesëmarrësit në trafik janë të detyruar që t'i shmangen çdo veprimi që shkakton rrezik ose pengesë në trafik, që sjell në rrezik për pjesëmarrësit në trafik ose që i shkakton dëm pronës private ose publike si dhe janë të obliguar që ta lajmërojnë policinë për çdo dukuri që mund ta rrezikojë sigurinë rrugore.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit me veprim motorik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, çdo pjesëmarrës tjetër në trafik, përveç të shoferit të mjetit me veprim motorik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 34

Largimi i sendeve nga rruga

1. Shoferi i mjetit është i detyruar t'i heqë nga sipërfaqja e rrugës sendet që bien në rrugë nga mjeti i tij dhe sendet që i ka lënë në rrugë kur e ka ndalur mjetin.

2. Nëse shoferi, pronari i mjetit ose personi tjetër përgjegjës nuk vepron në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, sendet që bien në rrugë i largon menjëherë personi juridik për mirëmbajtjen e rrugëve i kontraktuar nga Ministria apo Komuna.

3. Shoferi mund t'i largojë sendet që has në rrugë nëse rrezikohet siguria në trafik apo të lajmëroj Policinë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, pjesëmarrësi në trafik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) eurosh, personi juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 35

Mbrojtja e rrugës publike

1. Në rrugë, në trotuar dhe në brezin mbrojtës të rrugës nuk lejohet lënia e mjeteve të dëmtuara, të papërdorshme, të paregjistruara, të sendeve, materialeve ose të gjërave të ngjashme, shtazëve të aksidentuara e të ngordhura, si dhe hedhja e mbeturinave që mund ta pengojnë ose ta rrezikojnë trafikun.

2. Rruga publike dhe brezi i saj mbrojtës, përkatësisht rruga dhe trotuari, nuk lejohen të dëmtohen ose të shfrytëzohen për qëllime të tjera, si material ndërtimor ose të ngjashme, përveç në raste tjera të parapara me ligj ose të autorizuara nga organi kompetent.

3. Komuna mund të lejojë shfrytëzimin e pjesës së trotuarit me rrethojë, vendosje të tavolinave, ulëseve, qoshqeve ose të ngjashme, me kusht që nuk kufizohet ose pengohet fushëpamje e rrugës dhe që lëvizja e këmbësorëve të jetë e papenguar dhe e sigurt, duke lënë hapësirë të trotuarit me gjerësi prej së paku 1,6 metrash. Për rrugët nacionale dhe regjionale leja në fjalë mund të jepet vetëm me pëlqimin paraprak të Ministrisë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi

fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej një mijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, personi juridik i cili ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 36

Pjesëmarrja në trafik e personit të verbër

1. Kur personi i verbër merr pjesë në trafik pa praninë e personit përcjellës, ai duhet ta mbajë si shenjë identifikimi shkopin e bardhë, ose një shenjë dalluese, ose të jetë nën përcjellje të qenit të aftësuar për udhëheqje.

2. Shoferi e ka për detyrë të ketë kujdes të veçantë ndaj personave të verbër, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 37

Shënjimi i mjetit të personit me aftësi të kufizuara

1. Mjeti i cili është i përshtatur për t'u drejtuar nga personi me aftësi të kufizuara, me kërkesë të tij mund të shënohet me shenjë të veçantë.

2. Shenjë të veçantë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përdorë vetëm personi me aftësi të kufizuar.

3. Shenja e veçantë lëshohet në emër të personit me aftësi të kufizuara, gjegjësisht në emër të shoqatës së personave me aftësi të kufizuara për mjetet e saj. Pamjen e shenjës, kushtet për marrjen e saj, mënyrën e shënimit të vendeve për parking dhe të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, i rregullon Ministria me akt të veçantë nënligjor.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në një mijë e pesëqind (1500) euro, personi zyrtar i cili ia jep shenjën e qasjes personit që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë nen.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) eurosh, personi i cili e përdor shenjën e qasjes, por që nuk është person me aftësi të kufizuara në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 38

Mjetet e transportit publik

1. Shoferi i mjetit, i cili lëviz pranë mjetit të transportit publik të udhëtarëve ose pranë autobusit me të cilin kryhet transporti për nevoja personale i ndalur në vendndalim të autobusëve, duhet të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe me kujdes të shtuar, ashtu që të mos i rrezikojë personat të cilët hyjnë ose dalin nga mjeti.

2. Gjatë hyrjes ose daljes nga mjeti, personat nga paragrafi 1. i këtij neni duhet ta kalojnë rrugën me kujdes të shtuar.

3. Shoferi duhet ta ndalë mjetin e vet mbrapa mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni kur personat gjatë hyrjes ose daljes nga mjeti duhet të kalojnë nëpër shiritin e trafikut, nëpër shtegun apo shiritin e biçikletave ose shiritin në të cilin mjeti lëviz.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 39

Transporti i organizuar për fëmijë dhe nxënës

1. Shoferi i mjetit i cili lëviz prapa mjetit në të cilin transportohen fëmijë, përkatësisht nxënës, shoferi i mjetit i cili vjen përballë në rrugë me një shirit të trafikut të caktuar për trafik në një drejtim, duhet të ndalen kur mjeti me të cilin transportohen fëmijët është ndalur në rrugë derisa fëmijët hyjnë ose dalin nga ai mjet.

2. Nëse me mjet transportohen fëmijë në mënyrë të organizuar, mjeti duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta dhe të jetë i shënuar me shenjë të veçantë, ndërsa gjatë kohës së hyrjes dhe daljes së fëmijëve nga mjeti, shoferi duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit të mjetit.

3. Ndalohet të shënohet mjeti me anë të shenjës së veçantë nga paragrafi 2. i këtij neni, nëse nuk transportohen fëmijë në mënyrë të organizuar. Nëse ai mjet nuk transporton fëmijë, atëherë shenja e veçantë duhet mbuluar ose hequr.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili nuk e ndal mjetin e vet në kushtet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni dhe atij i shqiptohet një (1) pikë negative.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi përgjegjës për transportin e grupeve të organizuara të fëmijëve i cili urdhëron ose lejon që mjeti me të cilin bëhet transporti në fjalë nuk është i shënuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i mjetit që transporton grupe të organizuara fëmijësh, i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni.

Neni 40

Kushtet dhe kriteret për transport të organizuar të fëmijëve

1. Mjeti për transport të organizuar të fëmijëve duhet të ketë leje për këtë lloj transporti.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet dhe kriteret për transportin e organizuar të fëmijëve e nxënësve, si dhe shenjën e veçantë me të cilën duhet të shënohen këto mjete.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi përgjegjës për transportin e grupit të organizuar të fëmijëve i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni dhe atij i shqiptohen tri (3) pikë negative.

Neni 41**Veprimet me mjetin në trafik**

1. Shoferi, i cili në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, si: hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo në të majtë, kthimin gjysmërrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashme, lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë.

2. Para ndërmarrjes së veprimeve të përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni, shoferi duhet të këtë kujdes për pozitën e mjetit, për drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjes.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe atij i shqiptohet një pikë negative.

Neni 42**Detyrimet e shoferit para se të ndërmerr ndonjë veprim**

1. Para se të ndërmarrë ndonjë veprim në trafik, shoferi i mjetit duhet t'i paralajmërojë qartë dhe me kohë pjesëmarrësit e tjerë në trafik për qëllimin e tij, duke dhënë sinjal me anë të treguesve të drejtimit gjatë gjithë kohës së kryerjes së manovrimit dhe ta ndërpresë sinjalin menjëherë pas përfundimit të veprimit. Nëse nuk ekzistojnë treguesit e drejtimit, veprimin duhet paralajmëruar duke dhënë shenjë përkatëse me dorë.

2. Shoferi i mjetit është i obliguar të sinjalizojë me tregues të drejtimit edhe pasi ta ketë kryer tejkalimin dhe synon të kthehet në shiritin e trafikut në të cilin ka lëvizur para se ta bëjë tejkalimin e mjetit tjetër.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 43**Hyrja në trafik**

1. Hyrja në trafik ndodh atëherë kur mjeti fillon të lëvizë nga ndalja që nuk ka rezultuar nga rrethanat ose dispozitat e trafikut, ose kur mjeti del nga parkimi në rrugë, ose kur hyn:

- 1.1. në rrugë nga prona ose nga një rrugë dheu;
- 1.2. nga objekte anësore të rrugës ose nga rruga që dërgon te ato objekte;
- 1.3. nga rruga e cila nuk është rrugë publike;
- 1.4. nga zona e qetë e trafikut;
- 1.5. në rrugë nga toka bujqësore;
- 1.6. nga rruga në të cilën nuk zhvillohet trafik publik;

1.7. në rrugë prej bankinës a trotuarit,

1.8. në shirit trafiku të përcaktuar për lëvizje të mjeteve që lëvizin ngadalë ose nga shiriti për nxitim;

1.9. në rrugë nga shtegu i biçikletave;

1.10. në rrugë nga depoja ose nga vendisja e përcaktuar për mjete të cilat lëvizin nëpër binarë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 44

Hyrja nga rruga dytësore e paasfaltuar

1. Shoferi i cili me mjet hyn nga rruga e dheut në rrugë me rrugë të shtruara duhet ta ndalë mjetin dhe ta heqë baltën nga rrotat.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 45

Përparësia me rastin e hyrjes në trafik

1. Gjatë hyrjes në trafik, shoferi duhet të ketë kujdes të posaçëm dhe t'i japë përparësi çdo mjeti tjetër apo pjesëmarrësi tjetër të trafikut.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 46

Vendndalimi i autobusëve

1. Gjatë afrimit të vendndalimit të shënuar për autobusë, brenda zonës urbane, shoferi i mjetit detyrohet që ta zvogëlojë shpejtësinë dhe nëse është e nevojshme, të ndalet, në mënyrë që t'ia mundësojë shoferit të autobusit apo të ndonjë mjeti tjetër i cili kryen transportin publik të udhëtarëve që të hyjë në trafik, nëse shoferi i mjetit që kryen transport publik të udhëtarëve sinjalizon me treguesin e drejtimit synimin e tij që ta ndërrojë shiritin e trafikut ose të lëvizë nga vendndalimi i autobusit në rrugë.

2. Shoferi i autobusit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund të hyjë në shiritin e afërt të trafikut ose të lëvizë në rrugë vetëm pasi të sigurohet se veprimi i tillë nuk do të shkaktojë kurrfarë pengimi apo rreziku në trafik.

3. Ndalohet ndalja e autobusëve për marrje apo zbritje të udhëtarëve jashtë vendndalimit për autobusë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i cili vepron në

kundërshtim me rregullat e paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i autobusit i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 3. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, edhe personi juridik apo institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni.

Neni 47

Vendndalimi i autobusit të shkollës

1. Kur afrohet te vendndalimi i autobusit të shkollës, shoferi i mjetit duhet ta ndalë mjetin nëse shoferi i autobusit që ndodhet në vendndalim ka dhënë shenjë për ndalje të autobusit.

2. Shoferi i mjetit duhet ta zvogëlojë shpejtësinë dhe, nëse është e nevojshme, ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ia mundësoj shoferit të autobusit të shkollës për të lëvizur në rrugë ose në shiritin më të afërt të trafikut, nëse shoferi i autobusit sinjalizon që do ta bëjë një veprim të tillë.

3. Shoferi i autobusit të shkollës në rrethanat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni mund të lëvizë në shiritin e afërt të trafikut ose në rrugë vetëm pasi të sigurohet që ky veprim nuk do të shkaktojë pengim ose rrezikim në trafik.

4. Vendndalimi i autobusëve shënohet me shenja përkatëse të trafikut, në mënyrë që të jenë të dukshme për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 48

Lëvizja e mjeteve

1. Shoferi detyrohet ta drejtojë mjetin në anën e djathtë të kahut të lëvizjes së rrugës.

2. Për lëvizje të mjetit të vet, shoferi duhet ta shfrytëzojë vetëm rrugën, përkatësisht shiritin e trafikut dhe shtegun e caktuar për lëvizjen e atij lloji të mjeteve të cilit i takon mjeti, përveç në rast të rrezikut.

3. Në çdo rrugë të pashënuar me vija ndarëse, shoferi është i detyruar ta drejtojë mjetin sa më afër skajit të djathtë të rrugës. Nëse shiritat në rrugë janë të shënuar, shoferi duhet ta drejtojë mjetin nëpër mesin e shiritit të trafikut.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 49

Lëvizja në zona urbane

1. Në rrugët e zonave urbane me sipërfaqe rrugore në të cilat për lëvizje të mjeteve në të

njëtin kah ekzistojnë të paktën dy shirita të trafikut, shoferi për lëvizje me mjetin e vet mund ta shfrytëzojë edhe shiritin e trafikut që nuk ndodhet pranë skajit të djathtë të rrugës, në qoftë se me këtë nuk i pengon mjetet e tjera që lëvizin pas mjetit të tij.

2. Dispozita e paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të bëjë me shoferin e mjetit të transportit me masën më të madhe të lejuar mbi tremijë e pesëqind (3500) kg, me shoferin e mjetit që në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se dyzet (40) km/h, me shoferin e mopedit, të triçikletës, të katërçikletës, të traktorit, të makinës së punës dhe të motokultivatorit, përveç në pjesën e rrugës para kryqëzimit ose para vendit tjetër në të cilin mjeti kthehet në të majtë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 50

Mënyra e lëvizjes së mjeteve

1. Në rrugën për lëvizje të mjeteve në të dy kahet, e cila ka katër apo më shumë shirita të trafikut, shoferit nuk i lejohet të kalojë me mjetin e vet në shiritin rrugor që shërben për lëvizje të mjeteve nga kahu i kundërt.

2. Kur në rrugën për lëvizje të mjeteve në dy kahe ekzistojnë tre shirita të trafikut, shiriti i mesëm shfrytëzohet varësisht prej sinjalizimit rrugor. Shoferit të mjetit nuk i lejohet të lëvizë me mjetin e vet nëpër shiritin e trafikut që ndodhet pranë skajit të majtë të rrugës në kah të lëvizjes së mjetit.

3. Në rrugë në të cilën shiritat rrugorë janë të ndarë fizikisht njëri prej tjetrit, shoferit nuk i lejohet ta lëvizë mjetin e vet nëpër shiritin rrugor që shërben për lëvizje të mjeteve nga kahu i kundërt.

4. Në rrugë me trafik në një kah, shoferit nuk i lejohet të lëvizë nga kahu i kundërt, përkatësisht nga kahu i ndaluar.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej shtatëdhjetë (70) deri në dyqind e dhjetë (210) euro, shoferi i mjetit me veprim motorik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe atij i shqiptohet një (1) pikë negative.

Neni 51

Lëvizja në rrugë në nivel me binarë

Në rrugët në nivel me binarët e tramvajit, mjeti mund të lëvizë mbi binarë në qoftë se nuk e pengon lëvizjen e tramvajit, përveç nëse me shenja të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 52

Lëvizja prapa

1. Nëse shoferi i mjetit synon të lëvizë prapa me mjetin e vet, këtë mund ta bëjë në një pjesë të shkurtër të rrugës vetëm nëse nuk i pengon ose nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

2. Kur shoferi lëviz prapa me mjet, ai duhet të lëvizë në atë anë të rrugës në të cilën ka lëvizur deri atëherë.

3. Kur shoferi i mjetit lëviz prapa, ai duhet t'iu japë përparësi mjeteve të cilat vijnë prapa mjetit të tij.

4. Lëvizja prapa ndalohe:

4.1. në autoudhë dhe në motoudhë;

4.2. në vendkalime hekurudhore, në vendkalime të këmbësorëve dhe në vendkalime të biçikletave;

4.3. në kryqëzime të padukshme dhe në pjesë të rrugës me fushëpamje të kufizuar;

4.4. gjatë kohës me dukshmëri të dobësuar;

4.5. aty ku ndalohe ndalja;

4.6. aty ku pengohet dhe rrezikohet trafiku rrugor.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 53 **Përshtatja e shpejtësisë**

1. Shoferi duhet t'ua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psikofizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna - brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht, të mund të veprojë me kohë.

2. Shoferit nuk i lejohet që pa shkaqe të arsyeshme të lëvizë me mjet aq ngadalë sa që të shkaktojë pengesë ose rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

3. Kur shpejtësia e lëvizjes së mjetit të përshkruar në paragrafin 2. të këtij neni është përgjysmë më e vogël sesa shpejtësia e lejuar për atë rrugë ose për atë pjesë të saj, shoferi i atij mjeti duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit, përveç nëse e shfrytëzon dritën vezulluese rrotulluese.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 54 **Detyrimet e shoferit gjatë drejtimit**

1. Shoferi është i detyruar:

1.1. ta drejtojë mjetin me atë shpejtësi që nuk e pengon lëvizjen e mjeteve të tjera;

1.2. të mbajë distancë të nevojshme nga mjete përpara aq sa është e nevojshme për t'iu shmangur goditjes së mjetit, nëse mjete përpara frenon apo ndalet;

1.3. të mos e rrisë vullshëm shpejtësinë, përkatësisht të mos niset nga vendi në atë mënyrë që të shkaktojë rrëshqitje dhe rrotullim të rrotave në vend, duke bërë zhurmë pa nevojë dhe kështu t'i shqetësojë pjesëmarrësit e tjerë në trafik, veçmas këmbësorët;

1.4. të mos bëjë gara shpejtësie;

1.5. të mos frenojë vullshëm, përveç në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe atë duke i paralajmëruar pjesëmarrësit e tjerë në trafik me sinjalizim të dritave të frenimit dhe me të gjithë treguesit e drejtimit ose duke dhënë shenjë përkatëse me dorë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nën-paragrafëve 1.1 ose 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nën-paragrafëve 1.3, 1.4. ose 1.5. të paragrafit 1. të këtij neni dhe atij i shqiptohet një (1) pikë negative.

Neni 55

Shpejtësia e lëvizjes brenda zonës urbane

1. Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonës urbane është pesëdhjetë (50) km/h, në qoftë se me shenja të trafikut nuk është e përcaktuar ndryshe.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) euro, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi mbi pesëdhjetë (50) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej së paku një (1) viti, si dhe i shqiptohen pesë (5) pikë negative.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi tridhjetë (30) km/h deri në pesëdhjetë (50) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik gjashtë (6) muaj deri në dymbëdhjetë (12) muaj, si dhe i shqiptohen tri (3) pikë negative.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi njëzet (20) km/h deri në tridhjetë (30) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi dhjetë (10) km/h deri në njëzet (20) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi pesë (5) km/h deri në dhjetë (10) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

7. Dëshmia për tejkalim të shpejtësisë sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni duhet të bëhet nëpërmjet pajisjeve të avancuara teknologjike, përmes të cilave konstatohet tejkalimi i shpejtësisë me të dhëna të sakta për automjetin.

Neni 56

Shpejtësia më e madhe e lejuar jashtë zonës urbane

1. Në rrugë jashtë zonës urbane shoferit nuk i lejohet që të lëvizë me mjet me shpejtësi më të madhe sesa është e caktuar me shenjë të trafikut, e më së shumti:

1.1. në autoudhë - njëqind e tridhjetë (130) km/orë;

1.2. në motoudhë - njëqind e dhjetë (110) km/h;

1.3. në rrugë nacionale me dy shirita për një kah me ndarje fizike të shiritave rrugorë - njëqind (100) km/h;

1.4. në rrugë nacionale me një shirit të trafikut për një kah, në rrugë rajonale dhe në rrugë lokale - tetëdhjetë (80) km/h.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, shoferi i cili jashtë zonës urbane lëviz me mjet mbi pesëdhjetë (50) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe i shqiptohen tri (3) pikë negative.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili jashtë zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi tridhjetë (30) km/h deri në pesëdhjetë (50) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut. Përveç gjobës, atij i shqiptohen dy (2) pikë negative.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi njëzet (20) km/h deri në tridhjetë (30) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i cili brenda zonës urbane lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi dhjetë (10) km/h deri në njëzet (20) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

Neni 57

Kufizimi i shpejtësisë

1. Shpejtësia e lëvizjes sipas kategorive të mjeteve në rrugët e tjera, përveç në autoudhë e në motoudhë, kufizohet:

1.1. në tetëdhjetë (80) km/h, për mjetet e transportit me masën më të madhe të lejuar deri në shtatmijë e pesqind (7500) kg, për autobusë, për autobusë me rimorkio të lehtë dhe për automjete të cilat tërheqin rimorkio për kampim;

1.2. në shtatëdhjetë (70) km/h, për autobusët që kryejnë transport të organizuar të fëmijëve, për autobusët nyjorë pa vendqëndrim në këmbë, për mjetet e transportit me masën më të madhe të lejuar mbi shtatëdhjetë e pesëqind (7500) kg, për mjete të transportit me mjete të bashkëngjitura dhe për mjete të cilat transportojnë materie të rrezikshme;

1.3. në pesëdhjetë (50) km/h, për autobusë me rimorkio për transportim të njerëzve, për autobusë urbanë, për autobusë në të cilët përpos ulëseve të montuara, ka vende për qëndrim në këmbë, si dhe për mjete të transportit të cilat kryejnë transport grupor të njerëzve;

1.4. në dyzet (40) km /h, për traktorin klasik, si dhe për mjetin i cili e tërheq mjetin tjetër të prishur;

1.5. në njëzet (20) km/h, për trenin turistik.

2. Në rastet kur mjetet lëvizin në autoudhë e në motoudhë, ndryshe nga dispozita e paragrafit

1. të këtij neni, shpejtësia për këto automjete kufizohet:

2.1. në njëqind (100) km/h, për autobusë me masën më të madhe të lejuar mbi dymbëdhjetë mijë (12000) kg, përveç autobusëve të cilët transportojnë grupe të organizuara fëmijësh;

2.2. në tetëdhjetë e pesë (85) km /h, për mjetet e transportit me masën më të madhe të lejuar mbi dymbëdhjetë mijë (12000) kg, përveç mjeteve të cilat transportojnë materie të rrezikshme;

2.3. në tetëdhjetë (80) km/h, për mjetet e transportit me mjete të bashkëngjitura.

3. Kur drejtohet mjete i përcaktuar me dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, shoferët janë të detyruar t'i përmbahen shpejtësisë së lëvizjes sipas dispozitave të paragrafit 1., respektivisht 2. të këtij neni edhe në rrugë në të cilën me këtë ligj ose me shenjë të trafikut është lejuar shpejtësi më e madhe.

4. Shoferët e mjeteve të cilat e kanë kufizimin e shpejtësisë sipas kategorisë së mjeteve, janë të obliguar që ta vendosin shenjën e kufizimit të shpejtësisë në anën e prapme të mjetit, në vend të dukshëm. Kjo vlen edhe për mjetet të cilat nuk mund të lëvizin me shpejtësi më të madhe se tridhjetë (30) km/h.

5. Kamionët mbi tremijë e pesëqind (3500) kg., si dhe autobusët, duhet ta kenë kufizuesin e shpejtësisë, siç parashihet në legjislacionin përkatës.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili lëviz me mjet me shpejtësi prej mbi dhjetë dhjetë (10) km/h deri në tridhjetë (30) km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili lëviz me mjet me shpejtësi mbi tridhjetë (30)km/h mbi shpejtësinë e lejuar, të përcaktuar me rregulla të përgjithshme ose me shenjë të trafikut.

Neni 58

Kufizimi i shpejtësisë nga ana e autoriteteve

1. Me përjashtim nga dispozita e përcaktuar me paragrafin 1. të nenit 55 të këtij ligji, Ministria ose Komuna, në bashkëpunim me PK-në, mund ta zvogëlojë ose ta rrisë shpejtësinë e kufizuar brenda zonës urbane me anë të shenjave përkatëse të trafikut.
2. Shpejtësia më e madhe e lejuar e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund të zvogëlohet, nëse kushtet e sigurisë mungojnë në një rrugë të caktuar ose në një segment të saj.
3. Shpejtësia më e madhe e lejuar e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund të rritet, nëse kushtet e trafikut në një rrugë të caktuar ose në një segment të saj e mundësojnë këtë, pa e cenuar sigurinë në trafik, por vetëm deri në tetëdhjetë (80) km/h.
4. Ministria ose Komuna, në bashkëpunim me Policinë, me anë të shenjave përkatëse të trafikut mund ta zvogëlojë shpejtësinë e kufizuar jashtë zonës urbane, në rrugë ose në një segment të saj, nëse kushtet e trafikut e kërkon këtë.

Neni 59

Kthimi

1. Shoferi i mjetit që kthehet djathtas duhet ta bëjë kthimin duke lëvizur nëpër shiritin e skajshëm të trafikut që shtrihet përgjatë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.
2. Shoferi i mjetit që kthehet majtas duhet ta bëjë kthimin nëpër shiritin e majtë të skajshëm të trafikut që shtrihet pranë vijës së mesit dhe nëpër harkun e paramenduar ose të shënuar që lidh dy vijat e mesit të sipërfaqeve anësore të rrugës, përkatësisht nëpër shiritin e trafikut që shtrihet përgjatë skajit të majtë të rrugës në trafik me rrugë me një kah, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.
3. Rregullat në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nuk zbatohen, nëse dimensionet e mjetit nuk e mundësojnë kthimin sipas kësaj rregulle.
4. Gjatë kthimit djathtas, shoferi është i detyruar t'i lëshojë mjetet që lëvizin nga ana e tij e djathtë nëpër shiritin e trafikut për mjetet e transportit publik.
5. Shoferit nuk i lejohet ta bëjë kthimin gjysmërrethor me mjet:
 - 5.1. në tunele, në ura;
 - 5.2. në nënkalime dhe në mbikalime;
 - 5.3. në kushtet e dukshmërisë së dobësuar, përkatësisht të fushëpamjes së pamjaftueshme të rrugës;
 - 5.4. në pjesën e rrugës me gjerësi të pamjaftueshme;
 - 5.5. nëse gjatë kthimit kalon në sipërfaqen e ngritur të rrugës;

5.6. në rrugë me një kah;

5.7. ku ndalohet me shenjë trafiku.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 60

Rregulla e krahut të djathtë

1. Gjatë afrimit të një kryqëzimi me rëndësi të njëjtë, kur kryqëzimi nuk është i rregulluar me shenja të trafikut, shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të veçantë dhe t'i japë përparësi mjetit që vjen nga krahu i tij i djathtë.

2. Kur shoferi i mjetit në kryqëzim rrugësh kthehet majtas, ai është i obliguar t'i japë përparësi mjetit i cili duke ardhur nga krahu i kundërt në kryqëzim lëviz drejt ose kthehet djathtas, përveç në qoftë se me shenjat e trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.

3. Ndryshe nga rregullat e përcaktuara në paragrafin 1. e 2. të këtij neni, mjeteve të cilat lëvizin nëpër binarë ka përparësi kalimi në të gjitha rastet, përveç nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.

4. Ndërmjet mjeteve të cilat në kryqëzim me semaforë në të njëjtën kohë e kanë kalimin të lirë, vlen rregulla e krahut të djathtë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 61

Rruga me përparësi kalimi

1. Shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë me përparësi kalimi, është i obliguar t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat qarkullojnë në atë rrugë.

2. Kur mjetet që lëvizin në kryqëzim nëpër rrugën me përparësi kalimi nga kahu i kundërt, në rast se lëvizjet e tyre ndërpriten, vlen rregulla e krahut të djathtë.

3. Rregulla e krahut të djathtë vlen edhe nëse mjetet lëvizin nëpër rrugën dytësore nën kushtet e paragrafit 2. të këtij neni.

4. Shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë nga sipërfaqja në të cilën nuk zhvillohet trafik publik, qoftë ajo rrugë dheu, oborr, depo, fabrikë apo të ngjashme, duhet t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin nëpër rrugën ku hyn edhe atëherë kur kjo rrugë nuk është e shënuar si rrugë me përparësi kalimi.

5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 62
Vendkalimi i biçikletave

1. Shoferi i mjetit i cili i afrohet vendkalimit të caktuar për biçikleta, duhet të ketë kujdes të veçantë dhe t'i japë përparësi biçiklistit i cili gjendet në vendkalim.
2. Shoferi i mjetit i cili me rastin e kthimit të mjetit e pret shtegun ose shiritin për biçikleta, duhet t'iu japë përparësi kalimi mjeteve që lëvizin nëpër shiritin ose shtegun për biçikleta.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 63
Trafiku në kryqëzim

1. Kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai duhet të lëvizë me kujdes të shtuar, në mënyrë që t'iu përshtatet kushteve të trafikut në kryqëzim dhe ta kuptojë mënyrën e rregullimit të trafikut në kryqëzim.
2. Kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai është i obliguar të lëvizë me shpejtësi të tillë që të mund të ndalet dhe t'i lëshojë pjesëmarrësit e trafikut të cilët kanë përparësi kalimi në kryqëzim.
3. Shoferi i mjetit është i detyruar që në largësi të mjaftueshme para kryqëzimit ta marrë drejtimin me mjet në atë shirit të trafikut nëpër të cilin duhet ta lëshojë kryqëzimin.
4. Kur në kryqëzim mjetet vijnë nga kahe të kundërta dhe kthehen majtas, qendrën e kryqëzimit e kanë nga ana e vet e djathtë.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 64
Ndalimi i hyrjes në kryqëzim

1. Shoferit me mjet nuk i lejohet hyrja në kryqëzim nëse dendësia e trafikut është e tillë që në rast se do të ndalet në kryqëzim ose në vendkalim të këmbësorëve, ai do ta pengojë ose do ta pamundësojë trafikun e mjeteve të cilat vijnë nga rrugët anësore të kryqëzimit ose lëvizjen e këmbësorëve.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 65
Përballëkalimi

1. Shoferi obligohet që gjatë përballëkalimit të mbajë distancë të sigurt anësore në mes mjetit të tij dhe mjetit ose pjesëmarrësit tjetër në trafik që është duke kaluar përballë dhe, nëse është e nevojshme, të shmanget në anën e djathtë të rrugës ose të ndalet për të mundësuar përballëkalim të sigurt.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i cili me mjet vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 66

Përparësia e kalimit gjatë përballëkalimit

1. Kur përballëkalimi i mjeteve është i pamundur si pasojë e punimeve në rrugë, si pasojë e ndonjë mjeti të ndaluar ose të ndonjë pengese tjetër në rrugë, shoferi i mjetit i cili e ka pengesën në kahun e tij të lëvizjes duhet ndalet për t'i dhënë përparësi kalimi mjetit që vjen nga kahu i kundërt i rrugës.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 67

Përballëkalimi në pjerrtësi

1. Në rrugë me pjerrtësi, ku përballëkalimi me mjete të tjera është i vështirë ose i pamundur, shoferi i mjetit që lëviz teposhtë duhet të ndalet dhe të pozicionohet sa më afër skajit të rrugës, në mënyrë që t'ia mundësojë përballëkalimin mjetit i cili lëviz përpjetë.

2. Shoferi i mjetit që lëviz përpjetë duhet ta ndalë mjetin e vet në rast se para vetes ka vend të përshtatshëm për ndalim, për ta mundësuar përballëkalimin e sigurt të mjetit që lëviz teposhtë.

3. Në rrugë me pjerrtësi në të cilën përballëkalimi është i vështirësuar ose i pamundur, kurse njëri nga mjetet detyrohet të lëvizë prapa me qëllim të mundësimi të qarkullimit, këtë duhet ta bëjë:

3.1. çdo mjet i cili takohet me mjetin që tërheq mjet të bashkëngjitur;

3.2. mjeti i lehtë i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë;

3.3. mjeti transportues i cili takohet me autobusin;

3.4. mjeti i cili lëviz teposhtë, në qoftë se mjetet janë të së njëjtës kategori.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 68

Detyrimet e shoferit për tejkalim

1. Para fillimit të tejkalimit, shoferi duhet të sigurohet se:

1.1. ekziston fushëpamje dhe hapësirë e mjaftueshme që ta bëjë veprimin e tejkalimit pa i penguar dhe pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor;

1.2. shoferi i mjetit që lëviz prapa tij nuk e ka filluar veprimin e tejkalimit;

1.3. shoferi që ndodhet në mjetin përpara tij në të njëjtin shirit të trafikut nuk ka dhënë shenjë se ka për qëllim ta tejkalojë ndonjë mjet tjetër, ta ndryshojë drejtimin e lëvizjes apo ta ndërrojë shiritin e trafikut;

1.4. në rrugë ka hapësirë të mjaftueshme për realizim të plotë të tejkalimit, duke e pasur parasysh diferencën ndërmjet shpejtësisë së tij dhe të mjetit që tejkalohet, si dhe distancën dhe shpejtësinë e mjeteve që vijnë nga krahu i kundërt;

1.5. pas tejkalimit nuk do të bëjë manovrime të rrezikshme dhe të kthehet sa më parë që të jetë e mundur në shiritin e trafikut në të cilin ka lëvizur para tejkalimit, pa e penguar ose rrezikuar mjetin të cilin e tejkalon.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 69

Distanca anësore e sigurisë

1. Gjatë tejkalimit shoferi i mjetit duhet të ushtrojë kujdes të veçantë dhe të mbajë distancë të sigurt anësore ndaj mjetit të cilin e tejkalon ose ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

2. Në rast të tejkalimit të mjetit me dy rrota ose të kolonës së këmbësorëve, distanca anësore e sigurisë duhet të jetë së paku 1.5 metra.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 70

Dispozitat e tejkalimit

1. Tejkalimi i mjetit bëhet nga ana e majtë.

2. Tejkalimi i mjetit mund të bëhet nga ana e djathtë, ndryshe nga dispozita e paragrafit 1. të këtij neni, por vetëm në këto raste:

2.1. kur mjeti tjetër, i cili ndodhet përpara mjetit në të njëjtin kah, në rrugë ka zënë pozitë pranë skajit të majtë të shiritit dhe shoferi i tij jep sinjal për kthim në anën e majtë;

2.2. pranë mjetit i cili lëviz nëpër binarë të vendosur në mes të rrugës, në qoftë se midis atij mjeti dhe skajit të djathtë të rrugës ekziston shirit i trafikut.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe një (1) pikë negative.

Neni 71**Detyrimet e shoferit, mjeteve të cilin tejkalohe**

1. Shoferi, të cilin është dhënë sinjal se mjeteve pas tij po synon ta tejkalojë mjeteve nga krahu i tij i majtë, duhet t'iu përmbahet këtyre rregullave:

1.1. duhet ta largojë mjeteve e tij kah skaji i djathtë i rrugës;

1.2. nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë gjatë kohës gjersa tejkalohe.

2. Shoferi i cili tejkalohe nga ana e djathtë e tij duhet të veprojë njësoj sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjeteve të cilin vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjeteve me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe një (1) pikë negative.

Neni 72**Vendet ku ndalohet tejkalimi**

1. Ndalohet tejkalimi:

1.1. në vendet ku është e ndaluar me shenja të trafikut;

1.2. drejtpërdrejt para vendkalimit hekurudhor, në vendkalim ose mbi binarë në të njëjtin nivel;

1.3. drejtpërdrejt para dhe në vendkalim të këmbësorëve;

1.4. drejtpërdrejt para dhe në vendkalim të biçiklistëve;

1.5. në shiritin për nxitim;

1.6. në shiritin për ngadalësim;

1.7. në shiritin për ndalje të detyrueshme;

1.8. para dhe në kurriz rrugë, para dhe në kthesë të padukshme, përveç në rrugën qarkulluese që ka më së paku dy shirita të trafikut për lëvizje të mjeteve në një kah;

1.9. nëse kalohet me mjete përtej vijës së plotë të pandërprerë gjatësore, duke e shfrytëzuar shiritin e trafikut të paraparë për lëvizjen e mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt;

1.10. ndryshe nga dispozita që parasheh nënparagrafi 1.9. i këtij paragrafi, gjatë tejkalimit lejohet të kalohet me mjete përtej vijës së plotë të pandërprerë gjatësore vetëm në rastet kur tejkalimi bëhet pranë mjeteve pa motor dhe pranë mjeteve me

veprim motorik të cilat nuk zhvillojnë shpejtësi mbi tridhjetë (30)km/h, si traktorët, motokultivatorët, mopedët etj.;

1.11. në tunel, përveç nëse ekzistojnë dy ose më tepër shirita të trafikut në një kah.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe dy (2) pikë negative.

Neni 73

Ndalim i tejkalimit të mjeteve

1. Ndalohet tejkalimi i këtyre mjeteve:

1.1. i mjeteve nën përcjellje dhe me përparësi kalimi kur ato janë në intervenim;

1.2. i kolonës së mjeteve;

1.3. i mjetit i cili është ndalur ose është duke u ndalur për shkak lëshimit të këmbësorëve në rrugë.

2. Tejkalimi ndalohet edhe në këto situata:

2.1. nëse me këtë veprim do të rrezikohet siguria e trafikut ose do të pengohet trafiku nga kahu i kundërt;

2.2. nëse pas kryerjes së tejkalimit apo anashkalimit, mjete nuk mund të kthehet në shiritin e trafikut nga i cili ka lëvizur më parë pa i penguar ose pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe dy (2) pikë negative.

Neni 74

Situatat kur lejohet tejkalimi në kryqëzim

1. Shoferit nuk i lejohet ta tejkalojë mjetin tjetër drejtpërdrejt para kryqëzimit dhe në kryqëzim i cili nuk është me rrethrotullim, përveç në këto situata:

1.1. kur mjete tjetër i cili ndodhet përpara mjetit kthehet majtas, kurse tejkalohe nga ana e djathtë;

1.2. kur gjatë tejkalimit të mjetit tjetër që kthehet djathtas, me mjetin e vet nuk kalon në pjesën e rrugës së paraparë për trafikun nga kahu i kundërt;

1.3. kur mjeti lëviz në rrugë me përparësi kalimi;

1.4. në kryqëzim në të cilin trafiku rregullohet me semaforë ose nga personi i autorizuar.

2. Shoferit të mjetit i lejohet ta tejkalojë biçikletën, mopedin ose motoçikletën pa rimorkio anësore drejtpërdrejt para kryqëzimit dhe në kryqëzim i cili nuk është me rrethrotullim.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe një (1) negative.

Neni 75

Lëvizja në rreshta paralele

1. Në rrugë në të cilën ekzistojnë të paktën dy shirita të trafikut të paraparë për qarkullim të mjeteve që lëvizin në kahe të njëjta dhe në të cilën ndodhet kolonë e mjeteve, shoferit nuk i lejohet me mjet të kalojë nga një shirit në shiritin tjetër. Shoferi mund ta lëshojë shiritin në të cilin ndodhet vetëm në rastet kur pozicionohet që të kthehet në anën e majtë ose në anën e djathtë, apo për parkim të mjetit.

2. Në rrugët brenda zonës urbane sipas kushteve të paragrafit 1. të këtij neni, lëvizja më e shpejtë e mjetit në një shirit sesa në shiritin tjetër, si dhe kalimi pranë mjetit që lëviz ngadalë e që nuk e shfrytëzon shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut, nuk konsiderohet tejkalim.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 76

Mjetet që lëvizin ngadalë

1. Nëse për shkak të gjerësisë së pamjaftueshme të rrugës ose të gjendjes së saj nuk është i mundur tejkalimi pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik, shoferi i mjetit që lëviz më ngadalë sesa mjeti që lëviz drejtpërsëdrejti pas tij, është i detyruar që ta largojë mjetin e tij sa më djathtas dhe, nëse është e nevojshme, të ndalet në qoftë se prapa tij formohet kolona më tepër se pesë (5) mjete. dhe të ndalet sa më shpejt që të jetë e mundur, d.m.th., sapo t'i jepet mundësia e parë që ta ndalë mjetin e vet në një vend të përshtatshëm, në mënyrë që t'i lëshojë mjetet e shpejta ta tejkalojnë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 77

Anashkalimi

1. Në qoftë se në mes të rrugës ndodhet ishulli për këmbësorë, ose është e shënuar hapësira për parkim të mjeteve, ose është ndonjë sipërfaqe tjetër që nuk është e caktuar për trafik të mjeteve, ose është ndonjë objekt a mekanizëm tjetër, - atëherë shoferi i mjetit duhet t'i anashkalojë ato nga ana e djathtë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 78

Anashkalimi nga ana e majtë

1. Në qoftë se sipërfaqet, objektet a mekanizmat nga paragrafi 1. i nenet 77 të këtij ligji ndodhen në mes të rrugës me një kah, shoferi i mjetit mund t'i anashkalojë ato nga ana e djathtë ose e majtë, në qoftë se me shenja të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 79

Sinjalet paralajmëruese të dritës dhe zërit

Shoferi i mjetit duhet të japë sinjale zëri apo drite kur është e domosdoshme për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit e tjerë mbi rrezikun në rrugë.

Neni 80

Rastet kur ndalohet përdorimi i sinjaleve të zërit dhe dritës

1. Ndalohet:

1.1. të keqpërdoren sinjalet e zërit dhe dritës;

1.2. të jepen sinjale zëri brenda zonës urbane, përveç në rast rreziku të drejtpërdrejtë;

1.3. t'i paralajmërojë pjesëmarrësit e tjerë të trafikut nën kushtet kur shoferët e tjerë do t'i ekspozohen dritës verbuese.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 81

Sinjalet paralajmëruese të zërit

1. Shoferi obligohet që t'i përdorë sinjalet paralajmëruese të zërit kur e kërkon nevoja e sigurisë së trafikut, sidomos:

1.1. në rrugë jashtë zonës urbane, për ta paralajmëruar pjesëmarrësin tjetër në trafik që dëshiron të tejkalojë ose të anashkalojë, kur mosdhënia e këtij sinjali do të rrezikonte shkaktim të aksidentit në trafik;

1.2. në qoftë se pranë rrugës gjenden fëmijë të cilët nuk i kushtojnë vëmendje qarkullimit të mjeteve;

1.3. në rrugë jashtë zonës urbane, në të cilat përballëkalimi është i vështirësuar, si

p.sh: para hyrjes në kthesa të padukshme dhe të ngushtuara, para arritjes në kurriz e në situata të ngjashme.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 82

Sinjalet paralajmëruese të dritës

1. Prej muzgut të parë deri në agimin e plotë, shoferi i mjetit, në vend të sinjalit të zërit për paralajmërim, si rregull e përdor sinjalin e paralajmërimit me drita. Këtë sinjal shoferi i mjetit mund ta përdorë edhe në zonën urbane, gjatë tejkalimit të mjetit tjetër.

2. Sinjalin e paralajmërimit me drita shoferi i mjetit mund ta përdorë edhe ditën, në qoftë se mënyra e tillë e paralajmërimit u përshtatet më mirë rrethanave në rrugë.

3. Sinjali i paralajmërimit me dritë jepet duke i ndezur në intervale të shkurtra të njëpasnjëshme dritat e gjata, duke i ndezur në mënyrë të njëpasnjëshme dritat e shkurtra për ndriçim të rrugës ose duke i ndezur në mënyrë alternative, në intervale të shkurtra dritat e gjata dhe dritat e shkurtra.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 83

Ndezja e të gjithë tregueseve të drejtimit

1. Shoferi i mjetit në rrugë publike është i detyruar t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit - nëse në mjet janë të instaluara - si në vijim:

1.1. gjatë kohës së hyrjes apo daljes së udhëtarëve;

1.2. nëse i paralajmëron pjesëmarrësit e tjerë në trafik për rrezikun në trafik;

1.3. gjatë kohës së dukshmërisë shumë të vështirësuar, si pasojë e mjegullës së dendur, tymit e të ngjashme;

1.4. nëse është mjeti i fundit i ndalur në kolonën e cila është e ndalur në rrugë jashtë zonës urbane, përveç nëse kolona është e ndalur të veprjë sipas dispozitave apo shenjave të trafikut;

1.5. gjatë drejtimit mbrapa;

1.6. nëse ndalet në rrugë qarkulluese, përveç me rastin e parkimit në vendin e shënuar, përkatësisht për të vepruar sipas rregullave apo shenjave të trafikut.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 84
Ndalja dhe parkimi

1. Shoferit nuk i lejohet ta ndalë dhe ta parkojë mjetin në vendin ku do ta rrezikonte sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në trafik ose do ta pengonte zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 85
Ndalja e mjetit pran skajit të djathtë të rrugës

1. Shoferi i cili e ndal ose e parkon mjetin në rrugë publike është i detyruar ta ndalë, përkatësisht ta parkojë atë sa më pranë cepit të djathtë të sipërfaqes së rrugës qarkulluese.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 86
Mjetet e papërdorura

1. Në rrugë, në vende, përkatësisht në hapësira të përcaktuara për ndalje dhe parkim, si dhe në sipërfaqet e ndërtruara të trafikut të parapara për lëvizje të këmbësorëve, nuk lejohet lënia e mjeteve të papërdorshme, të paregjistruara ose të ngjashme, as të mjeteve të bashkëngjitura të cilat shfrytëzohen vetëm për kohësisht dhe as çfarëdo gjëje tjetër që do ta pengojë rrjedhën normale të trafikut.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 87
Shenjat rrugore për parkim

1. Shoferi i mjetit duhet ta përdorë mënyrën e ndaljes së mjetit siç tregohet me shenja të trafikut rrugor.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 88
Dalja e personave nga mjete

1. Shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të shtuar gjatë daljes së udhëtarëve nga mjete, posaçërisht fëmijëve, ashtu që dalja të bëhet nga ana ku nuk lëvizin mjetet, nga ana e trotuarit apo të ngjashme.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 89**Detyrimet e shoferit gjatë ndaljes ose parkimit**

1. Me rastin e ndaljes ose parkimit të mjetit në rrugë jashtë zonës urbane, mjete duhet të ndalet ose të parkohet jashtë rrugës qarkulluese.
2. Shoferi i cili për shkak të defektit në mjet, aksidentit të trafikut ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm ka qenë i detyruar ta ndalë mjetin në rrugë, duhet t'i marrë të gjitha masat në mënyrë që mjeti i ndalur në rrugë të mos e pengojë ose të mos e rrezikojë trafikun dhe është i obliguar që menjëherë ta largojë mjetin nga rruga.
3. Shoferi i cili për shkak të defektit në mjet, aksidentit në trafik ose për ndonjë arsye tjetër ka qenë i detyruar ta ndalë mjetin mbi binarë, detyrohet menjëherë ta largojë atë nga binaret. Nëse një gjë e tillë nuk është e mundur, atëherë ai duhet t'i marrë të gjitha masat në mënyrë që të lajmërohet me kohë personi i cili e drejton mjetin mbi binarë.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 90**Pengimi i trafikut me dyer të mjetit**

1. Në mjetin e ndalur ose të parkuar nuk lejohet hapja e dyerve, nëse me këtë pengohet lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë në trafik ose rrezikohet siguria në trafik.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 91**Ndalja dhe parkimi në trotuar**

1. Lejohet parkimi i mjetit në trotuar me dy rrotat anësore apo me rrotat e një boshti të mjetit të udhëtarëve, motoçikletës, triçikletës, katërçikletës, mopedit, dhe biçikletës, me kusht që:
 - 1.1. gjerësia e trotuarit që mbetet në dispozicion të këmbësorëve të jetë e mjaftueshme për lëvizjen e lirë të këmbësorëve; ajo nuk duhet të jetë më e vogël se 1,6 metra dhe nuk duhet të jetë pranë skajit të djathtë të rrugës qarkulluese;
 - 1.2. mjeti, të cilit boshti i përparmë i vendoset në trotuar, nuk e pengon qarkullimin rrugor.
2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni, lejohet parkimi në trotuar afër skajit të rrugës vetëm në vendin e shënuar me shenja të trafikut rrugor.
3. Shoferi mund ta parkojë mjetin e vet në vendet që ndodhen në mes të sipërfaqes së rrugës, vetëm kur këto vende janë të shënuara si vendparkim me shenja të trafikut rrugor.
4. Nëse pranë skajit të djathtë të rrugës gjenden binarët e tramvajit ose binarët e trenit, shoferi mund ta ndalë ose ta parkojë mjetin në anën e majtë të rrugës.

5. Në rrugë në një kah shoferi mund ta parkojë mjetin në dy anët e rrugës, nëse me këtë ligj ose me shenja të trafikut nuk përcaktohet ndryshe.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili e ndal ose e parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 92

Vendet ku ndalohet ndalja e mjetit

1. Është e ndaluar ndalja e mjetit në këto vende:

1.1. në kthesë të padukshme dhe në kurriz;

1.2. në tunel, në nënkalim e mbikalim, mbi urë, si dhe në distancë më të vogël se pesëmbëdhjet (15) metra nga vendet e përmendura;

1.3. mbi binarët e tramvajit ose të hekurudhës në të njëjtin nivel me rrugën dhe në afërsi të tyre, nëse pengohet lëvizja e mjetit mbi binarë;

1.4. në kryqëzim dhe në largësi më të vogël se pesë (5) metra nga skaji më i afërt i rrugës tërthore;

1.5. në shtegun dhe shiritin për biçikleta;

1.6. në vendndalim të autobusëve ose në sipërfaqe të zgjeruar jashtë shiritit për qarkullim të mjeteve që kryejnë transport publik të udhëtarëve, e të cilat vende janë të përcaktuara me shenja përkatëse të trafikut;

1.7. në vendkalim të këmbësorëve, në vendkalim të biçikletave, si dhe në distancë më të vogël se pesë (5) metra para vendkalimit të tillë;

1.8. në rrugë, përgjatë vijës së bardhë të plotë dhe në afërsi të pikave të përfundimit të tyre, nëse kjo do t'i detyronte shoferët e tjerë që gjatë drejtimit të mjetit ose bashkësisë së mjeteve të kalojnë mbi atë vijë;

1.9. në distancë më të vogël se dhjetë (10) metra nga ana e përparme e shenjës apo sinjalit të trafikut, nëse mjete do ta mbulonin pamjen e tyre;

1.10. në rrugë ku shiritat rrugorë janë ndarë fizikisht ndërmjet vetes, vetëm nëse janë të lejuara me shenja të trafikut;

1.11. në shtegun e këmbësorëve, përkatësisht në pjesën e trotuarit i cili është i paraparë për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara;

1.12. në sipërfaqen në të cilën ndalohet qarkullimi i mjeteve sipas shenjave të trafikut rrugor;

1.13. në skajin së majtë të rrugës, me përjashtim të ndaljes apo parkimit brenda zonës urbane në rrugë në një kah dhe rasteve sipas paragrafit 4. të nenit 91 të këtij ligji;

- 1.14. në brezin ndarës ndërmjet shiritave rrugorë;
- 1.15. në vendin e rezervuar për parkim të mjetit për personat me aftësi të kufizuara;
- 1.16. në trotuar, me përjashtim të dispozitave të nenit 91 të këtij ligji;
- 1.17. në pjesën e rrugës ku gjerësia e kalimit të lirë prej mjetit të ndalur ose të parkuar deri te vija e plotë gjatësore e mesit e shënuar në rrugë do të ishte më e vogël se tri (3) metra, përkatësisht deri te skaji tjetër i rrugës më e vogël se katër (4) metra.

2. Në zonën e FSK-së ndalohet ndalja dhe parkimi i mjeteve pa autorizim të veçantë nga FSK-ja.

3. Ndryshe nga dispozita e nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni, shoferit të taksisë me veturë deri në katër (4) ulëse, duke mos e përfshirë edhe ulësen e shoferit, i lejohet ndalja në shiritin e trafikut për mjete të transportit publik në të cilin nuk lëviz mjeti nëpër binarë, dhe atë vetëm për kohën derisa hyjnë apo dalin udhëtarët.

4. Ndalohet qëndrimi i mjetit taksi për të pritur për t'i marrë udhëtarët sipas paragrafit 3. të këtij neni.

5. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me ndaljen dhe parkimin nuk aplikohen për zyrtarë të Policisë në kryerjen e punës së tyre zyrtare.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili e ndal ose e parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) deri në katërqind e pesëdhjetë (450) euro, shoferi i mjetit taksi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 4. të këtij neni.

Neni 93

Vendet ku ndalohet parkimi i mjetit

1. Ndalohet parkimi i mjeteve në këto vende:

- 1.1. në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga garazhi, nga porta, apo të ngjashme dhe ku mund ta pengojë trafikun;
- 1.2. në vendin ku shkakton pengesë për mjetin tjetër për t'u parkuar apo për të dalë nga vendparkimi;
- 1.3. në pjesën e rrugës para kalimit të rrugës në nivel me vijën hekurudhore ose me vijën e tramvajit në një largësi më të vogël se pesëmbëdhjetë (15) metra nga këto kalime;
- 1.4. brenda zonës urbane, mjeti apo bashkësia e mjeteve me masën më madhe të lejuar mbi 3.500 kg apo me gjatësi që i tejkalon dymbëdhjetë (12) metra, jashtë vendit të përcaktuar me shenjë si parkim për këto mjete;

1.5. në distancë më të vogël se pesëmbëdhjetë (15) metra para ose mbrapa vendndalimit të autobusit apo shenjës së trafikut që e shënon këtë vendndalim;

1.6. në hyrje të rrugëve të lagjeve, në kalimet ndërmjet ndërtesave, përkatësisht në hyrje apo në dalje të blloqeve të banesave;

1.7. në rrugët jashtë vendparkimeve të cilat i lidhin hapësirat e parkimit me ndërtesat e banimit dhe me rrugë të tjera;

1.8. mbi kapakët e rrjetit të ujësjellësit, të kanalizimit ose të rrjeteve të tjera të shërbimeve komunale, apo të ngjashme.

2. Në mungesë të shoferit të mjetit i cili është ndaluar ose është parkuar në një vend të ndaluar, Policia bën fotografimin e mjetit dhe ia lë njoftimin shoferit në mjet, me anën e të cilit njoftim shoferi obligohet të paraqitet në stacionin e Policisë për veprime të mëtutjeshme.

3. Nëse shoferi nga paragrafi 2. i këtij neni nuk paraqitet në Polici, Polici merr masa të duhura ndaj pronarit të mjetit me veprim motorik, duke i shfrytëzuar të dhënat nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve.

4. Pronari i mjetit nga paragrafi 2. i këtij neni nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit, apo ndërrimin e pronarit, pa e bërë pagesën e gjobave të përcaktuara sipas dispozitave të paragrafit 2. të këtij ligji.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili e parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 94

Zhvendosja e mjetit

1. Nëse mjete është i ndaluar ose i parkuar në rrugë në kundërshtim me nenet 92 dhe 93 të këtij ligji dhe nëse me këtë rast paraqet pengesë për rrjedhën e trafikut, pjesëtarët e Policisë ose personat e tjerë të autorizuar me ligj urdhërojnë që mjete të zhvendoset nga ai vend në ndonjë vend tjetër.

2. Mjetet të cilat janë ndaluar ose janë parkuar dhe paraqesin pengesë për rrjedhën e trafikut mund të bllokohen ose të largohen nga vendi.

3. Para se personi i autorizuar ta japë urdhëresën për zhvendosjen e mjetit sipas paragrafit 1. të këtij neni, pozita e mjetit të ndaluar ose të parkuar në mënyrë të parregullt dëshkohet me fotografi dhe me skicë.

Neni 95

Zbatimin e urdhëresës për zhvendosjen e mjetit

1. Zbatimin e urdhëresës për zhvendosjen e mjetit nga nenet 93 dhe 94 i këtij ligji e bën Policia.

2. Policia e bën zhvendosjen e mjeteve të cilat janë ndaluar ose janë parkuar në kundërshtim me dispozitat e neneve 92 ose 93 të këtij ligji, përmes mjeteve të veta ose përmes personit juridik

të kontraktuar nga Ministria apo nga Komuna për zhvendosjen e mjeteve.

3. Policia përcakton mënyrën e zhvendosjes së mjeteve të cilat ndalen ose parkohen kundër dispozitave të nenit 92 dhe 93 të këtij ligji, ndërsa Komuna e përcakton vendin ku do të qëndrojnë përkohësisht mjetet e zhvendosura.

Neni 96

Afati për tërheqjen e mjetit të zhvendosur

1. Në qoftë se mjeti i zhvendosur nuk kërkohet nga pronari brenda gjashtë (6) muajsh, mjeti do të shitet me ankand publik dhe të hollat shkojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, përveç mjeteve që janë në proces të hetimeve penale.

2. Nëse mjeti pas tri (3) ankandeve publike nuk mund të shitet, i njëjti duhet të trajtohet në bazë të një vendimi të cilin e nxjerr një komision i veçantë i cili formohet nga komuna përkatëse, nga Policia dhe nga Dogana e Kosovës.

Neni 97

Shpenzimet e zhvendosjes së mjetit

1. Shpenzimet e zhvendosjes së mjetit dhe të qëndrimit të mjetit në vendin e caktuar nga neni 95 i këtij ligji i bart shoferi, përkatësisht pronari i mjetit.

2. Shumën e shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve e përcakton Policia në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për Financa.

Neni 98

Shenjimi i mjetit të ndalur në defekt

1. Nëse mjeti ose mjeti i bashkëngjitur - përveç mopedit, motoçikletës pa rimorkio anësore, triçikletës, triçikletës së lehtë - është i ndalur në rrugë qarkulluese për shkak të prishjes, aksidentit ose për ndonjë arsye tjetër, shoferi duhet që ta vendosë prapa mjetit të ndalur trekëndëshin e sigurisë me të cilin shënohet ndalja e mjetit në rrugë, dhe atë në këto rrugë:

1.1. në autoudhë, në motoudhë;

1.2. në rrugë jashtë zonës urbane, me rastin e ndaljes në rrugë në vendin ku kjo ndalohet, nëse mjeti nuk mund të shihet nga një distancë e mjaftueshme;

1.3. në rrugë brenda zonës urbane, me rastin e ndaljes në rrugë në vendin ku ndalja dhe parkimi ndalohet sipas neneve 92 dhe 93 të këtij ligji.

2. Ndalja e mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të shënohet si në vijim:

2.1. në autoudhë ose në motoudhë, me anë të vendosjes së trekëndëshit të sigurisë prapa automjetit, në distancë prej së paku njëqind (100) metrash dhe duke i ndezur të gjithë treguesit e drejtimit; nëse mjeti nuk është i pajisur me të gjithë treguesit e drejtimit, atëherë ai duhet t'i ndezë dritat e pozicionit;

2.2. në rrugë nacionale, rajonale dhe lokale jashtë zonës urbane, me anë të vendosjes

së trekëndëshit të sigurisë në distancë prej tridhjetë (30) deri në pesëdhjetë (50) metra prapa mjetit dhe duke i ndezur të gjithë treguesit e drejtimit; nëse treguesit nuk janë në dispozicion, atëherë ai duhet t'i ndezë dritat e pozicionit;

2.3. brenda zonës urbane me anë të ndezjes së të gjithë treguesve të drejtimit dhe, nëse treguesit nuk janë në dispozicion, duke i ndezur dritat e pozicionit dhe duke e vendosur trekëndëshin e sigurisë prapa mjetit në distancë prej së paku dhjetë (10) metrash.

3. Shënimi i mjetit të përmendur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni është i detyrueshëm gjatë tërë kohës së ndalimit të mjetit.

4. Në të njëjtën mënyrë sikurse në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, duhet të shënohen edhe kolona e mjeteve, bashkësia e mjeteve dhe mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme, vetëm se në vend të një trekëndëshi të sigurisë vendosen dy trekëndësha të sigurisë.

5. Trekëndëshi i sigurisë vendoset në rrugën qarkulluese prapa mjetit në pozitë vertikale, ashtu që mjetet që vijnë nga kahu i mjetit të ndalur të mund ta vërejnë me kohë shenjën dhe, sipas nevojës, ta ndalin mjetin e tyre, përkatësisht ta anashkalojnë në mënyrë të sigurt mjetin e ndalur.

6. Nëse mjeteve është i ndalur prapa kthesës, trekëndëshi i sigurisë vendoset para kthesës.

7. Nëse shoferi gjendet jashtë mjetit të vet në rrugën qarkulluese, ai është i detyruar ta mbajë jelekun reflektues.

8. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 99

Detyrimet e shoferit para se të largohet nga mjeteve

1. Para se të largohet nga mjeteve, shoferi i cili e lë mjetin në rrugë është i detyruar t'i marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që mjeteve mos të lëvizë vetë nga vendi ose që personat e paautorizuar të vënë atë në lëvizje: të fiket motori, të mbyllen dritaret dhe dyert, çelësat ti marrë me veti ose të ngjashme.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 100

Ndërprerja e kolonës së këmbësorëve

1. Shoferit nuk i lejohet ta ndërpresë me mjet kolonën e fëmijëve, të ushtarëve, të funeraleve ose çfarëdo kolone tjetër të organizuar të këmbësorëve që lëvizin rrugës.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 101**Tërheqja e mjeteve të bashkëngjitura dhe e qerreve**

1. Në trafikun rrugor publik, me përjashtim në autoudhë dhe në motoudhë, mjetit mund t'i bashkëngjiten më së shumti:

1.1. dy mjete të bashkëngjitura për transport të mallrave;

1.2. një mjet i bashkëngjitur për transport të personave.

2. Mjetit i lejohej ta tërheqë vetëm mjetin e bashkëngjitur që nuk e zvogëlon stabilitetin e tij.

3. Nëse automjeti i cili e ka të instaluar pajisjen nyjore EURO për tërheqje të mjetit të bashkëngjitur, kjo pajisje duhet të hiqet kur mjeti merr pjesë në trafikun rrugor dhe kur nuk tërheq mjet të bashkëngjitur.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 102**Tërheqja e mjetit të bashkëngjitur në autoudhë**

1. Në autoudhë dhe në motoudhë automjetit mund t'i bashkëngjitet vetëm një mjet i bashkëngjitur.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) euro, shoferi i automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Për kundërvajtje të përpara me këtë nen dënohet me gjobë prej pesëqind (500) deri një mijë e pesëqind (1.500) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 103**Qerrja që tërhiqet nga traktori**

1. Në trafikun rrugor, traktori mund ta tërheqë qerren e cila është e rregulluar për t'u tërhequr nga traktori.

2. Qerrja e cila tërhiqet nga traktori në trafikun rrugor duhet t'i ketë gomat të fryra dhe duhet të jetë e pajisur me drita të kuqe mbrapa.

3. Qerrja e cila tërhiqet nga traktori në trafikun rrugor duhet jetë e lidhur me ndihmën e lidhjes nyjore, ashtu që gjatë drejtimit ta sigurojë stabilitetin e dy mjeteve dhe ta pamundësojë shkëputjen e tyre.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 104

Mjetet e bashkëngjitura që tërhiqen nga biçikleta dhe nga mopedi

1. Në trafikun rrugor, biçikletës dhe mopedit i lejohe të tërheqë mjet të bashkëngjitur me dy rrota, të përforcuar në atë mënyrë që nuk e zvogëlon stabilitetin e mjetit.

2. Mjeti i bashkëngjitur sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk lejohe të jetë më i gjerë se tetëdhjetë (80) cm, ndërsa masa e përgjithshme nuk lejohe të jetë mbi pesëdhjetë (50) kg. Në pjesën e pasme duhet t'i ketë dy katadiopterë të paraparë për mjetin e bashkëngjitur.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 105

Tërhiqja e mjetit të prishur ose në defekt

1. Shoferi i mjetit mund ta tërheqë mjetin tjetër, përveç mjeteve të bashkëngjitura, vetëm nëse mjeti tjetër nuk mund të lëvizë vetë për shkak të prishjes apo në mungesë të ndonjë pjese.

2. Mjeti në defekt mund të tërhiqet me litar apo me pajisje të ngurtë, duke u mbështetur ose duke u varur në mjetin tërheqës.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 106

Detyrimet gjatë tërheqjes së mjetit në defekt

1. Në mjetin e tërhequr si rezultat i prishjes ndalohet transporti i personave.

2. Me mjet nuk lejohe tërheqja e motoçikletës pa rimorkio anësore, e mopedit, si dhe e triçikletës së lehtë dhe të rëndë, të cilat janë në defekt.

3. Mjeti i cili tërhiqet duhet të jetë i lidhur për mjetin që e tërheq, në atë mënyrë që të përjashtohet mundësia e shkëputjes së tyre gjatë lëvizjes.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 107

Shenjimi i mjeteve gjatë tërheqjes

1. Gjatë kohës së tërheqjes së mjetit të përcaktuar nga neni 105 i këtij ligji, të dy mjetet duhet të jenë të shënuara me trekëndëshin e sigurisë.

2. Në mjetin i cili tërheq, trekëndëshi vendoset në pjesën e përparme, ndërsa në mjetin e tërhequr në anën e prapme.
3. Në të dy mjetet, të parapara në nenin 105 të këtij ligji, gjatë tërheqjes duhet të jenë të ndezur të gjithë treguesit e drejtimit, nëse janë të instaluar në mjet.
4. Nëse mjeti i paraparë në nenin 105 të këtij ligji nuk i ka të instaluar të gjithë treguesit e drejtimit, ai është i detyruar t'i ndezë dritat e pozicionit.
5. Distanca në mes dy mjeteve mund të jetë më e vogël se tri (3) metra kur përdoret lidhja e ngurtë, ndërsa gjatë lidhjes me litar duhet të jetë prej tri (3) deri në pesë (5) metra.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 108

Rastet ku ndalohet tërheqja e mjetit në defekt

1. Ndalohet tërheqja me litar:
 - 1.1. e mjetit, nëse sistemi i tij i frenimit dhe i drejtimit është jashtë funksionit;
 - 1.2. e mjeteve transportuese dhe e autobusëve;
 - 1.3. e mjetit, nëse për funksionim të sistemit të frenimit të mjetit që tërhiqet, nevojitet që motori të punojë, ndërsa motori është jashtë funksionit.
2. Ndalohet tërheqja me lidhje të fortë:
 - 2.1. e mjetit, i cili mjet e ka jashtë funksionit sistemin e drejtimit;
 - 2.2. e mjetit, i cili është më i rëndë se mjeti që e tërheq, nëse mjeti që tërhiqet nuk e ka në rregull frenin punues.
3. Ndalohet tërheqja e mjetit në autoudhë, me përjashtim të tërheqjes kur prishja ka ndodhur gjatë drejtimit nëpër autoudhë deri në daljen e parë nga autoudha;
4. Ndalohet tërheqja e më shumë se një mjeti, me përjashtim të bashkësisë së mjeteve;
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 109

Kushtet për tërheqjen e mjetit në defekt

1. Nëse mjeti tërhiqet me ndihmën e litarit apo lidhjes së fortë, shoferi i cili e drejton mjetin që tërhiqet duhet të ketë patentë shoferi për drejtimin e asaj kategorie të mjetit të cilit i takon mjeti i cili tërhiqet.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 110

Tërhiqja e mjetit në kushtet e dukshmërisë së vështirësuar

1. Gjatë dukshmërisë së vështirësuar lejohet tërheqja e mjetit në defekt vetëm nëse i ka të ndezura prapa dritat e kuqe për shenjtim të mjetit, d.m.th. dritat e pozicionit, ose nëse tërheqjen e bën mjeti i cili e përdor dritën e verdhë vezulluese rrotulluese.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 111

Tërheqja e mjetit transportues dhe e bashkësisë së mjeteve

1. Tërheqja e mjetit të transportit ose e bashkësisë së mjeteve të ngarkuara në defekt lejohet deri te vendi i parë i përshtatshëm për ngarkim-shkarkim, ndërsa në raste të jashtëzakonshme deri te vendi i parë ku mund të mënjanohet defekti i mjetit.

2. Në rast të tërheqjes së një mjeti në mënyrë të tillë që nuk ka nevojë për ta drejtuar ose për t'i përdorur frenat, masa e përgjithshme të mjetit që tërhiqet nuk mund të jetë më e madhe se masa e përgjithshme e mjetit që e tërheq.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 112

Përdorimi i dritave në trafik

1. Në automjetin që merr pjesë në trafikun rrugor duhet të jenë të ndezura dritat si vijon:

1.1. Automjetet, përveç mopedëve dhe motoçikletave pa rimorkio anësore, duhet t'i kenë së paku dy drita të bardha në pjesën e përparme dhe dy drita të kuqe në pjesën e pasme;

1.2. mopedi dhe motoçikleta pa rimorkio anësore duhet t'i kenë të paktën një dritë të bardhë në pjesën e përparme dhe të paktën një dritë të kuqe në pjesën e pasme;

1.3. kur automjeti tërheq një ose dy mjete të bashkëngjitura, në pjesën e pasme të mjetit të fundit të bashkëngjitur duhet të jenë të ndezura të paktën dy drita të kuqe, e në qoftë se gjerësia e mjetit të bashkëngjitur është më e madhe se 1,60 metra, në pjesën e përparme të mjetit të parë të bashkëngjitur duhet të jenë të ndezura dy drita të bardha.

2. Automjeti i cili merr pjesë në trafikun rrugor duhet t'i ketë në rregull sistemin e sinjalizimit dhe të ndriçimit, të pozicionit, dritat e shkurtra, dritat e gjata, dritat e mjegullës, treguesit e drejtimit, gabaritet, dritat e tabelës dhe të ngjashme.

3. Përdorimi i dritave në automjetin i cili është i pajisur me teknologji të avancuar bëhet siç parashihet

nga prodhuesi i automjetit, në përputhje me standardet e përcaktuara.

4. Nuk lejohet vendosja e çfarëdo drite para ose mbrapa automjetit që nuk është e paraparë me këtë ligj, e as vendosja e dritave shtesë pa leje të veçantë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 3. ose 4. të këtij neni.

Neni 113

Rastet kur mjeti nuk duhet t'i ketë të ndezura dritat

1. Ndryshe nga dispozitat e nenit 112 të këtij ligji, këto mjete nuk duhet t'i kenë të ndezura dritat:

1.1. mjeti i ndaluar ose i parkuar në pjesën e ndriçuar të rrugës që shihet qartë nga një largësi e mjaftueshme;

1.2. mjeti i ndaluar ose i parkuar në vende të caktuara në rrugë ose jashtë rrugës, ose në rrugë me intensitet të dobët të trafikut;

1.3. biçikleta, mopedi dhe motoçikleta pa rimorkio anësore e cila nuk ka bateri, kur janë të ndalura ose të parkuara brenda zonës së banuar, pranë skajit të djathtë të rrugës qarkulluese.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 114

Dritat e parkimit

1. Mjetet te të cilat gjatësia nuk i kalon tetë (8) metra dhe gjerësia dy (2) metra dhe të cilat nuk kanë të bashkëngjitur mjet tjetër, kur është i ndaluar ose i parkuar në rrugë brenda zonës së banuar, në vend të dritave siç parashihen në nenin 112 të këtij ligji duhet të ketë të ndezur një dritë e cila nga ana e përparme shihet si e bardhë dhe një dritë nga ana e pasme si e kuqe, d.m.th. duhet të ketë të ndezura dritat e parkimit dhe të aktivizuara në anën e kundërt nga skaji i rrugës në të cilën mjeti është i ndaluar ose i parkuar.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 115

Përdorimi i dritave

1. Për ndriçim të rrugës, shoferi i automjetit përdor dritat e gjata.

2. Dritat e shkurtra përdoren në rastet vijuese:

2.1. gjatë përballëkalimit, kur mjete tjetër vjen përballë dhe kur njëri nga shoferët e mjetit i ndal dritat e gjata dhe i ndez dritat e shkurtra;

2.2. kur ekziston mundësia që ta pengojë nga prapa shoferin e mjetit përpara;

2.3. në afërsi të mjetit që lëviz nëpër binarë, të mjetit që lundron ose të ngjashme;

2.4. gjatë kohës derisa kalon pranë kolonës të organizuar të këmbësorëve;

2.5. në pjesën e rrugës me ndriçim rrugor.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit që i përdor dritat për ndriçim të rrugës në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 116

Dritat gjatë drejtimit ditën

1. Shoferi i automjetit duhet t'i ketë të ndezura dritat e shkurtra ose dritat e ditës gjatë tërë kohës së drejtimit.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk i përdor dritat sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 117

Dritat gjatë drejtimit nëpër mjegull

1. Kur ka mjegull shoferi i automjetit duhet t'i ketë të ndezura në mjet dritat e shkurtra ose ato për mjegull, ose të dy llojet e dritave në të njëjtën kohë.

2. Dritat për mjegull lejohet të përdoren vetëm kur ka mjegull ose në rast të dukshmërisë së vështirësuar.

3. Dritat për mjegull të cilat gjinden në pjesën e përparme mund të jenë të bardha ose të verdha, ndërsa në pjesën e pasme me ngjyrë të kuqe.

4. Shoferi i automjetit mund t'i përdorë dritat e mjegullës kur dukshmëria është më e vogël se pesëdhjetë (50) metra. Kur dukshmëria të përmirësohet, shoferi i mjetit duhet t'i ndalë këto drita menjëherë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili i përdor dritat për mjegull në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 118

Dritat e pozicionit

1. Gjatë gjithë kohës së lëvizjes, automjeti duhet t'i ketë të ndezura edhe dritat e pozicionit, përveç dritave të zakonshme për ndriçim të rrugës, respektivisht atyre të veçanta për mjegull.

2. Në rast se mjete nuk ka drita të radhitura në nenin 112 të këtij ligji, në vend të tyre, shoferi i mjetit duhet t'i përdorë ato drita me të cilat është i pajisur mjete.
3. Dispozitat nga neni 112 të këtij ligji nuk zbatohen gjatë ndaljes së mjetit e cila vjen për shkak të dispozitave të trafikut rrugor.
4. Nëse ndalja në kolonë zgjat më shumë se një (1) minutë, lejohet të ndalen dritat e shkurtra të mjetit nëse para dhe pas tij në të njëjtin shirit të trafikut janë të ndalura mjete të tjera.
5. Dritat e pozicionit në mjet mund të ndizen gjatë qëndrimit, gjatë ndaljes apo në parkim, me kusht që ato nuk i pengojnë pjesëmarrësit e tjerë në trafik.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk i përdor dritat e pozicionit sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 119

Dritat në mjetet me veprim motorik

1. Për të gjitha mjetet me veprim që janë pajisur me drita, aplikohen dispozitat prej nenit 112 deri në nenin 118 të këtij ligji.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili i përdor dritat në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 120

Distanca në mes të mjeteve

1. Shoferi i mjetit është i detyruar ta mbajë distancën e sigurisë kur lëviz pas mjetit tjetër, duke e pasur parasysh shpejtësinë e lëvizjes, gjendjen, llojin dhe fushëpamjen e rrugës, dukshmërinë, kushtet atmosferike, gjendjen e ngarkesës, gjendjen e vet psikofizike, gjendjen e sistemit frenues etj., në mënyrë që të mos e rrezikojë sigurinë e trafikut, ashtu që në rast se mjete para tij frenon apo ndalet, shoferi të mund ta ndalë mjetin në mënyrë të sigurt.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk e mban distancën e sigurisë ndaj mjetit sipas dispozitave të këtij neni, nëse kjo dëshmohet nga organi kompetent.

Neni 121

Distanca e sigurisë të mjeteve të rënda

1. Kur në rrugën publike jashtë zonës urbane me vetëm një shirit të trafikut që shërben për qarkullim të mjeteve në një drejtim, lëvizin njëra pas tjetrës automjete me masën maksimale të lejuar mbi tremijë e pesqind (3500) kilogramë ose me gjatësi më të madhe se shtatë (7) metra, shoferët e mjeteve janë të detyruar të mbajnë largësi prej së paku njëqind (100) metrash ndërmjet këtyre mjeteve.
2. Kur në rrugë publike jashtë zonës urbane lëvizin në varg dy ose më tepër mjete që bartin materie të rrezikshme, distanca ndërmjet këtyre mjeteve duhet të jetë së paku dyqind (200) metra.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili nuk e mban distancën e sigurisë sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 122

Trafiku i mjeteve në binarë

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për qarkullim të tramvajeve dhe mjeteve të tjera të cilat lëvizin rrugëve nëpër binarë, përveç nëse vetitë konstruktive nuk e lejojnë një gjë të tillë.

Neni 123

Makinat e punës dhe traktorët

1. Në trafikun rrugor makina e punës dhe traktori lejohet të tërheqin edhe mjete dhe vegla të bashkëngjitura të cilat shërbejnë për qëllimin e tyre.

2. Ndalohet qarkullimi në trafikun rrugor për kategori të caktuara të makinave të punës, si: ngarkuesit, ngarkuesit me pirun, buldozerët e bagerët me rrota e zinxhirë, traktorët me zinxhirë, cilindrat e të ngjashme, përveç në rrugën ose në pjesën e rrugës ku zhvillohen punimet ose, në raste të veçanta, me leje të lëshuar nga organi kompetent.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton rregulla për ndalimin dhe kufizimin e qarkullimit të makinave të punës dhe çështje të tjera lidhur me to.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 124

Rregullat e trafikut për biçiklistë

1. Shoferi i biçikletës (në tekstin më tutje: biçiklisti), gjatë drejtimit duhet ta shfrytëzojë shiritin për biçikleta ose shtegun e përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë.

2. Biçiklisti, gjatë shfrytëzimit të shtegut të përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë, duhet të ketë kujdes të shtuar dhe t'u japë përparësi këmbësorëve.

3. Kur nuk ekziston shtegu apo shiriti për biçikleta ose shtegu i përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë, biçiklisti duhet ta shfrytëzojë bankinën dhe nëse kjo nuk është e mundshme, ta shfrytëzojë shiritin e djathtë, duke lëvizur sa ma afër skajit të djathtë në distancë deri në një (1) metër.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, biçiklisti i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 125

Mosha e biçiklistit

1. Fëmijës më të ri se dymbëdhjetë (12) vjeç nuk i lejohet ta drejtojë biçikletën në rrugë publike.
2. Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1. të këtij neni, në zonat e këmbësorëve, në zonën e trafikut të qetë, në zonën me kufizim të shpejtësisë në tridhjetë (30)km/h, në zonën e shkollës, në rrugët e pakategorizuara, biçikletën mund ta drejtojë edhe fëmija i cili i ka mbushur nëntë (9) vjet.
3. Në zonën e këmbësorëve dhe në zonën e trafikut të qetë biçikletën mund ta drejtojë fëmija më i ri se nëntë (9) vjeç nëse është nën mbikëqyrje të personit mbi gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, prindi ose kujdestari nëse biçiklisti vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 126

Vendkalimi për biçiklistë

1. Në vendkalimin për biçiklistë, biçiklistit i ndalohet të hyjë ashpër para mjetit që vjen apo ta ngadalësojë e ta ndalojë biçikletën pa arsye.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i biçikletës i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 127

Detyrimet e biçiklistit

1. Biçiklistit i lejohet shfrytëzimi i trotuarit ose shtegut për këmbësorë në raste të veçanta, kur personi kujdeset për fëmijën deri në moshën dhjetë (10) vjeçare që është duke drejtuar biçikletën.
2. Shoferi i biçikletës i cili e shfrytëzon trotuarin ose shtegun e këmbësorëve, duhet të drejtojë ngadalë, të ushtrojë kujdes të veçantë dhe t'u japë përparësi këmbësorëve.
3. Biçikleta duhet ta ketë të ndezur një dritë ngjyrë të bardhë në pjesën e përparme dhe një dritë ngjyrë të kuqe, katadiopter me materie retroreflektuese në pjesën e pasme gjatë drejtimit natën dhe gjatë drejtimit ditën kur dukshmëria është e vështirësuar.
4. Kur biçiklisti qarkullon në rrugë publike gjatë pashmërisë të zvogëluar, ai është i detyruar të ketë jelek reflektues, rroba reflektuese për biçiklistë apo ndonjë burim drite.
5. Biçiklisti më i ri se gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç duhet ta mbajë helmetën mbrojtëse gjatë drejtimit.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i biçikletës i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 128

Kufizimi i drejtimit të biçikletës, mopedit, motoçikletës dhe triçikletës

1. Personit i cili drejton biçikletë, moped, motoçikletë dhe triçikletë i ndalohet:
 - 1.1. të drejtojë pa e mbajtur timonin me dy duar, përveç në raste kur jep shenjë me dorë;
 - 1.2. pa i mbajtur këmbët në pedale ose në mbështetëse të këmbëve;
 - 1.3. të mbahet ose të tërhiqet nga mjete të tjera;
 - 1.4. ta lëvizë mjetin krahas mjetit tjetër;
 - 1.5. të bartë çfarëdo ngarkese nëse kështu pengohen apo rrezikohen pjesëmarrësit e tjerë në trafik;
 - 1.6. të përdorë dëgjuese të pajisjeve audio, duke i vendosur në dy ose në një vesh;
 - 1.7. të manovrojë me një rrotë.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 129

Përdorimi i helmetës

1. Shoferi i cili drejton moped, motoçikletë, triçikletë a katërçikletë pa kabinë mbrojtëse, si dhe personat të cilët barten në këto mjete, duhet të mbajnë helmata mbrojtëse përkatëse, të rregullta, dhe gjatë qarkullimit në rrugë t'i përdorin ato sipas udhëzimeve të prodhuesit të helmetës.
2. Shoferit të mjeteve nga paragrafi 1. të këtij neni nuk i lejohet të transportojë persona të cilët janë nën ndikim të alkoolit, të drogës ose të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike, ose persona të cilët për ndonjë arsye tjetër nuk janë në gjendje t'i kontrollojë veprimet e veta.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi dhe personat të cilët barten në këto mjete nëse gjatë qarkullimit në rrugë nuk e bartin helmetën mbrojtëse ose nuk e përdorin atë sipas udhëzimeve të prodhuesit të helmetës mbrojtëse.

Neni 130

Qarkullimi i qerreve dhe lëvizja e bagëtive

1. Shoferi i qerres gjatë drejtimit duhet ta mbajë mjetin nën kontroll, duke e drejtuar me fre ose duke i grahur kafshës tërheqëse pranë ose përpara, ashtu që qerrja të lëvizë sa më afër skajit të djathtë të rrugës.
2. Distanca në mes qerreve që lëvizin në rrugë duhet të jetë së paku njëqind (100) metra.

3. Në qerre që qarkullojnë në rrugë publike lejohet të lidhen më së shumti dy kafshë në anën e djathtë të pjesës së prapme.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i qerres i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 131

Hyrja në rrugë publike me qerre

1. Shoferi i qerres me rastin e hyrjes në rrugë publike është i detyruar ta mbajë për frenash njërën kafshë në rastet vijuese:

- 1.1. në vendet ku fushëpamja e rrugës është e kufizuar;
- 1.2. kur dukshmëria është e vështirësuar;
- 1.3. gjatë kalimit nëpër rrugë rajonale dhe nacionale;
- 1.4. gjatë kalimit në vendkalim hekurudhor;
- 1.5. në vendkalimet për këmbësorë dhe për biçiklistë ose të ngjashme;
- 1.6. në pjesë të rrezikshme të rrugës.

2. Në rrugë publike qerres i lejohet ta tërheqë edhe një qerre tjetër e cila duhet të jetë nën mbikëqyrje të përcjellësit.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 132

Detyrimet e shoferit të qerres

1. Shoferit të qerres i ndalohet:

- 1.1. ta mbingarkojë qerren;
- 1.2. ta lërë qerren të lëvizë vetë;
- 1.3. ta drejtojë qerren pa zile ose pa vinç për frenim;
- 1.4. ta lërë qerren në rrugë, pa mbikëqyrje.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i cili gjatë drejtimit të qerres vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 133
Kushtet e drejtimit të qerres

1. Qerren në rrugë mund ta drejtojë personi i cili i ka së paku katërmbëdhjetë (14) vjet.
2. Ndalohet të drejtohet qerrja nga personi i cili nuk është i aftë, i cili është nën ndikim të alkoolit, të drogës, të narkotikëve apo të substancave që ndikojnë në aftësitë psikofizike.
3. Gjatë lëvizjes natën ose gjatë lëvizjes ditën kur dukshmëria është e vështirësuar, qerrja duhet ta ketë të ndezur një dritë me ngjyrë të bardhë në pjesën e përparme dhe një dritë me ngjyrë të kuqe në pjesën e pasme të anës së majtë.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 134
Lëvizja e kafshëve

1. Në të gjitha rrugët publike është i ndaluar qëndrimi, braktisja dhe të ushqyerit e kafshëve.
2. Në rrugë nacionale dhe regjionale nuk bën të lëvizin kafshët në grupe me qëllim që të dërgohen për kullosë ose për ndonjë qëllim tjetër.
3. Kafshët mund të lëvizin në rrugë vetëm nën mbikëqyrje të përcjellësit, dhe atë sa më afër skajit të djathtë të rrugës qarkulluese.
4. Nëse kafshët përcillen dhe tërhiqen në rrugë publike, përcjellësi e ka për detyrë të sigurojë që gjysma e majtë e rrugës të jetë e lirë për qarkullim.
5. Në rast aksidenti të trafikut me kafshë pa përkujdesje, nëse konstatohet se shoferi nuk është shkaktar i aksidentit, përgjegjësia bie mbi pronarin e kafshës.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1., 2., 3. apo 4. të këtij neni.
7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni.

Neni 135
Lëvizja e kafshëve në grupe

1. Lëvizjen e kafshëve në grup ose veç e veç nëpër rrugë publike mund ta bëjë vetëm personi i cili duke e pasur parasysh moshën dhe gjendjen psikofizike mund t'i ketë nën kontroll vazhdimisht kafshët dhe mund t'i marrë të gjitha masat që të evitohet rreziku.
2. Nëse kafshët grahen në rrugën publike në grupe të mëdha, grahësit e kanë për detyrë që t'iu grahin në grupe të ndara, në mënyrë që t'iu sigurojnë shoferëve tejkalim të sigurt.

3. Gjatësia e grupit të kafshëve nuk lejohet të jetë më e madhe se pesëdhjetë (50) metra, ndërsa në mes dy ose më shumë grupe duhet të ekzistojë distancë e lirë së paku prej pesëdhjetë (50) metrash.
4. Përtej rrugës e cila nuk ka kalime të rregulluara ose të përcaktuara, kafshët mund ta kalojnë rrugën vetëm në pjesë të dukshme të rrugës.
5. Në rrugët rajonale dhe nacionale kalimin e kafshëve matanë rrugës duhet ta sigurojnë së paku dy grahës, të cilët duhet të gjinden njëri nga njëra anë, e tjetri nga ana tjetër e rrugës.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 136

Lëvizja e kafshëve në kushte të dukshmërisë së vështirësuar

1. Kur kafshët grahen natën ose ditën gjatë dukshmërisë së vështirësuar, grahësit e kafshëve duhet ta mbajnë një dritë me ngjyrë të kuqe e cila duhet të jetë e dukshme për pjesëmarrësit e tjerë në trafik në distancë prej së paku njëqind e pesëdhjetë (150) metrash.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, grahësi i kafshëve i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 137

Mosha e grahësve të kafshëve

1. Në rrugët rajonale dhe lokale grahja e kafshëve mund të bëhet nga personi i cili i ka së paku dhjetë (10) vjet.
2. Në rrugët nacionale personit mbi moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç i lejohet t'iu grahë më së shumti dy kafshëve, duke lëvizur në krahun e djathtë të rrugës në drejtim të lëvizjes.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, prindi ose kujdestari i grahësit, nëse grahësi vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 138

Rasti kur ndalohet grahja e kafshëve

1. Ndalohet:
 - 1.1. t'iu grahë kafshëve aty ku ndalohet me dispozita dhe me shenja të trafikut;
 - 1.2. t'iu grahë kafshëve përtej rrugës në një vend që nuk është i dukshëm nga një distancë e mjaftueshme;
 - 1.3. t'i ndalë kafshët në rrugë;
 - 1.4. të zërë me kafshë më shumë hapësirë nga ana e djathtë e rrugës, të shtegut të

këmbësorëve apo të biçiklistëve, që pengon trafikun.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 139

Kalorësi

1. Grahja e kafshëve që kalërohen ose që bartin ngarkesë bëhet në shtegun e përcaktuar për lëvizje të kafshëve.

2. Në rast se nuk ekziston shteg për lëvizje të kafshëve, kafshët mund të lëvizin edhe në rrugë të tjera, duke mos i penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

3. Për lëvizje të kalorësit në rrugë qarkulluese aplikohen të gjitha dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me lëvizje të biçiklistit.

4. Ndalohet kalërimi ose grahja e kafshës nën këto kushte:

4.1. pa fre;

4.2. aty ku ndalohet me rregulla dhe me shenja të trafikut;

4.3. në rrugë publike gjatë kohës me dukshmëri të vështirësuar pa ndonjë burim drite ose pa materie reflektuese;

4.4. në rrugët rajonale dhe lokale nga personi i cili është nën moshën dhjetë (10) vjeç.

5. Kalorësit i lejohet të tërheqë vetëm një kafshë në anën e djathtë të tij.

6. Ministria apo Komuna i përcaktojnë me akt nënligjor rregullat e lëvizjes së kafshëve, ndalimin e drejtimit të kafshëve në rrugë të caktuara apo në zona të caktuara brenda një kohe specifike, si dhe qarkullimin e qerreve për transport të mallrave dhe njerëzve apo të ngjashme, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili i vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 140

Dispozitat për lëvizje të këmbësorëve

1. Këmbësorit nuk i lejohet të lëvizë as të ndalet në rrugë.

2. Si rregull, këmbësorit nuk i lejohet të lëvizë e të ndalet as në ishuj të trafikut dhe të këmbësorëve, në kryqëzime, gjegjësisht në rrugë publike ku pengohen ose rrezikohen vetë ata dhe pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

3. Në rrugën qarkulluese janë të ndaluara lojërat dhe lëvizja me pajise të ndryshme etj.

4. Iu ndalohet këmbësorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë ta shfrytëzojnë trotuarin në atë mënyrë që e pengojnë lëvizjen e lirë, si: qëndrimi ulur apo shtrirë në trotuar, shfrytëzimi i trotuarit për aktivitete të tjera përveçse për lëvizje të këmbësorëve. Përgjithësisht bëjnë vetëm rastet me leje paraprake nga organi kompetent.

5. Këmbësori është i detyruar që ta përdorë trotuarin ose shtegun për këmbësorë.

6. Nëse nuk ka trotuar ose shteg të këmbësorëve, ose nëse ai nuk mund të përdoret përkohësisht, këmbësori mund ta përdorë rrugën qarkulluese, në atë mënyrë që para se të hyjë në rrugë të vërtetohet se nuk e pengon trafikun, duke lëvizur sa më afër skajit të rrugës dhe, kur është e nevojshme, duke ua lëshuar rrugën mjeteve që vijnë.

7. Gjatë qarkullimit në rrugë publike, këmbësorët janë të obliguar të lëvizin njëri pas tjetrit, përveç personit i cili e shoqëron fëmijën më të ri se shtatë (7) vjeç ose personit në përcjellje të personit me aftësi të kufizuara.

8. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

9. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 4. të këtij neni.

Neni 141

Lëvizje jashtë zonës urbane

1. Këmbësori i cili ec në rrugë jashtë zonës urbane duhet ta shfrytëzojë anën e majtë të rrugës në kah të lëvizjes dhe gjatë kohës së pashmërisë së zvogëluar ta mbajë ndonjë mjet ose pajisje reflektuese apo burim drite, si: jelek reflektues, rroba reflektuese, bateri e të ngjashme.

2. Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1. të këtij neni, këmbësorit i lejohet lëvizja pranë skajit të djathtë të rrugës nëse lëvizja është më e sigurt për të, si: kthesë e padukshme, humnerë, vend i gërmuar, shembje gurësh apo të ngjashme

3. Në rrugë jashtë zonës urbane fëmija deri në moshën shtatë (7) vjeç lejohet ta shfrytëzojë rrugën vetëm nën mbikëqyrje të personit që është së paku i moshës dhjetë (10) vjeçe.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, prindi ose kujdestari nëse fëmija vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 142

Kalimi i rrugës nga ana e këmbësorëve

1. Këmbësori gjatë kalimit të rrugës obligohet që të ketë kujdes të posaçëm dhe gjithherë ta shfrytëzojë vendkalimin e këmbësorëve atëherë kur ai ekziston.

2. Këmbësori është i detyruar ta kalojë rrugën qarkulluese, shiritin ose shtegun për biçikleta me

kujdes të shtuar duke kaluar rrugës më të shkurtër dhe duke u vërtetuar para se ta fillojë kalimin e rrugës se këtë mund ta bëjë në mënyrë të sigurt.

3. Gjatë kalimit të rrugës, të shiritit apo të shtegut të biçikletave ose të binarëve, këmbësorit nuk i lejohej përdorimi i telefonit mobil, shfrytëzimi i dëgjueseve në veshë apo i pajisjeve të tjera të ngjashme që mund ta hutojnë.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 143

Vendkalimi për këmbësorë

1. Në rrugë e cila ka vendkalim të këmbësorëve ose kalime të veçanta të ndërtuara për këmbësorë, këmbësori është i detyruar të lëvizë nëpër këto kalime, nëse ato nuk janë të larguara nga ai më shumë se pesëdhjetë (50) metra në zona urbane, përkatësisht njëqind (100) metra jashtë zonës urbane.

2. Kalimi i rrugës jashtë vendkalimit të këmbësorëve sipas paragrafit 1. të këtij neni lejohej me kusht që nuk e pengon qarkullimin e mjeteve. Këmbësori obligohet që t'u japë përparësi mjeteve dhe ta kalojë rrugën duke e shfrytëzuar rrugën më të shkurtër, nën kënd të drejtë me vijën e mesit të rrugës.

3. Brenda zonës urbane, në rrugën me dy shirita rrugorë të ndarë në mes veti fizikisht, këmbësori obligohet që ta shfrytëzojë vetëm vendkalimin e paraparë për këmbësorë.

4. Nëse vendkalimi i këmbësorëve gjendet në rrugë me dy shirita rrugorë, kalimi i secilit shirit rrugor konsiderohet si vendkalim i ndarë. Kjo zbatohet gjithashtu edhe në vendkalimet e këmbësorëve, në vendet ku qarkullimi i mjeteve është i ndarë me anë të një pjese të ngritur, ose me ndonjë pajisje tjetër teknike të trafikut.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 144

Ndalimi ose kufizimi i lëvizjes së këmbësorit

1. Këmbësorit i ndalohej:

1.1. të hyjë në rrugë drejtpërdrejt para mjetit në lëvizje, duke përfshirë këtu edhe hyrjen në vendkalim të këmbësorëve, të afrohet prapa mjetit ose prapa ndonjë pengese tjetër që e kufizon fushëpamjen e rrugës;

1.2. ta kalojë rrugën në vendin ku fushëpamja e rrugës është e kufizuar;

1.3. ta ngadalësojë shpejtësinë e të ecurit ose të ndalet pa arsye gjatë kalimit të rrugës apo të binarëve hekurudhorë;

1.4. të lëvizë ose të qëndrojë në rrugë;

- 1.5. të vrapojë pa arsye;
- 1.6. të ecë përgjatë vijës hekurudhore;
- 1.7. të hyjë brenda vijës së hekurudhës kur mbrojtëset apo gjysmëmbrojtëset janë të lëshuara poshtë ose kur ulja e tyre, përkatësisht ngritja e tyre nuk ka përfunduar;
- 1.8. ta kalojë rrugën në vendin ku mekanizmat ose pengesat për siguri e ndajnë shtegun e këmbësorëve ose trotuarin nga rruga, pa marrë parasysh në cilën anë janë të vendosura ato;
- 1.9. të tërhiqet apo të mbahet për mjetesh me rollera, ski, saja e ngjashme.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 145

Sjellja e këmbësorëve në vendkalim

1. Në vendkalimin e shënuar për këmbësorë, përkatësisht në kryqëzimin në të cilin qarkullimi i këmbësorëve rregullohet me semaforë për këmbësorë, këmbësori është i detyruar të veprojë sipas atyre shenjave.
2. Në vendkalimin e shënuar për këmbësorë në të cilin qarkullimi i këmbësorëve rregullohet me semaforë për këmbësorë ose me shenja të personit të autorizuar, këmbësori mund ta kalojë rrugën vetëm kur me shenjën e dhënë i lejohet kalimi nëpër rrugë.
3. Në vendkalimin e shënuar për këmbësorë në të cilin qarkullimi i këmbësorëve nuk rregullohet me semaforë as me shenja të personit të autorizuar, këmbësori, edhe pse ka përparësi kalimi, duhet t'i kushtojë kujdes largësisë dhe shpejtësisë së mjetit i cili i afrohet.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 146

Kolona e organizuar e këmbësorëve

1. Kolona e organizuar e këmbësorëve duhet të udhëhiqet nga personi i moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
2. Kolonës së organizuar të këmbësorëve i lejohet të lëvizë vetëm në anën e djathtë të rrugës në kah të lëvizjes.
3. Gjatësia e kolonës së organizuar të këmbësorëve nuk mund të jetë më e gjatë se pesëdhjetë (50) metra. Përfshirë nga kjo dispozitë bën vetëm në rastet e kortezhit funeral, në rastet kur kjo bëhet me leje të veçantë, apo për njësitë policore ose ushtarake;
4. Distanca ndërmjet kolonave të organizuara të këmbësorëve nuk mund të jetë më e vogël se njëqind (100) metra.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 147

Lëvizja në kolonë e këmbësorëve në kushte të dukshmërisë së vështirësuar

1. Gjatë kohës me dukshmëri të vështirësuar, si dhe në rastet ku ka të bëjë me siguri të trafikut rrugor, këmbësorët të cilët lëvizin në kolonë, duhet të lëvizin njëri pas tjetrit. Përrjashtim nga kjo dispozitë bën vetëm në raste të kortezhit funeral, në raste kur kjo bëhet me leje të veçantë, apo për njësitë policore ose ushtarake;

2. Nëse kolona e këmbësorëve ec nën kushte të dukshmërisë së vështirësuar:

2.1. personi i parë në kolonë duhet ta bartë një dritë të bardhë, ndërsa personi i fundit në kolonë një dritë të kuqe;

2.2. drita duhet të jetë e dukshme nga një distancë jo më e vogël se njëqind e pesëdhjetë (150) metra.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 148

Shtyrja e mjeteve me dy rrota

1. Këmbësori i cili e shtyn karrocën, biçikletën, mopedin a motoçikletën; personi i cili lëviz me ndihmën e karriges për persona me aftësi të kufizuar; personi i cili e shtyn apo e tërheq karrocën e dorës; - të gjithë këta presona duhet të lëvizin pranë skajit të djathtë të rrugës në kah të lëvizjes.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 149

Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve

1. Gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësorë, shoferi i mjetit duhet të ketë kujdes të shtuar dhe t'i japë përparësi këmbësorit i cili është në vendkalim ose hyn në të.

2. Në qoftë se trafiku në vendkalimin e shënuar për këmbësorë është i rregulluar me semaforë ose me shenja të personit të autorizuar, shoferi i mjetit është i detyruar ta ndalë mjetin e vet para vendkalimit të shënuar për këmbësorë kur me shenjën e dhënë i ndalohet kalimi.

3. Nëse vendkalimi i shënuar për këmbësorë nga paragrafi 2. i këtij neni gjendet në hyrje të rrugës, shoferi i cili lëviz në atë rrugë është i detyruar të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe t'i lëshojë të kalojnë këmbësorët të cilët gjenden ose hyjnë në vendkalim dhe, sipas nevojës, ta ndalë mjetin e vet për t'i lëshuar këmbësorët.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili

vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni. Atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, si dhe tri (3) pikë negative.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. ose 3. të këtij neni.

Neni 150

Detyrimet e shoferit të mjetit gjatë kalimit të trotuarit apo shtegut

1. Gjatë kalimit nëpër trotuar apo nëpër shteg të këmbësorëve, shoferi i mjetit duhet të drejtojë ngadalë dhe t'iu japë përparësi këmbësorëve.

2. Rregulla në paragrafin 1. të këtij neni zbatohet gjithashtu edhe gjatë drejtimit në sheshe, ku për arsye se nuk ka rrugë të ndara dhe trotuare, lëvizja e mjeteve dhe e këmbësorëve bëhet në të njëjtën sipërfaqe.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 151

Kujdesi i shoferit ndaj pjesëmarrësve të veçantë

1. Në rastin kur rruga kalohet nga persona me aftësi të kufizuara, nga persona të moshuar ose nga fëmijë, shoferi detyrohet ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ua mundësojë atyre personave që ta kalojnë rrugën.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat këtij neni.

Neni 152

Detyrimet e shoferit gjatë kthimit në rrugë anësore

1. Shoferi i cili me mjet kthehet në rrugë anësore, në hyrje të së cilës nuk ekziston vendkalim i shënuar për këmbësorë, është i obliguar të kthehet me shpejtësi të zvogëluar dhe nuk i lejohet t'i rrezikojë këmbësorët të cilët tashmë kanë hyrë në rrugë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 153

Trafiku në vendkalim hekurudhor

1. Kur pjesëmarrësi në trafik i afrohet vendkalimit hekurudhor, respektivisht kur e kalon atë, duhet të ketë kujdes të shtuar.

2. Pjesëmarrësit në trafik janë të detyruar të ndalen para vendkalimit hekurudhor nëse pajiset për mbyllje të trafikut fillojnë të lëshohen ose janë të lëshuara, ose nëse shenjat ndriçuese a akustike paralajmërojnë fillimin e lëshimit të pajisjeve, përkatësisht paralajmërojnë se në

vendkalimin hekurudhor po vjen treni.

3. Para se të kalojë mbi binarë, shoferi i mjetit duhet të sigurohet që mjeti i cili lëviz nëpër binarë nuk është duke ardhur dhe të ndërmarrë masa të veçanta të nevojshme, veçanërisht nëse dukshmëria është e vështirësuar ose rrethanave të tjera në rrugë.

4. Para vendkalimit hekurudhor shoferi i mjetit duhet të drejtojë mjetin me kujdes dhe me shpejtësi të zvogëluar, ashtu që t'i mundësojë atij ta ndalë mjetin me kohë, në rastet kur mjeti i cili lëviz nëpër binarë është afruar, ose kur mbrojtëset ose gjysmëmbrojtëset, ose sinjalizimi me dritë të kuqe dhe zëri e ndalojnë hyrjen në vendkalimin hekurudhor.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, secili pjesëmarrës tjetër në trafik me përjashtim të shoferit, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 154

Detyrimet e shoferit gjatë kalimit në vendkalim hekurudhor

1. Në vendkalim hekurudhor pa mbrojtëse dhe gjysmëmbrojtëse dhe pa sinjale me të cilat paralajmërohet ardhja e trenit, shoferi i mjetit është i obliguar që para se të kalojë nëpër binar, paraprakisht të sigurohet se në vendkalimin hekurudhor nuk kalon ndonjë mjet.

2. Shoferit i ndalohet:

2.1. të kalojë anash mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve dhe të hyjë në vendkalim hekurudhor nën rrethanat kur ulja e mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve tashmë ka filluar ose ka përfunduar, ose kur ngritja e tyre nuk ka përfunduar;

2.2. të hyjë në vendkalim hekurudhor nëse janë të ndezura sinjalet, dritat ose pajisjet akustike me të cilat paralajmërohet ardhja e mjetit në binarë;

2.3. ta kalojë mjetin gjatë kohës që është duke e pritur hapjen e gjysmë barrierave ose barrierave;

2.4. të hyjë në vendkalim hekurudhor, nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme të lirë në anën tjetër të kalimit për vazhdim të lëvizjes.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe i shqiptohet një (1) pikë negative.

Neni 155

Detyrimet e shoferit në rast të bllokimit të mjetit në vendkalimin hekurudhor

1. Nëse ndodh që mjeti është bllokuar në vendkalim hekurudhor, shoferi është i detyruar që menjëherë ta largojë mjetin nga vendkalimi. Nëse kjo është e pamundshme, shoferi detyrohet

ta paralajmërojë për rrezikun personin që e drejton mjetin mbi binarë.

2. Shoferi i cili e drejton mjetin ose bashkësinë e mjeteve me gjatësi që tejkalon dhjetë (10) metra dhe që nuk mund të zhvillojë shpejtësi me të madhe se gjashtë (6) km/orë, para se të hyjë nëpër vendkalim hekurudhor duhet të sigurohet se në vendkalim nuk është duke ardhur mjete i cili lëviz nëpër binarë për aq kohë sa i nevojitet mjetit për kalim të sigurt, ose duhet të kërkojë ndihmë nga personi i cili e siguron atë vendkalim hekurudhor.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 156

Trafiku në autoudhë dhe motoudhë

1. Ndalohet lëvizja nëpër autoudhë e këmbësorëve, e bagëtisë, e mjeteve pa motorë, e traktorëve, e mopedëve dhe e makinave të punës.

2. Në autoudhë ndalohet edhe lëvizja e mjeteve me veprim motorik, e automjeteve të cilat për nga vetitë e konstruksionit nuk mund të lëvizin me shpejtësi prej së paku gjashtëdhjetë (60) km/h. Përjashtim nga kjo dispozitë bëjnë mjetet nën përcjelle, mjetet me përparësi kalimi, mjetet e FSK-së, mjetet e institucioneve të sigurisë, mjetet të cilat me leje speciale i tërheqin mjetet në defekt dhe mjetet e tjera me leje speciale.

3. Shoferi i automjetit, i cili për shkak të avarisë ose për shkaqe të tjera është i detyruar ta ndalë automjetin në autoudhë, duhet ta ndalë automjetin në shiritin e emergjencës dhe duhet t'i ndërmarrë masat në mënyrë që sa më parë ta largojë mjetin nga shiriti i trafikut.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 157

Kushte për lëvizje në autoudhë

1. Ndalohet hyrja në autoudhë e automjetit që është duke e tërhequr mjetin në defekt.

2. Në autoudhë automjetet duhet të lëvizin në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut i cili nuk është i zënë me automjete që lëvizin në kolonë.

3. Në autoudhë lejohet ndërrimi i shiritit të trafikut me qëllim të lëvizjes më të shpejtë vetëm duke kaluar me automjet në shiritin e majtë të trafikut.

4. Në autoudhë shoferit nuk i lejohet të kalojë me mjet prej një shiriti në një shirit tjetër me lëvizje zigzage, të tejkalojë në shiritin për ndalje emergjente, të drejtojë në distancë të vogël pas mjetit që lëviz para tij duke nxituar me automjet, t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit, ta përdorë borinë, ose të ndërmarrë çfarëdo veprimi tjetër me të cilin do t'i rrezikonte pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

5. Shoferit nuk i lejohet ta drejtojë automjetin në kahje të kundërt ose të ndaluar në autoudhë.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej së paku një (1) viti dhe i shqiptohen tri (3) pikë negative.

Neni 158

Drejtimi në autoudhë me shumë shirita të trafikut

1. Në autoudhë me tre (3) ose me tepër shirita të trafikut që shërben për lëvizje të automjeteve në një drejtim, shoferi i automjetit me masën me të madhe të lejuar se pesëmijë (5000) kg, ose të automjeteve me rimorkio me gjatësi mbi shtatë (7) metra mund të shfrytëzoj vetëm dy (2) shirita të trafikut që ndodhën pranë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës.

2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) euro, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 159

Hyrja në autoudhë

1. Shoferi i cili hyn me automjet në autoudhë duhet:

1.1. ta shfrytëzojë shiritin për nxitim, kur ai shirit ekziston, duke dhënë shenjë përkatëse me tregues të drejtimit dhe duke hyrë në rrjedhën e trafikut në atë mënyrë që të mos e rrezikojë trafikun e automjeteve që lëvizin nëpër autoudhë;

1.2. t'i japë përparësi kalimi automjetit tjetër i cili lëviz nëpër autoudhë, nëse nuk ekziston shirit i posaçëm për nxitim.

2. Shoferi i cili me mjet lëviz në autoudhë duhet t'ia lehtësojë hyrjen në autoudhë mjetit tjetër, duke e lënë të lirë shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut dhe duke lëvizur në shiritin majtas prej tij, nëse nuk pengohet lëvizja e mjeteve të tjera në autoudhë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 160

Dalja me automjet nga autoudha

1. Shoferi i cili del nga autoudha duhet ta marrë pozitën me automjet në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut dhe të kalojë në fillim të shiritit për ngadalësim, në qoftë se një shirit i tillë ekziston në autoudhë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 161**Bllokimi i trafikut në autoudhë**

1. Në rast të bllokimit të trafikut në autoudhë, automjetet duhet t'ua mundësojnë lëvizjen mjeteve me përparësi kalimi dhe nën përcjellje, duke u skajuar në të djathtë ose në të majtë të shiritit të trafikut për të krijuar hapësirë të lirë kalimi.
2. Ndalohet ndalja ose parkimi i automjetit në autoudhë, përveç në ato vende ku është e shënuar për këtë qëllim.
3. Nëse ndalja e automjetit bëhet për shkak të një problemi teknik ose për arsye të tjera, shoferi duhet ta largojë automjetin nga rruga dhe t'i paralajmërojë pjesëmarrësit e tjerë në trafik.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 162**Dispozitat në motoudhë**

Të gjitha dispozitat dhe dënimet nga neni 156 deri në nenin 161 të këtij ligji vlejnë edhe për motoudhë.

Neni 163**Trafiku në tunel**

1. Shoferit që me mjet lëviz nëpër tunel nuk i lejohej ta ndalë ose ta parkojë mjetin, të bëjë kthim gjysmërrethor ose të lëvizë prapa.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe të njëjtit i shqiptohet një (1) pikë negative.

Neni 164**Përdorimi i dritave gjatë ngasjes në tunel**

1. Shoferi i mjetit me veprim motorik gjatë drejtimit nëpër tunel duhet t'i ketë të ndezura dritat e shkurta për ndriçim të rrugës.
2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej dyzetë (40) euro, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 165**Automjetet nën përcjellje**

1. Automjetet nën përcjellje, duke pasur kujdes për sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në trafik, e kanë të drejtën e përparësisë së kalimit kundrejt të gjitha mjeteve të tjera, përveç në kryqëzim ku trafiku rregullohet nga personi i autorizuar.
2. Personi i autorizuar që e rregullon trafikun rrugor është i detyruar të krijojë kushte në mënyrë

që mjetet me përparësi kalimi të kalojnë pa pengesa.

3. Automjeti nën përcjellje ka të drejtë të mos i zbatojë dispozitat e trafikut, kur ai mjet jep sinjale me dritë të kuqe dhe të kaltër dhe sinjale zëri me intensitet të ndryshueshëm, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

Neni 166

Sjellja e shoferit ndaj mjeteve në përcjellje

1. Shoferi i mjetit i cili e has në rrugë mjetin ose kolonën e mjeteve nën përcjelle, si dhe shoferi të cilin e arrin mjeti nën përcjelle ose kolona e mjeteve nën përcjelle, është i detyruar ta ndalë mjetin e vet, që natën në vend të dritave të gjata t'i përdorë dritat e shkurtra për ndriçim të rrugës, që t'iu përmbahet në mënyrë të përpiktë urdhrave që ia japin personat që i përcjellin mjetet dhe ta vazhdojë lëvizjen vetëm pasi të kalojnë të gjitha mjetet nën përcjelle.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 167

Sjellja e këmbësorit ndaj mjeteve në përcjellje

1. Për ta bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve nën përcjelle, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga përderisa të mos kalojnë këto mjete.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 168

Mjetet me përparësi kalimi

1. Mjete me përparësi kalimi konsiderohen:

1.1. mjeti i Policisë;

1.2. mjeti i zjarrfikësve;

1.3. mjeti i emergjencës \ ambulancës;

1.4. mjeti i FSK-së;

1.5. mjeti në pronësi të institucioneve publike, i autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë;

1.6. mjetet e njesisë së veçantë për transportin e personave të burgosur.

2. Mjete me përparësi kalimi në trafik janë të gjitha mjetet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni, kur me pajime të veçanta japin sinjale me dritë të kaltër dhe me zë me intensitet të ndryshueshëm gjatë intervenimit.

3. Mjetet me përparësi kalimi kanë të drejtë përparësie për kalim kundrejt të gjitha mjeteve të tjera, përveç ndaj mjeteve nën përcjelle dhe ndaj mjeteve që lëvizin nëpër kryqëzim i cili rregullohet me shenja të personit të autorizuar.

4. Personi i autorizuar që e rregullon trafikun rrugor është i detyruar që të krijojë kushte në mënyrë që mjetet me përparësi kalimi të kalojnë pa pengim.

5. Mjetet me përparësi kalimi kanë të drejtë të mos i zbatojnë dispozitat e trafikut, kur ato mjete japin sinjale me dritë të kaltër dhe sinjale zëri me intensitet të ndryshueshëm, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesëmarrësit e tjerë në trafik.

Neni 169

Detyrimet e shoferit ndaj mjeteve me përparësi kalimi

1. Kur mjete i Policisë ose i FSK-së duke i përdorur dy drita të kaltra ia siguron kalimin një mjeti ose kolonës së mjeteve që lëvizin pas tij, shoferët e mjeteve të tjera janë të detyruar t'iu kushtojnë kujdes edhe mjeteve të cilave u sigurohet kalimi, t'iu japin atyre përparësi kalimi dhe, në rast nevojë, t'i ndalin mjetet e veta përderisa të mos kalojnë këto mjete.

2. Kur mjetet me përparësi kalimi takohen në mes veti, mes tyre vlejnë dispozitat e përgjithshme të përparësisë së kalimit.

Neni 170

Sjellja e shoferit ndaj mjeteve me përparësi kalimi

1. Kur shoferi i mjetit takon në rrugë ose arrihet nga mjeti me përparësi kalimi, ai duhet ta lëshojë rrugën e, sipas nevojës, të ndalet derisa të kalojë mjeti me përparësi kalimi dhe të veprojë sipas urdhrat të personit të autorizuar nga mjeti me përparësi kalimi.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk vepron në pajtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 171

Sjellja e këmbësorëve ndaj mjeteve me përparësi kalimi

1. Për ta bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve me përparësi kalimi, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga derisa të kalojnë këto mjete.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 172

Përdorimi i pajisjeve të veçanta të zërit dhe dritës

1. Pajisjet për dhënie të sinjalizimit të posaçëm me drita dhe me zë me intensitet të ndryshueshëm kanë të drejtë t'i përdorin vetëm mjetet e parapara me nenet 165 dhe 168 të këtij ligji.

2. Në mjetet e Policisë, përveç pajisjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të montohen edhe pajisje në të cilat shkruhen urdhrat dhe lajmërimet për shoferin i cili lëviz përpara ose prapa

mjetit të Policisë: “Ndalje e detyrueshme”, “Ndal, policia!”, “Zvogëlo shpejtësinë!”, “Aksident trafiku”, “Rrezik në rrugë” apo të ngjashme.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) eurosh, personi i cili monton pajisje në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) euro deri në tremijë (3000) euro, zyrtari përgjegjës në institucionin publik nëse pa autorizim monton ose lejon montimin e pajisjeve në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, shoferi i cili merr pjesë në trafik me pajisje të montuara në kundërshtim me këtë nen. Atij i konfiskohet pajisja dhe nuk i rikthehet.

Neni 173

Vendosja e pajisjeve të zërit dhe dritave

Ministria përkatëse për Punë të Brendshme me akt nënligjor përcakton mënyrën e vendosjes së pajisjeve të zërit dhe të dritave në mjetet nën përcjelle dhe në mjetet me përparësi kalimi, të dritave të verdha në mjetet që parashihet vendosja e tyre, kriteret për dhënie të autorizimit sipas nënparagrafit 1.5. të paragrafit 1. të nenit 168 të këtij ligji dhe çështje të tjera lidhur me to.

Neni 174

Ngarkesa në mjet

1. Mjeti që ndodhet në trafikun rrugor ndalohet të ngarkohet më tepër se masa më e madhe e lejuar, e përcaktuar në certifikatën e regjistrimit të mjetit, ta tejkalojë ngarkesën boshtore të lejuar ose t'i tejkalojë mundësitë teknike të rrugës.

2. Ndryshe nga paragrafi 1. i këtij neni, lejohet tejkalimi prej 3% i masës së përgjithshme të lejuar dhe i ngarkesës boshtore të përcaktuar me dispozitë të veçantë, gjegjësisht përtej masës më të madhe të lejuar dhe ngarkesës së lejuar boshtore të përcaktuar në lejen e qarkullimit, gjegjësisht përtej mundësive të cilat lejon cilësia e rrugës së përcaktuar me shenjë të trafikut, me kusht që, për shkak të karakteristikave të ngarkesës dhe rrethanave të tjera të lejuara, në vendin e ngarkesës nuk ka qenë e mundshme të përcaktohet masa e ngarkesës.

3. Ngarkesa në mjet duhet të vendoset dhe, sipas nevojës të përforcohet e të mbulohet, në atë mënyrë që:

3.1. të mos e rrezikojë sigurinë e pjesëmarrësve në trafik;

3.2. të mos i dëmtojë rrugët dhe objektet në rrugë;

3.3. të mos e dobësojë stabilitetin e mjetit dhe të mos e vështirësojë drejtimin e mjetit;

3.4. të mos ia zvogëlojë shoferit të mjetit pamjen e rrugës;

3.5. të mos krijoj zhurmë të tepërt;

3.6. të mos derdhet a të mos shpërndalet nëpër rrugë;

3.7. të mos i mbulojë pajisjet dhe sinjalet ndriçuese në mjet;

3.8. të mos i mbulojë targat e regjistrimit dhe shenjat e tjera të përcaktuara të mjetit.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 175

Shënimi i ngarkesës në mjet

1. Ndalohet që ngarkesa në mjet të kalojë më tepër se një (1) metër në pjesën e përparme.

2. Ngarkesa që transportohet në mjet dhe në mjetin e bashkëngjitur mund ta kalojë pikën më të skajshme në pjesën e prapme të mjetit më së shumti sa 1/6 e gjatësisë së vet, e cila mbështetet në krejt hapësirën ngarkuese si ngarkesë e pandërprerë.

3. Në qoftë se me mjet transportohet ngarkesa në mjetin e bashkëngjitur që përbëhet nga mjeti tërheqës dhe nga rimorkio me një bosht, me gjatësi të mjetit kuptohet gjatësia e përgjithshme e mjetit tërheqës dhe e rimorkios me një bosht.

4. Në qoftë se ngarkesa në mjet kalon për më tepër se një (1) metër pikën më të skajshme në pjesën e pasme të mjetit, pika më e skajshme e ngarkesës duhet të shënohet me pëlhurë të kuqe.

5. Pika më e skajshme e ngarkesës që transportohet me mjet të transportit ose me rimorkio në rastin nga paragrafi 4. i këtij neni duhet të shënohet me tabelë. Kjo tabelë është në formë katrore me përmasa pesëdhjetë (50) cm x pesëdhjetë (50) cm, e ngjyrosur në mënyrë alternative me shirita të pjerrët me ngjyrë reflektuese portokalli dhe me ngjyrë të bardhë dhe e vendosur pingul mbi boshtin gjatësor të mjetit.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik apo institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni.

Neni 176

Shënimi i ngarkesës gjatë dukshmërisë së vështirësuar

1. Gjatë kohës së dukshmërisë së vështirësuar, pikat më të skajshme të ngarkesës që transportohen në mjet duhet të shënohen:

1.1. me dritë ose me materie me ngjyrë ose materie reflektuese në rastin e paragrafëve 4. dhe 5. të nenit 175 të këtij ligji;

1.2. me dritë apo me materie reflektuese të cilat nga ana e përparme japin dritë të bardhë, kurse nga ana e pasme dritë të kuqe, në rastin kur ngarkesa në mjetin rrugor ose në rimorkio kalon anash cepin e jashtëm të dritës së përparme ose të pasme për shënim të mjetit më tepër se njëzet (20) cm.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik apo institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 177

Masa e mjeteve të bashkangjitura

1. Masa e përgjithshme e rimorkios së tërhequr nga automjeti, mjeti për transport me masën më madhe të lejuar deri në 3.5 tonë apo autobusi, nuk lejohet që ta tejkalojë masën e përgjithshme të mjetit tërheqës.

2. Masa e përgjithshme e rimorkios së tërhequr nga mjeti i transportit me masën më të madhe të lejuar mbi 3.5 tonë mund ta tejkalojë masën e përgjithshme të mjetit tërheqës deri në dyzet (40) %.

3. Masa e përgjithshme e rimorkios së tërhequr nga motoçikleta apo mopedi nuk lejohet ta tejkalojë masën e përgjithshme për secilin prej këtyre mjeteve mbi njëqind (100) kg.

4. Kufizimet e parapara në paragrafët 1., 2. e 3. të këtij neni nuk zbatohen për kokë tërheqëse.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni.

Neni 178

Mjetet për të cilat nuk vlejné dispozitat për masën e mjetit të bashkëngjitur

Dispozitat nga neni 177 të këtij ligji nuk zbatohen për mjetet e FSK-së, të Policisë dhe të zjarrfikësve.

Neni 179**Transporti në mjetin e bashkëngjitur në biçikletë dhe në moped**

1. Në mjetin e bashkëngjitur të biçikletës e të mopedit nuk lejohet transporti i sendeve me të gjera se tetëdhjetë (80) cm.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 180**Transporti në mjetin me dy rrota**

1. Në biçikletë, në moped dhe në motoçikletë nuk lejohet transporti e sendeve me gjerësi më të madhe se 0,5 metra nga dy anët e mjetit.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 181**Leja e veçantë**

1. Lejohet lëvizja e mjeteve apo e bashkësive të mjeteve tek të cilat masa e përgjithshme, ngarkesa në boshte apo dimensionet me apo pa ngarkesë, janë më të mëdha sesa lejohen me dispozitat sipas nenit 177 të këtij ligji, me kusht që të merret leje e veçantë.
2. Leja nga paragrafi 1. i këtij neni lëshohet:
 - 2.1. në afat të pacaktuar;
 - 2.2. për një periudhë të caktuar kohore;
 - 2.3. vetëm për një udhëtim.
3. Lejet nga paragrafi 2. i këtij neni lëshohen nga Ministria apo komuna, në bashkëpunim me Policinë.
4. Ministria apo komuna, në bashkëpunim me Policinë, përkufizon kriteret dhe procedurat për lëshim të lejeve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni lidhur me mjetet dhe itineraret.
5. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme me akt nënligjor e rregullon mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të policisë për lëshim të lejeve dhe për angazhim për përcjellje.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni.

Neni 182
Transporti i personave

1. Në mjet lejohet të transportohen vetëm aq persona sa ka ulëse të montuara në mjet, përkatësisht sa janë të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit.
2. Dy (2) fëmijë nën moshën dhjetë (10) vjeçe konsiderohen si një person i rritur, në kuptim të paragrafit 1. të këtij neni.
3. Shoferit të mjetit nuk i lejohet që në ulëset e para ta bartë personin i cili është nën ndikim të alkoolit, të drogave apo të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 183
Transporti i personave në rimorkion anësore

1. Në mjetet e bashkëngjitura sipas dispozitës nga neni 179 të këtij ligji dhe në sëndukun e ngarkesës së mopedit e të motoçikletës nuk lejohet transporti i personave.
2. Në rimorkion anësore të biçikletës dhe të motoçikletës mund të transportohen persona.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili në mjet transporton persona në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 184
Transporti i personave në hapësirë të mbyllur të mjetit

1. Nuk lejohet transporti i personave në hapësirë të mbyllur të mjetit që nuk mund të hapet nga brenda. Përrjashtim bëjnë mjetet e institucioneve kompetente, të përcaktuara me akte normative.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1.500) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 185
Transporti i personave në biçikletë

1. Shoferi i biçikletës mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç mund të transportojë me biçikletë persona mbi shtatë (7) vjeç vetëm nëse në biçikletë gjinden ulëse të veçanta për çdo person

të pajisura me dorezë për mbajtje me duar, si dhe me mbajtëse të këmbëve, përkatësisht me pedale.

2. Shoferi i biçikletës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç mund të transportojë fëmijë deri në shtatë (7) vjeç vetëm nëse në biçikletë është e montuar ulësja e veçantë e cila i përgjigjet madhësisë së fëmijës dhe është e përforcuar për biçiklete.

3. Shoferit të biçikletës, të mopedit dhe të motoçikletës nuk u lejohet transporti i personave nën ndikim të alkoolit apo të drogave.

4. Fëmija më i ri se dymbëdhjetë (12) vjeç nuk lejohet të transportohet me moped dhe me motoçikletë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 186

Sjellja e udhëtarëve ndaj shoferit

1. Gjatë drejtimit të mjetit nuk lejohet pengimi i shoferit nga persona që gjenden në mjet, në atë mënyrë që do të rrezikohet siguria në trafik.

2. Nuk iu lejohet personave t'i hapin dyert e mjetit pa lejen e shoferit të mjetit.

3. Nëse derën e mjetit që transporton udhëtarë e hap personi i mitur, përgjegjësinë për këtë e mban shoferi, ndërsa nëse derën e mjetit e hap personi i moshës madhore, përgjegjësinë për këtë e mban vetë personi.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat të këtij neni.

Neni 187

Përdorimi i rripit të sigurisë

1. Në automjetin për udhëtarë dhe në mjetin transportues shoferi dhe të gjithë personat të cilët gjenden në mjet duhet t'i përdorin rripat e sigurisë, siç e parasheh prodhuesi i atij automjeti.

2. Nëse personi i mitur i cili transportohet në mjet nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia bie mbi shoferin e mjetit, ndërsa nëse personi i moshës madhore nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia për këtë e mban vetë personi.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili bart persona të mitur, respektivisht personi i moshës madhore, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 188**Ulësja e sigurisë për fëmijë**

1. Fëmijët nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeç dhe me lartësi nën njëqind e pesëdhjetë (150) cm të cilët transportohen në mjetet nga neni 187 i këtij ligji të cilat kanë të instaluar rripa të sigurisë, duhet të jenë të siguruar tërësisht apo pjesërisht me sistem të sigurt, d.m.th. me ulëse të sigurisë për fëmijë, të përshtatur për masën dhe lartësinë së fëmijëve.
2. Në mjetet nga paragrafi 1. i këtij neni të cilat nuk kanë të instaluar sistem të sigurisë, d.m.th. ulëse të sigurisë për fëmijë, nuk lejohet të transportohen fëmijë më të rinj se tre (3) vjeç.
3. Në mjetet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk lejohet të ulen në ulëset e para fëmijë nga tre (3) e më shumë vjeç dhe me lartësi nën njëqind e pesëdhjetë (150) cm.
4. Nëse fëmija është nën përkujdesë të personit të moshës madhore që nuk është i ulur në ulëset e përparme të mjetit, përkatësisht nëse mbahet në prehër apo në duar të këtij personi, lirohet nga detyrimi për ta përdorur ulësen e sigurisë për fëmijë.
5. Sistemi i sigurisë për lidhje të fëmijëve, d.m.th. ulësja e sigurisë për fëmijë, duhet të jetë në përputhje me direktivat e BE-së, të cilat transpozohen nga Ministria me akt nënligjor.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 189**Personat të cilët lirohen nga përdorimi i rripit të sigurisë**

1. Ndryshe nga dispozitat e neneve 187 dhe 188 të këtij ligji, detyrimi për ta përdorur rripin e sigurisë nuk zbatohet për këta persona:
 - 1.1. për personin që posedon certifikatë mjekësore me të cilën vërtetohet se i shfaqen efekte anësore negative po që se e përdor rripin e sigurisë;
 - 1.2. për gruan shtatzënë;
 - 1.3. për policin apo personelin tjetër të autorizuar gjatë transportimit të personave të arrestuar;
 - 1.4. për personat e autorizuar zyrtarë që ofrojnë mbrojtje të afërt të personave;
 - 1.5. për personelin e shërbimit mjekësor gjatë ndihmës së parë dhe gjatë aktiviteteve e detyrueshme;
 - 1.6. për personelin e sigurimit që është duke e bartur një shumë të konsiderueshme të parave të gatshme;
 - 1.7. për personin e sëmurë që bartet në lesë apo në ulëse të invalidëve.

2. Ministria përkatëse për Shëndetësi me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrën e lëshimit të certifikatës mjekësore nga nënparagrafi 1.1. i paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 190

Sjellja e udhëtarëve gjatë lëvizjes së mjetit

1. Gjatë kohës së lëvizjes së mjetit nuk lejohet që personat të kërcëjnë, t'i hapin dyert, të dalin me pjesë të trupit jashtë mjetit, të ulen në dritare apo të ngjashme, në pjesë të jashtme të mjetit ose në mjete të bashkëngjitura.

2. Policia duhet t'i identifikojë personat në fjalë dhe të ndërmarrë veprimet e duhura edhe pas përfundimit të këtyre rasteve.

3. Ndryshe nga paragrafi 1. i këtij neni, lejohet transporti i personave në pjesën e jashtme të mjetit të transportit dhe të rimorkios të cilët kryejnë punë me mjete speciale, si: shërbimet e zjarrfikësve, pastruesit e qyteteve apo të ngjashme, nëse në ato mjete është montuar platforma për të qëndruar në këmbë dhe për mbajtje. Në raste të tilla, mjetit nuk i lejohet të lëvizë me shpejtësi më të madhe se tridhjetë (30)km/h.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni. E njëjta gjobë i shqiptohet edhe shoferit të mjetit.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi që e tejkalon shpejtësinë e kufizuar të lëvizjes sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 191

Transporti i udhëtarëve me autobusë

1. Ndryshe nga dispozitat e neneve 182, 187 dhe 188 të këtij ligjit, në automjetet dhe në mjetin e bashkëngjitur për transport të udhëtarëve në transportin publik urban me autobusë, lejohet transporti i personave edhe duke qëndruar në këmbë. Në këtë rast, përdorimi i rripit të sigurisë nuk është i domosdoshëm.

2. Në autobusët me të cilët bëhet transporti publik në transportin ndërrurban, mund të transportohen vetëm aq persona sa ka edhe ulëse të montuara në autobus.

3. Rimorkiot për bartje të udhëtarëve mund t'iu bashkëngjiten vetëm autobusëve në transportin urban.

4. Autobusët që përveç ulëseve kanë vende për qëndrim në këmbë, janë të obliguar të jenë në përputhje me Ligjin për transportin rrugor.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, edhe personi juridik, institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni.

Neni 192

Sjellja e udhëtarëve në mjetin për transport të udhëtarëve

1. Nuk lejohet që udhëtarët të dalin nga mjeti për transport të udhëtarëve pa u ndalur mjeti.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, udhëtar i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 193

Transporti i personave në mjete transportuese dhe në rimorkio të traktorëve

1. Në mjete transportuese dhe në rimorkio të cilat i tërheq traktori mund të transportohen më së shumti pesë (5) persona të cilët punojnë në ngarkim-shkarkim të ngarkesës, si dhe kur kryhen punë bujqësore ose punë të tjera.
2. Personi i cili nuk i ka mbushur katërmëdhjetë (14) vjeç lejohet të transportohet në mjetet nga paragrafi 1. i këtij neni vetëm nëse përcillet nga personi i moshës madhore.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit, si dhe personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e të këtij neni.

Neni 194

Transporti i personave në hapësirën për vendosje të ngarkesës

1. Në mjetin transportues në hapësirën për vendosje të ngarkesës ose në mjetin e bashkangjitur të cilin e tërheq traktori, me leje të veçantë mund të transportohen më shumë se pesë (5) persona të cilët punojnë në ngarkim-shkarkim ose punë të tjera. Shoferi duhet ta ketë me vete lejen e veçantë dhe ta tregojë atë kur i kërkohet nga personi i autorizuar.
2. Lejet nga paragrafi 1 të këtij neni lëshohen nga Ministria apo Komuna, në bashkëpunim me policinë.
3. Ministria, në konsultim me Policinë, me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe kriteret për lëshim të lejes së veçantë për mjetet të cilat kryejnë transport të organizuar të personave.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 195

Transporti i kafshëve

1. Në qoftë se në kamion dhe në rimorkio transportohen kafshë, në ato mjete nuk lejohet transporti i personave.

2. Në qoftë se në automjet barten kafshë shtëpiake, nuk lejohet vendosja e tyre në ulësen e përparme.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 196

Sjellja në raste të jashtëzakonshme

Në rast të evakuimit ose të dhënies së ndihmës gjatë fatkeqësive elementare, në mjetin transportues ose në rimorkio që e tërheq traktori mund të kryhet transport i personave edhe pa leje paraprake.

Neni 197

Transporti i personave në makinat e punës dhe në motokultivatorë

1. Në makinën e punës dhe në mjetin e bashkëngjitur të cilin e tërheq makina, gjatë kohës së lëvizjes në rrugë, përveç shoferit lejohet të gjendet dhe përcjellësi.

2. Në motokultivator gjatë kohës së lëvizjes në rrugë lejohet të gjendet vetëm shoferi, ndërsa në mjetin e bashkëngjitur që e tërheq motokultivatori lejohet të transportohen më së shumti tre (3) persona të cilët punojnë në ngarkim-shkarkim ose kryejnë punë të tjera.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 198

Transporti i personave në hapësirën për vendosje të ngarkesës

1. Personave të cilët transportohen në hapësirën e kamionit për vendosje të ngarkesës dhe në mjetin e bashkëngjitur të cilën e tërheq traktori ose në makinën e punës, nuk iu lejohet të qëndrojnë në këmbë të ulen në anësorët e mjetit, mbi ngarkesë jostabile ose në ngarkesë e cila e kalon lartësinë e anësorës së mjetit.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. E njëjta gjobë i shqiptohet edhe shoferit të mjetit.

Neni 199

Ndalimi i transportit

1. Në trafikun rrugor ndalohet transporti i personave:

- 1.1. në mjetin i cili nuk ka anësore;
- 1.2. në mjetin me shkarkues automatik, nëse mekanizmi është i aktivizuar;
- 1.3. në mjetin e bashkëngjitur për transport të ngarkesës të cilën e tërheq mjeti transportues;
- 1.4. në kampshtëpizë;
- 1.5. në mjetin e bashkëngjitur të traktorit i cili tërheq më shumë mjete të bashkëngjitura, me përjashtim të të parit.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 200

Mjetet që kryejnë shërbime publike

1. Kur mjeti i cili kryen shërbime publike, si: mirëmbajtje të rrugëve, shërbime komunale, shërbime të furnizimit dhe shpërndarje të energjisë apo të ngjashme, gjatë kohës sa lëviz apo gjendet në rrugë publike duhet ta nderë dritën sinjalizuese me ngjyrë të verdhë.

2. Mjeti, konstruksioni a ngarkesa e cila i kalon kufijtë e lejuar gjatë pjesëmarrjes në trafikun rrugor, duhet ta përdorë dritën vezulluese ngjyrë të verdhë.

3. Shoferi i mjetit që kryen shërbime publike mund të mos i zbatojë dispozitat që kanë të bëjnë me lëvizjen e mjeteve, nëse me këtë veprim nuk rrezikohet trafiku, si: gjatë pastrimit të borës ose ndonjë arsye tjetër, ndërsa nëpër trotuar mund të lëvizë nëse nuk rrezikohen këmbësorët.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 201

Mjetet që kryejnë shërbime publike në autoudhë

1. Shoferi i mjetit që kryen shërbime publike, si: mirëmbajtje të rrugëve, shërbime të furnizimit dhe të shpërndarjes së energjisë apo të ngjashme, mund ta shfrytëzojë autoudhën edhe nëse mjeti nuk është automjet ose konstruksioni i tij nuk e bën të mundur që të zhvillojë shpejtësi mbi gjashtëdhjetë (60) km/h.

2. Ndalohet që shoferi i mjetit për mirëmbajtje të rrugëve t'i përdorë dritat vezulluese ngjyrë të

verdhë për qëllime të tjera përveç atyre të përshkruara në nenin 200 të këtij ligji.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) eurosh, shoferi i mjetit për mirëmbajtje të rrugëve i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 202

Detyrimet e personit i cili i mirëmban rrugët

1. Personi të cilit i është besuar mirëmbajtja e rrugëve detyrohet që t'i marrë të gjitha masat e duhura për t'i mënjanuar pengesat në rrugë, si: borën, shembjen e gurëve, kafshë të ngordhura, sende e të ngjashme. I njëjti duhet t'i respektojë urdhrat e personit të autorizuar, i cili mbikëqyr dhe rregullon trafikun rrugor.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) eurosh, personi nga paragrafi 1 i këtij neni i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi nga paragrafi 2. të këtij neni.

Neni 203

Dokumentet gjatë drejtimit të mjetit

1. Shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet t'i mbajë me vete dokumentet si vijon:

1.1. patentën e shoferit;

1.2. certifikatën e regjistrimit të automjetit;

1.3. autorizimin, nëse mjete shfrytëzohet për drejtim jashtë vendit. Autorizimi duhet të nxirret nga organi kompetent i autorizuar, nëse shoferi nuk është pronar i mjetit ose pronari i mjetit nuk është në mjet;

1.4. urdhëresën e punës ose autorizimin, të lëshuara nga institucionet publike apo private për drejtim të mjetit brenda vendit, nëse mjete përdoret si mjet komercial, si: mjetet publike dhe private të kompanive, të ndërmarrjeve, të firmave, taksitë, autoshkollat, autobusët, mjetet transportuese apo të ngjashme;

1.5. policën e sigurimit;

1.6. raportin evropian të aksidenteve;

1.7. dokumentet për kualifikim të shoferëve, siç parashihet me ligj;

- 1.8. certifikatën e vlefshme shëndetësore, kur me ligj parashikohet posedimi i saj.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, shoferi i mjetit i cili i posedon dokumentet valide të parapara me këtë nen, por nuk i ka me vete kur i kërkohet nga personi i autorizuar.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me rregullat e nënparagrafëve 1.3 ose 1.4 të paragrafit 1. të këtij neni.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk e posedon me vete raportin evropian të aksidenteve, siç parashihet në nënparagrafin 1.6 të paragrafit 1. të këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, institucioni i autorizuar i cili me rastin e sigurimit të mjetit, pronarin e mjetit nuk e pajis me raportin evropian të aksidenteve.

Neni 204

Vendosja e shenjave, dekorimeve, si dhe përkujdesja ndaj mjetit

1. Ndalohet:

- 1.1. të përdoret mjeti në atë mënyrë që të rrezikojë sigurinë e personave të cilët transportohen në mjet;
 - 1.2. t'i mbulojë dritat apo mekanizmat e tjerë sinjalizues, targat e regjistrimit dhe tabelat apo shenjat e tjera të cilat kërkohen që të jenë të dukshme;
 - 1.3. të vendosë dekorime shtesë në tabela apo në vend të caktuar për targa, përpara dhe prapa, të vendosë shenja, tekste apo objekte që do të mund ta kufizonin leximin e tyre;
 - 1.4. ta vendosë në mjet shenjen e një vendi të huaj;
 - 1.5. të vendosë folie ose ndonjë material tjetër me qëllim të errësimit të xhamave në mjet.
2. Ministria përkatëse për punë të brendshme me autorizim të veçantë lejon përdorimin e mjeteve me xhama të errët për mjete të caktuara zyrtare.
 3. Ndalohet vendosja dhe bartja në mjet e reklamave të cilat e zvogëlojnë sigurinë në trafik.
 4. Ndalohet bartja e reklamave pa leje paraprake dhe pa atest nga institucioni përkatës lidhur me këtë çështje.
 5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
 6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500)

euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi nga paragrafi 5. të këtij neni.

Neni 205

Vendosja e pjesëve shtesë në mjet

1. Ndalohet:

1.1. vendosja brenda dhe jashtë mjetit e çdo sendi i cili mund t'iu shkaktojë dëm personave që barten në mjet ose pjesëmarrësve të tjerë në trafik;

1.2. të shfrytëzohet në mjet çfarëdo pjese shtesë ose pjesë që nuk është në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse;

1.3. të vendosin në pjesën e përparme të mjetit shenja me drita ose materie me ngjyrë të kuqe, kurse në anën e prapme shenjë ose lëndë që japin drita me ngjyrë të bardhë;

1.4. dispozitat e nënparagrafit 1.3. të këtij paragrafi lidhur me dritat me ngjyrë të bardhë nuk kanë të bëjnë me dritën për ndriçim të rrugës gjatë lëvizjes mbrapa, me dritën e lëvizshme për vëzhgim, me dritën për ndriçim të targës dhe me targën e veshur me ngjyrë të bardhë reflektuese, si dhe me mjetet e Policisë, Ndihmës së shpejtë, zjarrfikëseve dhe FSK-së.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe kriteret për vendosje të pajisjeve shtesë në automjet dhe çështje të tjera lidhur me to.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 206

Detyrimet e shoferit

1. Shoferit i ndalohet:

1.1. të largohet nga mjete kur motori është i ndezur;

1.2. ta shfrytëzojë mjetin në atë mënyrë që të lëshojë tym të tepruar duke e ndotur ambientin apo që bën zhurmë më shumë sesa është e paraparë me rregulla;

1.3. ta lërë motorin të ndezur gjatë parkimit brenda zonës së banuar. Kjo rregull nuk zbatohet për mjetet për mirëmbajtje të rrugëve, për mjetet me përparësi kalimi dhe mjetet nën përcjellje, të përcaktuara me dispozitat e neneve 165 e 168 të këtij ligji;

1.4. ta tërheqë prapa mjetit personin në ski, në sajë, në roleta, në dërrasën për skijim apo në pajisje të ngjashme;

1.5. ta përdorë mjetin me goma me elemente të përhershme kundër rrëshqitjes;

1.6. t'i përdorë zinxhirët e borës kur asnjë pjesë e rrugës nuk është e mbuluar nga bora ose akulli;

1.7. ta hapë derën e mjetit gjatë drejtimit të mjetit.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 207

Pajisjet rezervë dhe shtesë të automjetit

1. Automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t'i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë: poçat rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin i sigurisë, pajisjen për tërheqjeje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. Të gjitha këto pajisje duhet të jenë të kompletuara dhe me afat të përdorimit.

2. Thellësia e pneumatikëve duhet t'i përmbushë kriteret e përcaktuara me akt përkatës nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

3. Mjetet e transportit të ngarkesës dhe të udhëtarëve me masën më të madhe të lejuar mbi pesëmijë (5000) kg, duhet të jenë të pajisura me tahograf ose me sistem të mbikëqyrjes, si dhe me pykën e sigurimit të moslëvizjes.

4. Koha e llogaritjes së drejtimit për mjetet nga paragrafi 3 i këtij neni fillon nga momenti i fillimit të drejtimit të mjetit.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 1. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 2. të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 3. ose 4. të këtij neni.

Neni 208

Testimi i mjetit rrugor

1. Me qëllim të testimit të mjeteve të reja ose të riparuar, mund të mos zbatohen disa nga dispozitat e sigurisë së trafikut në rrugë dhe për këtë testim duhet leje e veçantë.

2. Lejen e veçantë nga paragrafi 1. i këtij neni e lëshon Policia në territorin e të cilit kryhet testimi i mjetit rrugor.

3. Në lejen e veçantë përcaktohen masat e sigurisë të cilat duhet t'i ndërmarrë organizatori me shpenzime të vetat, si dhe shënohet emri i personit i cili gjendet në mjet gjatë kohës së testimit të mjetit rrugor.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në një mijë e pesëqind (1500) euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 209

Detyrat në rast aksidenti të trafikut

1. Personi i cili gjendet ose has në vendngjarje të aksidentit të trafikut në të cilin ka persona të lënduar, duke i pasur parasysh njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e veta, duhet t'iu japë ndihmë personave të lënduar në aksident dhe, sipas mundësisë, t'i bartë ata deri te institucioni më i afërm shëndetësor, si dhe t'i marrë të gjitha masat në mënyrë që të parandaloj rreziqe të reja, aq sa është kjo e mundur.

2. Personi nga paragrafi 1 i këtij neni e ka për detyrë që ta informojë menjëherë Policinë dhe institucionet shëndetësore.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 210

Sjella e pjesëmarrësit në aksident të trafikut

1. Shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi tjetër i përfshirë në aksident të trafikut në të cilin dikush e ka humbur jetën, ose është lënduar, ose është shkaktuar dëm i madh material, e ka për detyrë:

1.1. ta ndalë mjetin, nëse është me mjet, dhe të qëndrojë në vendin e aksidentit të trafikut. Përgjithësisht bëjnë rastet kur pjesëmarrësi në aksident iu ofron ndihmë personave të lënduar, ose në qoftë se vetë atij i nevojitet ndihma mjekësore, ose nëse është larguar për ta njoftuar policinë, me kusht që të kthehet në vendin e aksidentit sapo të jetë kjo e mundur;

1.2. të ndërmarrë gjithçka që është e mundur, në mënyrë që të mënjanohej rreziqe të reja, të mundësohet rrjedha normale e trafikut, të bëhen përpjekje që të mos ndërrohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese, me kushtin që ndërmarrja e atyre masave të mos e rrezikojë sigurinë e trafikut;

1.3. ta njoftojë Policinë për aksidentin e trafikut, dhe ta presë ardhjen e personave të autorizuar të cilët e bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit.

2. Personi i cili është njoftuar për aksidentin e trafikut në të cilin është lënduar ndonjë person, e ka për detyrë që t'i njoftojë menjëherë institucionet shëndetësore dhe Policinë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) euro, shoferi i cili është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në aksident dhe i cili largohet me mjet nga vendi i aksidentit. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej së paku një (1) viti, si dhe i shqiptohen pesë (5) pikë negative.

Neni 211**Aksidenti me dëme të vogla materiale**

1. Shoferët - pjesëmarrës në aksident të trafikut në të cilin është shkaktuar dëm i vogël material, janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë mjetet nga shiriti rrugor, që ta mundësojnë qarkullimin e papenguar të trafikut dhe ta plotësojnë e ta nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve.

2. Shoferët pjesëmarrës në aksident trafiku e plotësojnë dhe e nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve sipas dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni kur pajtohen për mënyrën se si ka ndodhur aksidenti.

3. Raporti evropian i aksidenteve nuk plotësohet dhe nuk nënshkruhet në rastin e aksidentit në të cilin ka persona të lënduar ose të vdekur.

4. Policia është e obliguar të dalë në vendin e aksidentit të trafikut në të cilin ka ndodhur dëm i vogël material, nëse atë e kërkon njëri nga pjesëmarrësit në trafik dhe atë kur:

4.1. njëri nga mjetet nuk ka targa të regjistrimit ose i njëjti nuk është i siguruar;

4.2. njëri nga mjetet ka targa të huaja të regjistrimit;

4.3. njëri nga shoferët është dukshëm nën ndikim të alkoolit, të drogës ose të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike;

4.4. njëri nga shoferët nuk posedon patentë shoferi;

4.5. shoferët nuk mund t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur aksidenti i trafikut;

4.6. njëri nga shoferët refuzon që t'i ofrojë të dhënat e veta personale, përkatësisht të dhënat për mjetin;

4.7. njëri nga shoferët e ka lëshuar vendin e aksidentit të trafikut; ose

4.8. në qoftë se shoferi merr pjesë i vetëm në aksident trafiku.

5. Në rast të aksidentit të trafikut me dëm të vogël material, kur në vendin e aksidentit nuk ndodhet pronari i mjetit ose pronari i një sendi tjetër të dëmtuar, shoferi e ka për detyrë që pronarit të mjetit ose të një sendi tjetër të dëmtuar t'ia lërë të dhënat për veten dhe për mjetin me të cilin e ka shkaktuar aksidentin e trafikut.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe i shqiptohet një (1) pikë negative.

Neni 212

Dëshmitarët e aksidentit

1. Shoferi dhe secili pjesëmarrës tjetër, i cili ka marrë pjesë në aksident të trafikut, në të cilin ka të vdekur ose të lënduar, ka të drejtë t'i kërkojë të dhënat personale dhe adresën nga personat e tjerë të cilët kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur aksidenti.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, personi i cili e kundërshton plotësimin e dispozitës së këtij neni.

Neni 213

Obligimet e shoferit ndaj të lënduarve në aksident

1. Shoferi i cili ka qenë ose has në vendin e aksidentit të trafikut, por i cili nuk është i përfshirë në aksident, e ka për detyrë që me kërkesë të personit të autorizuar ta dërgojë personin që është lënduar në aksident të trafikut deri në institucionin më të afërt shëndetësor.
2. Shoferi e ka për detyrë të veprojë sipas dispozitës së paragrafit 1. të këtij neni edhe para se të vijë personi i autorizuar, përveç në qoftë se ka ndodhur aksidenti në vendin në të cilin mund të pritet ardhja e shpejtë e mjetit të ndihmës së shpejtë, apo në qoftë se shoferi konstaton se me mënyrën joprofesionale dhe jopërkatese gjatë transportit gjendja e personit të lënduar mund të përkeqësohet.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 214

Obligimet e institucionit shëndetësor

1. Në qoftë se institucioni shëndetësor është njoftuar për aksidentin e trafikut apo ka pranuar të lënduar në aksident, e ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Policinë.
2. Në qoftë se personi i lënduar në aksident të trafikut vdes nga lëndimet e marra, institucioni shëndetësor e ka për detyrë që për këtë ta njoftojë Policinë.
3. Institucioni shëndetësor e transporton kufomën nga vendi i ngjarjes së aksidentit në morgun e institucionit shëndetësor.
4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, personi përgjegjës në institucionin shëndetësor i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri një mijë e pesëqind (1500) euro, institucioni shëndetësor i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 215

Largimi i sendeve nga vendi i aksidentit

1. Në qoftë se mjeti është paaftësuar për lëvizje të mëtejme në rrugë për shkak të aksidentit në trafik, shoferi apo pronari i mjetit e ka për detyrë që, pasi të urdhërohet nga personi i autorizuar,

ta mënjanojë nga rruga mjetin, ngarkesën, sendet ose ndonjë material tjetër të derdhur në rrugë.

2. Në qoftë se shoferi apo pronari i mjetit nuk është në gjendje të veprojë sipas paragrafit 1. të këtij neni, personi i autorizuar do ta urdhërojë kontraktuesin që mjetin, ngarkesën, sendet apo ndonjë material tjetër të derdhur, ta zhvendosë nga rruga në një vend të sigurt.

3. Kontraktuesi, e ka për detyrë që t'i ndërmarrë urgjentisht të gjitha masat e nevojshme për zhvendosjen dhe ruajtjen e mjeteve me ngarkesë, sendeve apo materialit tjetër të derdhur në rrugë dhe ta lirojë rrugën.

4. Në qoftë se kontraktuesi nuk vepron sipas dispozitës të paragrafit 3. të këtij neni, personi i autorizuar do t'i ndërmarrë të gjitha masat përkatëse për ta mundësuar rrjedhën normale të trafikut.

5. Shpenzimet e zhvendosjes e të ruajtjes së mjeteve, të ngarkesave, të sendeve ose të një materiali tjetër, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera përkatëse nga paragrafi 4. i këtij neni i mbulon kontraktuesi. Kontraktuesi ka të drejtë të kompensohet prej atij që e ka shkaktuar aksidentin.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 1. të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri një mijë e pesëqind (1500) euro, kontraktuesi i cili vepron në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 216

Shikimi dhe ekzaminimi në vendin e ngjarjes

1. Polici i cili e bën ekzaminimin e vendit të aksidentit të trafikut në të cilin ka persona të lënduar ose është shkaktuar dëm material, do t'i detyrojë pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në aksident që t'i nënshtrohen kontrollit me mjete dhe aparate përkatëse ose do të caktojë kontroll profesional me qëllim të kontrollimit të prezencës së alkoolit, drogës, apo të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike në udhëzimin e të cilave është e shënuar se ndalohet përdorimi i tyre para ose gjatë kohës së drejtimit të mjetit.

2. Nëse me kontrollin nga paragrafi 1 i këtij neni konstatohet se pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në aksidentin e trafikut janë nën ndikim të alkoolit, të drogës, apo të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike në udhëzimin e të cilave është e shënuar se ndalohet përdorimi i tyre para ose gjatë kohës së drejtimit të mjetit, polici i cili e bën ekzaminimin do të caktojë kontroll mjekësor, përkatësisht marrjen e gjakut dhe urinës për analiza.

3. Nëse në aksidentin e trafikut ka të vdekur, polici i cili e bën ekzaminimin në vendngjarjen e aksidentit, do të caktojë që shoferët - pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në aksident, t'i japin gjakun dhe urinën, në mënyrë që të konstatohet se a kanë në organizëm alkool, droga apo barna që ndikojnë në aftësitë psikofizike, kurse për pjesëmarrësit e tjerë në aksident pasi t'iu konstatohet prania në organizëm e alkoolit, drogës apo barnave të përmendura, me mjete apo aparate përkatëse.

4. Në rastet nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mjeku mund të vendosë që të mos u merren gjaku dhe urina nëse me atë mund të shkaktohen pasoja të dëmshme për shëndetin e pjesëmarrësve

në aksidentin e trafikut.

5. Personat nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, që nga momenti i shkaktimit të aksidentit të trafikut e deri kur të zbatohet ndaj tyre procedura e kontrollit nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nuk duhet të përdorin pije alkoolike, droga apo barna që ndikojnë në aftësitë psikofizike.

6. Personi për të cilin, me kontroll në njërën nga mënyrat e caktuara në këtë nen, është konstatuar se ka në organizëm alkool, droga apo barna që ndikojnë në aftësitë psikofizike, i mbulon shpenzimet e kontrollit, kurse personi nga paragrafi 1. i këtij neni, i mbulon edhe shpenzimet e dërgimit me mjet zyrtar policie në kontroll mjekësor dhe për dhënien e gjakut dhe urinës për analiza.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi në trafik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej së paku gjashtë (6) muajsh, si dhe i shqiptohen dy (2) pikë negative.

Neni 217

Detyrimet e policit në vendngjarjen e aksidentit

1. Policia e ka për detyrë të dalë në vendin e aksidentit të trafikut për të cilin është lajmëruar, si dhe në rastin kur gjatë patrullimit has në aksidentin e ndodhur.

2. Polici i cili e bën ekzaminimin në vendin e ngjarjes së aksidentit, e ka për detyrë ta bëjë regjistrimin e pasurisë që mbetet në vendin e ngjarjes, të personit të vdekur ose të lënduar rëndë në aksidentin e trafikut, ta njoftojë kontraktuesin që ta largojë mjetin dhe sendet nga rruga, si dhe të ofrojë ndihmë për ta mbrojtur pasurinë, në qoftë se në vendin e ngjarjes nuk është personi i cili mund ta rimarrë atë pasuri.

3. Pavarësisht prej dëmit të shkaktuar dhe prej shkallës së lëndimit, pas daljes në vendin e aksidentit për të cilin Policia është lajmëruar nga pala e përfshirë në aksident, Polici është i obliguar të bëjë raport mbi aksidentin.

4. Nëse me rastin e ekzaminimit të vendit të aksidentit me dëme të vogla materiale nuk ka nevojë për skicim dhe matje, mjafton fotografimi nga vendi i ngjarjes dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe shoferëve.

KAPITULLI VI MANIFESTIMET NË RRUGË

Neni 218

Manifestimet sportive dhe aktivitetet e tjera në rrugë

1. Për mbajtje të manifestimeve sportive dhe manifestimeve të tjera ose aktivitete të ngjashme në rrugë, organizatori duhet të marrë leje nga Komuna, përkatësisht nga Ministria.

2. Sigurinë për mbarëvajtje të aktiviteteve nga dispozita e paragrafit 1. të këtij neni e bën Policia apo ndonjë subjekt tjetër i autorizuar.

3. Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1. të këtij neni, nuk ka nevojë për leje nëse nuk pengohet rrjedha normale e trafikut.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i manifestimeve sportive dhe aktiviteteve të tjera në rrugë, nëse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 219

Ndalimi i përkohshëm i trafikut

Mbajtja e garave të automobilistëve, të motoçiklistëve apo të biçiklistëve në rrugë mund të lejohet edhe në rastet kur nuk ka rrugë të tjera alternative, por vetëm në kohën kur pjesëmarrësit e tjerë në trafik në atë rrugë lëvizin më së paku. Në këtë rast trafiku mund të ndalohet më së shumti dy (2) orë.

Neni 220

Kërkesa për dhënie të lejes

1. Kërkesa për dhënie të lejes paraqitet më së voni tridhjetë (30) ditë para se të mbahet manifestimi sportiv apo ndonjë aktivitetet tjetër.

2. Kërkesës për dhënie të lejes duhet bashkëngjitur programin e manifestimit, përkatësisht të aktiviteteve, dispozitat e garave, pasqyrën e masave që organizatori i parasheh për sigurinë e pjesëmarrësve në trafik dhe për sigurinë e pjesëmarrësve në manifestim, si dhe shenjat me të cilën shënohen personat dhe mjetet të cilat i përcjellin garuesit.

Neni 221

Refuzimi i kërkesës për mbajtje të manifestimit dhe aktivitetit në rrugë

1. Kërkesa për mbajtje të manifestimit sportiv a të ndonjë aktiviteti tjetër në rrugë do të refuzohet në qoftë se organizatori, sipas vlerësimit të organit kompetent, nuk është në gjendje t'i zbatojë masat që parashihen me këtë ligj.

2. Në qoftë se për shkak të mbajtjes së manifestimit sportiv a të një manifestimi tjetër ose të bërjes së aktiviteteve në rrugë do të duhej ndaluar trafiku në drejtimet më të rëndësishme, apo do të rrezikohet në masë të madhe ose do të pengohet trafiku rrugor, kërkesa për dhënie të lejes mund të refuzohet.

Neni 222

Detyrimet e organizatorit

1. Në lejen për mbajtje të manifestimit sportiv a të një manifestimi tjetër, ose për bërje të aktiviteteve në rrugë, duhet të përcaktohen masat e sigurimit që duhet t'i ndërmarrë organizatori.

2. Kur kufizohet apo ndalohet trafiku në rrugë për të mbajtur manifestim ose për të bërë aktivitet, leja përmban edhe obligimin e organizatorit që ta njoftojë opinionin përmes mjeteve të informimit publik për masat e kufizimit ose të ndalesës së trafikut, më së voni dyzet e tetë (48) orë para se të fillojë manifestimi, përkatësisht aktiviteti.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i manifestimit sportiv ose aktivitetit tjetër në rrugë, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 223

Rastet kur ndalohet manifestimi dhe aktiviteti në rrugë

1. Organizatori nuk duhet të fillojë të mbajë manifestimin sportiv a ndonjë aktivitet tjetër në rrugë, në qoftë se nuk janë ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë, të caktuara në leje.

2. Në qoftë se konstatohet që organizatori nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë, të caktuara në leje, manifestimi, përkatësisht aktiviteti do të ndalohet.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i manifestimit sportiv ose aktivitetit tjetër në rrugë, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 224

Ndërprerja e manifestimit apo aktivitetit në rrugë nga ana e organizatorit

1. Organizatori duhet ta ndërpresë mbajtjen e manifestimit sportiv apo të ndonjë aktiviteti tjetër në rrugë në rast se:

1.1. rrezikohen pjesëmarrësit në trafik ose pjesëmarrësit në aktivitet;

1.2. prishet në masë të madhe rendi dhe qetësia publike;

1.3. paraqiten rrethana për shkak të të cilave manifestimi, përkatësisht aktiviteti nuk do të lejohej;

1.4. nuk zbatohen masa të caktuara sigurie;

1.5. e kërkojnë arsye të tjera të sigurisë.

2. Në qoftë se organizatori nuk e ndërpret manifestimin, përkatësisht aktivitetin në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, Policia e urdhëron organizatorin që ta ndërpresë manifestimin, përkatësisht aktivitetin dhe i ndërmerr masat e nevojshme që urdhri të zbatohet.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i manifestimit sportiv ose aktivitetit tjetër në rrugë, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 225

Mjetet të cilat i përcjellin garuesit

1. Vetëm mjetet të cilat janë të shënuara me shenjë të veçantë, që e përcakton organizatori, mund të përcillen garuesit e aktivitetit sportiv në rrugë.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, shoferi i mjetit i cili e përcjell aktivitetin sportiv në rrugë pa e shënuar mjetin në pajtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i aktivitetit sportiv në rrugë nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 226

Detyrimet pas përfundimit të aktivitetit sportiv apo të manifestimit

1. Pas përfundimit të aktivitetit sportiv apo të një manifestimi tjetër në rrugë, organizatori ka për detyrë që menjëherë t'i ndërmarrë këto veprime:

1.1. t'i largojë nga rruga të gjitha shenjat e trafikut dhe shenjat e tjera, mekanizmat, sendet e objektet që janë vendosur për ta mbajtur manifestimin, përkatësisht për ta bërë aktivitetin;

1.2. t'i rivendosë në rrugë të gjitha shenjat e trafikut dhe shenjat e tjera, sendet dhe objektet që kanë qenë të larguara për ta mbajtur manifestimin, përkatësisht për ta bërë aktivitetin;

1.3. t'i rregullojë dhe t'i sjellë në gjendjen e mëparshme rrugën dhe objektet rrugore, në qoftë se janë dëmtuar gjatë mbajtjes së manifestimit, përkatësisht gjatë zhvillimit të aktivitetit.

2. Në qoftë se organizatori nuk vepron sipas paragrafit 1. të këtij neni, Policia do të ndërmarrë masa përkatëse që me shpenzime të organizatorit të kthehet rruga në gjendjen e mëparshme.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, organizatori i aktivitetit sportiv ose i manifestimit tjetër në rrugë, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI VII KUSHTET DIMËRORE

Neni 227 Sezoni dimëror

1. Gjatë sezonit dimëror, nga 15 nëntori deri më 15 mars, automjetet dhe bashkësitë e mjeteve që marrin pjesë në trafikun rrugor duhet t'i kenë pajisjet dimërore.

2. Gjatë kushteve dimërore ndalohet qarkullimi i automjeteve dhe i bashkësisë së mjeteve të cilat nuk i kanë të vendosura pajisjet dimërore.

3. Kushte dimërore nga paragrafi 2. i këtij neni janë kur rruga është e mbuluar me borë ose kur në rrugë ka akull.

4. Gjatë kushteve dimërore lejohet lëvizja e sajave dhe e të gjitha mjeteve të pajisura me rrëshqitëse. Sajat duhet t'i plotësojnë këto kushte:

4.1. të jenë të pajisura me sistem frenimi dhe të konstruara në atë mënyrë që mund të manovrohen lehtë;

4.2. gjatë kohës së dukshmërisë së zvogëluar duhet t'i kenë dy drita të bardha në pjesën e përparme të mjetit dhe dy drita të kuqe në pjesën e pasme të mjetit, si dhe një sinjal reflektues me ngjyrë portokalli në çdo anë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, edhe personi juridik apo institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 4. të këtij neni.

Neni 228

Ndalimi dhe kufizimi i trafikut

1. Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1. të nenit 227 të këtij ligji, Ministria apo Komuna, për kohë të caktuar dhe për rrugë të caktuara mund të urdhërojë që disa kategori ose lloje të mjeteve t'i kenë detyrimisht pajisjet dimërore edhe jashtë sezonit dimëror.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton pajisjet dimërore nga paragrafi 1. i nenit 227 të këtij ligji.

3. Ministria me akt nënligjor i përcakton rregullat dhe kushtet për lëvizjen e sajave dhe mjeteve të pajisura me rrëshqitëse, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

4. Ministria apo Komuna, në konsultim me Policinë, mund ta urdhërojë ndalimin ose kufizimin e të gjithave mjeteve ose disa llojeve të mjeteve, ta kufizojë shpejtësinë e lëvizjes për rrugë të caktuara ose për ditë të caktuara, nëse ndalimi ose kufizimi është i domosdoshëm për ta parandaluar ose për ta mënjanuar rrezikun për pjesëmarrësit në trafik, për të mundësuar zhvillim të papenguar të trafikut nëse trafiku është i dendur ose i vështirësuar, ose për ndonjë arsye tjetër.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 229

Rregullimi i trafikut në rrethana të veçanta

Në rastin kur kërkohet që siguria dhe rrjedha e trafikut të jenë në nivel ose në rrethana të veçanta, policia mund ta ndalojë trafikun ose të urdhërojë kufizim të veçantë të trafikut në rrugë të caktuar ose në pjesë të rrugës gjatë kohës derisa ekzistojnë rrethanat për shkak të të cilave janë ndërmarrë këto masa.

KAPITULLI VIII AMBIENTI

Neni 230 Mbrojtja e ambientit

1. Pjesëmarrësve në trafik nuk iu lejohej të marrin veprime që i shkaktojnë ose mund t'i shkaktojnë dëm ambientit.
2. Me mjet nuk lejohej që të shkaktohet zhurmë e panevojshme dhe jashtë normave të parapara.
3. Shoferi i mjetit me veprim motorik është i detyruar ta fikë motorin në këto raste:
 - 3.1. me kërkesë të personit të autorizuar;
 - 3.2. kur parashihet me rregulla të trafikut;
 - 3.3. kur mjeti me veprim motorik ndalet në tunel më shumë se një (1) minutë.
4. Pjesëmarrësve në trafik nuk iu lejohej të hedhin në rrugë ose pranë saj materie, mbeturina e të ngjashme, me të cilat rrezikohet jeta dhe shëndeti i njerëzve e i kafshëve, dëmtohen bimët ose ndotet ambienti.
5. Ministria apo Komuna, me qëllim të mbrojtjes së ambientit mund ta ndalojnë ose ta kufizojnë qarkullimin në rrugët që i kanë nën administrim të tyre, për lloje apo kategori caktuara të mjetit, apo për të gjitha mjetet.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, pjesëmarrësi në trafik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI IX SHOFERËT

Neni 231 Kushtet për drejtimin e mjetit

1. Mjetin me veprim motorik në trafikun rrugor mund ta drejtojë në mënyrë të pavarur vetëm personi i cili posedon patentë shoferi të vlefshme vendore ose të një vendi të huaj.
2. Shoferi ka të drejtë t'i drejtojë vetëm ato kategori të mjeteve të cilat i ka të shënuara në patentën e vet të shoferit.
3. Shoferi gjatë kohës së drejtimit të mjetit me veprim motorik duhet t'i shfrytëzojë mjetet ndihmëse të cilat i ka të shënuara në patentën e vet të shoferit.
4. Shoferit të mjetit me veprim motorik gjatë kohës së drejtimit nuk i lejohej përdorimi i telefonit të dorës – mobil, as i pajisjeve të tjera të cilat do ta zvogëlonin mundësinë e reagimit dhe drejtimit

të sigurt të mjetit. Këto pajisje mund të shfrytëzohen gjatë drejtimit të mjetit nëse përdorimi i tyre bëhet pa i mbajtur me dorë.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në një mijë e pesëqind (1500) euro, shoferi i cili e drejton mjetin me veprim motorik pa e pasur të drejtën për ta drejtuar mjetin: kur nuk ka patentë shoferi të vlefshme, ose kur e ka të ndaluar drejtimin e mjetit, ose kur nuk e ka patentë shoferin për kategorinë përkatëse. Përveç gjobës, atij i shqiptohen edhe tri (3) pikë negative.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 3., 4. ose 5. të këtij neni.

Neni 232

Kushtet psikofizike për drejtim të mjetit

1. Shoferi i cili e drejton mjetin në trafikun rrugor duhet të jetë i aftë në pikëpamje fizike dhe psikike për ta drejtuar mjetin dhe për këtë të ketë njohuri dhe shkathtësi të nevojshme.

2. Ndalohet ta drejtojë mjetin shoferi që është i lodhur, i sëmurë ose që ndodhet në gjendje të tillë psikike saqë është i paaftë për ta drejtuar mjetin në mënyrë të sigurt, si dhe shoferi që është nën ndikim të narkotikëve, barnave dhe substancave në udhëzimin e të cilave është e shënuar se ndalohet përdorimi i tyre para ose gjatë kohës së drejtimit të mjetit.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, si dhe dy (2) pikë negative.

Neni 233

Ndalimi i përdorimit të alkoolit

1. Shoferit të mjetit të kategorisë C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D ose DE, instruktorit të shoferëve, shoferit të ri dhe fillestar, si dhe shoferit të kategorisë B kur të drejtuarit e mjetit e ka profesion themelor, si: taksist, shofer i ndihmës së shpejtë, shofer në institucione shtetërore qendrore dhe lokale, në ndërmarrje apo të ngjashme, nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në trafikun rrugor nëse është nën ndikim të alkoolit.

2. Shoferit të mjeteve të kategorisë A1, A2, A, B, BE, T, L ose AM nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në trafikun rrugor nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi dhe instruktori i shoferëve sipas dispozitës së paragrafit 1. të këtij neni nëse në organizëm ka alkool deri në 0,50 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë. Përveç gjobës, atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe një (1) pikë negative.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) deri në katërqind e pesëdhjetë (450) euro, shoferi dhe instruktori i shoferëve i paraparë sipas dispozitave të këtij neni nëse në organizëm ka alkool mbi 0,50 deri në 1,00 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë. Përveç gjobës, atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim

i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj, si dhe dy (2) pikë negative.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, shoferi dhe instruktori i shoferëve i paraparë sipas dispozitave të këtij neni nëse në organizëm ka alkool mbi 1,00 deri 1,50 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë. Përveç gjobës, atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej nëntë (9) deri në tetëmbëdhjetë (18) muaj, si dhe dy (2) pikë negative.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) euro, shoferi dhe instruktori i shoferëve i paraparë sipas dispozitave të këtij neni nëse në organizëm ka alkool mbi 1,50 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë. Përveç gjobës, atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej një (1) deri në dy (2) vjet, si dhe tri (3) pikë negative.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, biçiklisti dhe drejtuesi i qerres nëse në organizëm ka alkool mbi 1,50 g/kg, respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë.

Neni 234

Konstatimi i pranisë së alkoolit dhe drogave në organizëm

1. Prania e alkoolit në gjak përcaktohet me analizat e gjakut dhe të urinës, me matjen e sasisë së alkoolit në litër, me kontroll mjekësor dhe me metoda e aparate të tjera.

2. Konsiderohet se shoferi ka në organizëm droga nëse prania e drogave vërtetohet me mjete ose pajisje gjegjëse, me kontroll mjekësor ose me analiza të gjakut ose të urinës.

Neni 235

Kufizimet për shoferin e ri dhe fillestar

1. Shoferit të ri dhe fillestar i ndalohet ta drejtojë mjetin në autoudhë me shpejtësi më të madhe se njëqind e dhjetë (110) km/h, në motoudhë me shpejtësi më të madhe se tetëdhjetë (80) km/h, në rrugët e tjera me shpejtësi më të madhe se shtatëdhjetë (70) km/h, mopedin me shpejtësi më të madhe se dyzet (40) km/h, si dhe ta drejtojë mjetin me të cilin kryhet transport i organizuar për fëmijë.

2. Shoferi i ri dhe fillestar obligohet që ta vendosë shenjën dalluese në automjet.

3. Ministria me akt nënligjor e përcakton formën dhe përmbajtjen e shenjës dalluese, si dhe mënyrën e vendosjes së saj në automjet.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej (200) deri në gjashtëqind (600) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni. Përveç gjobës, atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre (3) deri në gjashtë (6) muaj, si dhe tri (3) pikë negative.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 236**Kontrolli shëndetësor**

1. Shoferi duhet t'i nënshtrohet kontrollit shëndetësor. Kontrolli shëndetësor mund të jetë i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.
2. Kontrollit të rregullt shëndetësor shoferi duhet t'i nënshtrohet sipas rregullave që parashihen në Ligjin për patentë shoferi.

Neni 237**Kontrolli i jashtëzakonshëm shëndetësor**

1. Shoferi tek i cili dyshohet se për shkak të gjendjes shëndetësore nuk është më në gjendje ta drejtojë mjetin në mënyrë të sigurt dërgohet në kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor.
2. Në kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor dërgohet shoferi dhe instruktori i shoferëve tek i cili është konstatuar përmbajtja e alkoolit në organizëm më tepër se 1,50 g/kg, ose që është konstatuar përmbajtja e drogës ose e barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike në organizëm, si dhe shoferi dhe instruktori i shoferëve i cili refuzon t'i nënshtrohet ekzaminimit se a ka në organizëm alkool, droga ose barna që ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit.
3. Kërkesë për kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor të shoferit mund të parashtrijë Policia, inspektorati përkatës i transportit, prokuroria, gjykata dhe personi juridik apo fizik në kompaninë në të cilën është i punësuar shoferi.
4. Në rast të refuzimit për kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor, në kontroll shoferin e dërgon Policia.
5. Shpenzimet e kontrollit të jashtëzakonshëm shëndetësor i mbulon shoferi i cili dërgohet në kontroll, nëse konstatohet se ai nuk është i aftë ose i është kufizuar aftësia për ta drejtuar mjetin.
6. Nëse në kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor konstatohet se shoferi është i aftë për ta drejtuar mjetin me veprim motorik, shpenzimet e kontrollit i mbulon subjekti i cili ka parashtruar kërkesë për kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor.
7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i mjetit i cili nuk i është nënshtrohet ose refuzon t'i nënshtrohet kontrollit të jashtëzakonshëm shëndetësor.
8. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni.

Neni 238**Detyrimet e subjekteve shëndetësore**

1. Nëse në kontroll shëndetësor konstatohet se shoferi nuk është i aftë që në mënyrë të sigurt ta drejtojë mjetin për të cilin i është lëshuar patentë e shoferit, subjekti shëndetësor është i detyruar që t'i lëshojë atij certifikatë shëndetësore, si dhe ta lajmërojë Ministrinë për punë të brendshme dhe Policinë brenda tetë (8) ditësh prej ditës së kontrollit.

2. Nëse me kontroll shëndetësor konstatohet se instruktori i shoferëve nuk është i aftë nga pikëpamja psikofizike për ta drejtuar mjetin, atëherë subjekti shëndetësor është i detyruar t'ia lëshojë atij certifikatën shëndetësore dhe t'i lajmërojë brenda tetë (8) ditësh Ministrinë përkatëse për punë të brendshme, Policinë, si dhe Ministrinë.

3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) eurosh, personi i cili lëshon certifikatë shëndetësore në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 239

Ankesa kundër konstatimit të kontrollit shëndetësor

Shoferi ose instruktori i shoferëve i cili nuk pajtohet me konstatimin e kontrollit shëndetësor ka të drejtë ankese, siç parashihet me Ligjin për shëndetësi.

KAPITULLI X MJETET RRUGORE

Neni 240

Mjetet

Për pjesëmarrje në trafikun rrugor çdo mjet rrugor dhe çdo mjet i bashkëngjitur duhet t'i plotësojë kushtet dhe kriteret siç parashihen me ligj.

Neni 241

Autorizimi për mbikëqyrje të mjeteve rrugore

1. Policia, inspektorati i Ministrisë, inspektorati i komunës, si dhe dogana, sipas kompetencave që kanë, janë të autorizuar t'i ndalojnë apo t'i largojnë nga trafiku mjetet rrugore ose mjetet e bashkëngjitura në rastet kur ato i tejkalojnë dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkesën boshtore ose e rrezikojnë sigurinë në trafikun rrugor.

2. Lëshimi në trafik i mjetit i cili është larguar mund të bëhet vetëm pasi t'i lëshohet certifikata nga autoriteti kompetent, me të cilën dëshmohet gjendja e rregullt teknike.

3. Ngarkesa e mjetit të ndaluar mbetet nën përgjegjësinë e transportuesit që e përdor këtë mjet.

Neni 242

Gjendja e rregullt teknike e mjetit

Mjeti në trafikun rrugor duhet të jetë në gjendje të rregullt teknike dhe të mos e dëmtojë ambientin.

Neni 243**Kontrollimi mobil i rregullsisë teknike të mjetit**

Me qëllim të rritjes së sigurisë në trafikun rrugor dhe për mbrojtje të ambientit, kontrolli i rregullsisë teknike të mjetit mund të bëhet edhe në rrugë, përmes kontrollit teknik mobil.

Neni 244**Dënimet për shkak të parregullsisë teknike të mjetit**

1. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 243 të këtij ligji.

2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

KAPITULLI XI**MASAT E VEÇANTA PËR SIGURINË NË TRAFIKUN RRUGOR****Neni 245****Autorizimet e policit**

1. Personi i autorizuar zyrtar i Policisë së Kosovës (më tutje në tekst: polici) mund ta urdhërojë çdo pjesëmarrës në trafikun rrugor, i cili me sjelljen e vet pengon ose rrezikon trafikun, që t'i nënshtrohet kontrollit me anë të mjeteve dhe aparateve përkatëse për ta konstatuar praninë e alkoolit, të drogave apo të barnave të cilat ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit, pastaj sipas nevojës ta dërgojë atë në institucionin shëndetësor për dhënie të gjakut dhe urinës apo në kontroll shëndetësor.

2. Para se t'i ndërmarrë veprimet sipas paragrafit 1. të këtij neni, polici mund t'i detyrojë shoferin dhe pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor që t'i nënshtrohen procedurës me qëllim të identifikimit të simptomave që janë pasojë e pranisë së alkoolit, të drogave apo të barnave të cilat ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit.

3. Polici do ta dërgojë në institucion shëndetësor për të dhënë gjak dhe urinë, për analiza ose në kontroll shëndetësor edhe personin tek i cili rezultatet e ekzaminimit tregojnë se në organizëm ka drogë apo barna të cilat ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit, të konstatuara me mjete dhe aparate përkatëse.

4. Personat nga paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni e kanë për detyrë të veprojnë sipas kërkesave të policit.

5. Për veprimet e ndërmarra nga paragrafët 1. dhe 3. të këtij neni dhe nga neni 216 të këtij ligji, polici e përpilon procesverbalin dhe, sipas nevojës, kërkesën për kontroll mjekësor, për analiza të gjakut e të urinës.

6. Personi tek i cili konstatohet, përmes kontrollit me njërën nga mënyrat e përshtuara në dispozitat e paragrafëve 1. ose 3. të këtij neni, se në organizëm ka alkool, droga narkotike apo barna të cilat ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit, i mbulon vetë

shpenzimet e kontrollit shëndetësor, kurse personi nga paragrafi 3. i këtij neni i mbulon edhe shpenzimet e dërgimit me mjet zyrtar të policisë për kontroll mjekësor, përkatësisht për analiza të gjakut dhe të urinës.

7. Procedurën e të vepruarit të policit me qëllim të identifikimit të simptomave që janë pasojë e pranisë së alkoolit, të drogave apo të barnave të cilat ndikojnë në aftësitë psikofizike dhe në aftësitë e drejtimit të mjetit, sipas dispozitës nga paragrafi 2. i këtij neni, e përcakton me akt nënligjor Ministria përkatëse për punë të brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Ndaj shoferit që ka bërë kundërvajtje në trafikun rrugor, apo që është nën ndikim të drogës apo barnave ose është konstatuar sasia e palejueshme të alkoolit në gjak, me qëllim të parandalimit të drejtpërdrejtë të kryerjes së një vepre tjetër të kundërligjshme, polici mund të urdhërojë masa për vendosje në dhomë të veçantë deri sa të ndërpritet ndikimi i alkoolit, drogave apo barnave, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) orë. Gjatë kësaj kohe polici urdhëron që mjeti i tij të zhvendoset në vend të caktuar. Zhvendosjen e mjetit në vendin e caktuar sipas urdhrit të policit e bën kontraktuesi. Shpenzimet e zhvendosjes së mjetit sipas këtij paragrafi mbuloohen nga shoferi, përkatësisht nga pronari i mjetit.

9. Në qoftë se shoferi refuzon t'i nënshtrohet kontrollit ose ekzaminimit, përveç gjobës së paraparë me këtë nen, me automatizëm konsiderohet se shoferi ka qenë nën ndikim të alkoolit.

10. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej gjashtëdhjetë (60) eurosh, çdo pjesëmarrës tjetër në trafik përveç shoferit të mjetit me veprim motorik dhe instruktorit të shoferëve, i cili refuzon t'i nënshtrohet kontrollit ose ekzaminimit shëndetësor, përkatësisht dhënies së gjakut dhe urinës për analiza.

11. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i mjetit me veprim motorik dhe instruktori i shoferëve i cili refuzon t'i nënshtrohet verifikimit ose kontrollit me alkoolmatës ose ekzaminimit, gjegjësisht dhënies së gjakut dhe urinës. Përveç gjobës, atij i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej së paku gjashtë (6) muajsh, si dhe i shqiptohen tri (3) pikë negative.

Neni 246

Përcaktimi i shpejtësisë së lëvizjes së mjetit

1. Shpejtësia e lëvizjes së mjetit konstatohet me pajisje të matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjetit, me të dhëna në tahograf, duke përcjellë drejtpërdrejt mjetin me anë të videoincizimeve, me pajisje mobile dhe statike apo të ngjashme.

2. Fotografia dhe videoincizimi me të dhëna për shpejtësinë e konstatuar, të dhënat në tahograf dhe procesverbali për lexim nga radari pa përshkrim dhe pa shpejtësimatës, shërbejnë si provë e shpejtësisë së konstatuar të lëvizjes së mjetit.

3. Ndalohet të shfrytëzohen ose të instalohen pajisje në mjet të cilat i pengojnë ose i detektojnë pajisjet që shfrytëzojnë personat e autorizuar për mbikëqyrje dhe rregullim të trafikut rrugor. Nëse polici has në shoferin i cili i shfrytëzon ose i ka të instaluar në mjet këto pajisje, ai e urdhëron shoferin që t'i mënjanojë, e nëse shoferi refuzon ta bëjë këtë, pajisja do të hiqet me shpenzime të shoferit. Pajisja konfiskohet dhe e njëjta nuk i kthehet shoferit, përkatësisht pronarit të mjetit.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 247

Marrja e dokumentacionit për drejtim të mjetit

1. Polici do t'ia marrë patentën shoferit, përkatësisht licencën instruktorit të shoferëve, nëse gjatë kontrollit konstatohet se është bërë i paaftë fizikisht apo psikikisht për ta drejtuar mjetin, për kohën derisa zgjat kjo paaftësi.

2. Shoferit apo instruktorit të shoferëve, të cilit i kufizohet e drejta për kategori të caktuara më të larta të mjeteve për shkaqe të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, ato kategori do t'i anulohen në patentë shoferi. Me kërkesën e shoferit, atij do t'i lëshohet patentë shoferi pa kategoritë e anuluar.

3. Shoferit apo instruktorit të shoferëve do t'i merret patentë shoferi nëse nuk i nënshtrohet kontrollit shëndetësor në të cilin është dërguar. Patentat e shoferit nuk do t'i kthehet shoferit derisa ai të mos i nënshtrohet kontrollit shëndetësor.

4. Polici do t'ia marrë shoferit patentën e shoferit dhe instruktorit të shoferëve licencën nëse në kontroll të jashtëzakonshëm shëndetësor konstatohet se i janë kufizuar aftësitë. Me kërkesën e shoferit, atij do t'i lëshohet patentë shoferi i ri në bazë të kufizimeve të konstatuara.

5. Institucioni i autorizuar ia refuzon kandidatit për shofer lëshimin e patentës së shoferit, përkatësisht shoferit ia merr patentën e shoferit, ndërsa instruktorit të shoferëve ia merr licencën, nëse me kontroll shëndetësor konstatohet se është i paaftë për ta drejtuar mjetin, përkatësisht ta kryejë profesionin e instruktorit të shoferëve.

6. Kundër masave të shqiptuara sipas dispozitave të këtij neni, pala mund të parashtojë ankesë pranë gjykatës kompetente.

Neni 248

Pezullimi i dokumentacionit për drejtim të mjetit

1. Polici do t'ia marrë për kohësisht patentën e shoferit, përkatësisht licencën dhe do ta largojë nga trafiku shoferin apo instruktorin e shoferëve në rastin kur ai vepron në kundërshtim me:

1.1. nenin 231, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji;

1.2. nenin 231, paragrafi 3. të këtij ligji;

1.3. nenin 231, paragrafi 5. të këtij ligji;

1.4. nenin 232, paragrafi 2. të këtij ligji;

1.5. nenin 233 të këtij ligji;

1.6. nenin 237 të këtij ligji.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 1. të këtij neni, patentat e shoferit merret përkohësisht deri në ndërprerjen e shkaqeve për të cilat është marrë, e më së shumti deri në tetë (8) ditë.

3. Në qoftë se në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni shoferi nuk e merr patentën e shoferit pasi të ndërpriten shkaqet për të cilat i është marrë, e më së largu në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e marrjes së përkohshme, patentat e shoferit do t'i dërgohet organit i cili e ka lëshuar këtë dokument.

4. Më rastin e veprimit ndaj shoferit apo instruktorit të shoferëve, sipas paragrafit 1. të këtij neni, polici do t'ia bëjë të mundshme shoferit që në afat të përshtatshëm ta ftojë një shofer tjetër, i cili i përmbush kushtet për ta drejtuar mjetin në trafik, për ta marrë mjetin e larguar nga trafiku të cilin e ka drejtuar shoferi.

5. Po qe se shoferi nga paragrafi 4. i këtij neni tenton ose vazhdon ta drejtojë mjetin pas largimit nga trafiku rrugor dhe vazhdon të bëjë kundërvajtje për shkak të së cilës është larguar nga trafiku, polici do ta largojë shoferin përsëri nga trafiku dhe në pajtim me nenin 95 të këtij ligji do të japë urdhëresë për ta zhvendosur mjetin. Mjeti i zhvendosur mund të merret porsa të pushojnë shkaqet e zhvendosjes. Mjeti do të zhvendoset në hapësirën përkatëse të kontraktuesit, me shpenzime të shoferit.

6. Inspektori i njësisë mobile të veterinarisë mund ta përjashtojë mjetin i cili bart kafshë me qëllim të mbikëqyrjes së kushteve të veçanta sipas dispozitave të parapara.

Neni 249

Pasojat juridike të dënimeve

1. Pasojë juridike të vendimit të plotfuqishëm për shoferin e mjetit që ka shkaktuar kundërvajtje të caktuara sipas këtij ligji, në bazë të numrit të pikave të grumbulluara negative, është marrja e përkohshme e patentës së shoferit. Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj, as më shumë se dy (2) vjet.

2. Gjykata përkatëse mban evidencën e pikëve negative pas vendimit të plotfuqishëm ndaj shoferit i cili ka shkaktuar kundërvajtje në trafik sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Gjykata përkatëse e lajmëron ministrinë përkatëse për punë të brendshme, përkatësisht Policinë për vendimet nga paragrafi 2. i këtij neni.

4. Pika negative fshihet nga evidenca e shoferit pas kalimit të dy (2) vjetëve nga data kur me vendim të plotfuqishëm është shqiptuar ajo.

5. Shoferit të mjetit me veprim motorik të cilit i janë shqiptuar së paku nëntë (9) pikë negative për shkelje të parapara me këtë ligj, prej të cilave pesë (5) pikë negative i janë shqiptuar përnjëherësh, do t'i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik për të gjitha kategoritë në kohëzgjatje prej së paku dymbëdhjetë (12) muajsh.

6. Shoferit të mjetit me veprim motorik të cilit i janë shqiptuar së paku nëntë (9) pikë negative për shkelje të parapara me këtë ligj, prej të cilave tri (3) pikë negative i janë shqiptuar përnjëherësh, do t'i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik për të gjitha kategoritë në kohëzgjatje prej nëntë (9) muaj deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

7. Shoferit të mjetit me veprim motorik të cilit i janë shqiptuar së paku nëntë (9) pikë negative

për shkelje të parapara me këtë ligj, prej të cilave nuk i janë shqiptuar më shumë se dy (2) pikë negative përnjëherësh, do t'i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik për të gjitha kategoritë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) deri në nëntë (9) muaj.

8. Pasi që pikët negative për kundërvajtje janë marrë parasysh për marrjen e vendimit sipas paragrafëve 5., 6. dhe 7. të këtij neni, pikët negative fshihen nga evidenca e shoferit.

9. Nëse shoferi i mjetit, të cilit i është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik sipas paragrafëve 5., 6. dhe 7. të këtij neni në periudhën e ardhshme prej dy (2) vjetësh pas skadimit të afatit të ndalimit të masës mbrojtëse, i ka bërë nëntë (9) pikë negative të tjera, atij i shqiptohet masa e anulimit të patentës së shoferit për të gjitha kategoritë.

10. Pas kalimit të dy (2) vjetëve nga skadimi i ekzekutimit të masës mbrojtëse për anulim të patentës së shoferit, shoferi ka të drejtë t'i nënshtrohet përsëri provimit për patentë shoferi si kandidat fillestar, siç e parasheh Ligji për patentë shoferi.

11. Vendimi nga ky nen i dërgohet institucionit kompetent për lëshim të patentës së shoferit.

12. Kundër vendimit nga dispozitat e këtij neni, shoferi mund të ushtrojë ankesë në gjykatën kompetente.

Neni 250

Masa mbrojtëse për patentë shofer

1. Personit që e drejton mjetin me veprim motorik pa e fituar të drejtën për drejtim të mjetit ose pa patentë shoferi të kategorisë përkatëse, i merret e drejta që t'i nënshtrohet provimit për patentë shoferi për cilëndo kategori një (1) vit nga data e shqiptimit të vendimit të plotfuqishëm.

2. Shoferit të cilit i është marrë patenta e shoferit ose është që larguar nga trafiku rrugor sipas këtij ligji, ose ndaj të cilit është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, nuk i lejohet gjatë asaj kohe ta drejtojë mjetin në trafikun rrugor.

3. Nëse shoferi, ndaj të cilit është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, e drejton mjetin në trafikun rrugor gjatë periudhës së masës mbrojtëse, kjo masë i vazhdohet edhe për atë kohë sa ka qenë shqiptimi i masës së ndalimit.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në njëmijë e gjashtëqind (1.600) euro, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, edhe personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 251

Largimi i mjetit nga trafiku

1. Nëse Polici gjatë kontrollit has mjetin në rrugë me parregullsi teknike, ai do ta urdhërojë shoferin që menjëherë ta ndërpresë lëvizjen e mjetit dhe t'i mënjanojë parregullsitë ose ta dërgojë mjetin deri në vendin e caktuar ku mund t'i mënjanojë parregullsitë. Polici e ndërmerr këtë veprim për këto parregullsi teknike:

- 1.1. sistemi i çrregulluar i drejtimit;
- 1.2. sistemi i çrregulluar i frenimit;
- 1.3. mekanizmi i çrregulluar i lidhjes te bashkësia e mjeteve;
- 1.4. ngarkesa e vendosur në mënyrë të parregullt, përkatësisht sigurimi i pamjaftueshëm i saj;
- 1.5. transporti i jashtëzakonshëm pa leje të veçantë;
- 1.6. dritat për ndriçim të rrugës të çrregulluara;
- 1.7. dritat e pozicionit të çrregulluara;
- 1.8. sinjalizimi, stop dritat ose treguesit e drejtimit të çrregulluara;
- 1.9. mungesa e trekëndëshit të sigurisë;
- 1.10. mungesa e ndihmës së parë;
- 1.11. mungesa e aparatit për fikje të zjarrit e të ngjashme;
- 1.12. fshesat e dëmtuara dhe jofunksionale të xhamit të përparmë në kohën e drejtimit nëpër shi dhe të reshura bore;
- 1.13. gomat e vjetruara ose të dëmtuara;
- 1.14. xhamin e përparmë të dëmtuar;
- 1.15. pajisjet akustike të instaluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji;
- 1.16. janë bërë ndryshime në mjet pa iu nënshtruar atestit përkatës.

2. Në qoftë se polici has mjetin në rrugë në të cilën lëvizja e atij lloji mjetesh është e ndaluar, ose lëviz pa pajisje dimërore në pjesën e rrugës dhe në kohën kur pajisja dimërore është e detyrueshme, do ta urdhërojë shoferin që menjëherë të ndërpresë lëvizjen e mjetit ose të vazhdojë lëvizjen e mjetit në rrugë në të cilën lëvizja e atij lloji mjetesh lejohet, përkatësisht ta përdorë pajisjen dimërore.

3. Polici ka të drejtë të përdorë pajisje speciale për ndalim të mjetit rrugor.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 ose 1.5 të paragrafit 1. të këtij neni.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe

personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nënparagrafëve 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.14, 1.15 ose 1.16 të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 252

Kontrolli teknik i jashtëzakonshëm

1. Polici mund ta urdhërojë shoferin që ta dërgojë mjetin në kontroll teknik për t'i konstatuar parregullsitë ose, në bashkëpunim me organin kompetent që i kontrollon dhe menaxhon rrugët publike, të urdhërojë që të kryhet kontrolli i masës më të madhe të lejuar të ngarkesës boshtore dhe i dimensioneve të mjetit.

2. Në qoftë se në kontroll nga paragrafi 1. i këtij neni konstatohet se mjete nuk është në rregull teknikisht, ose e tejkalon masën më të madhe të lejuar, ose e tejkalon ngarkesën boshtore, ose kapacitetin e lejuar të mjetit, ose i tejkalon dimensionet e mjetit, - shpenzimet e kontrollimit i mbulon shoferi.

3. Nëse shoferi nuk vepron sipas urdhrit të paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni, polici e largon mjetin nga trafiku. Largimi i mjetit nga trafiku zgjat gjithnjë derisa të mos mënjanohen shkaqet për shkak të të cilave është larguar mjete.

4. Shoferi është i detyruar që mjetin e larguar ta mënjanojë menjëherë nga rruga në vendin në të cilin nuk e rrezikon sigurinë e trafikut ose nuk e pengon rrjedhën normale të trafikut, d.m.th. në vend të caktuar për parkim të mjeteve apo të ngjashme. Shoferi e ka për detyrë ta mënjanojë mjetin e larguar nga vendet e cekura më lart më së voni në afat prej dymbëdhjetë (12) orësh.

5. Në qoftë se shoferi vazhdon ta drejtojë mjetin pasi që mjete i tij është larguar nga trafiku rrugor, apo nuk e mënjanon mjetin siç parashihet me dispozitat e paragrafit 4. të këtij neni, polici do ta largojë përsëri mjetin nga trafiku, ose në pajtim me nenin 96 të këtij ligji do të japë urdhër për zhvendosjen e tij në vend tjetër.

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e tridhjetë (130) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni.

8. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind (100) deri në treqind (300) euro, shoferi, nëse në kontroll të jashtëzakonshëm teknik konstatohet parregullsia e mjetit.

9. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 8. të këtij neni.

Neni 253

Regjistrimi i mjetit

1. Polici do të largojë nga trafiku edhe mjetin që nuk është regjistruar apo që nuk ka targa të caktuara të regjistrimit ose që nuk i është nënshtruar në afat të caktuar kontrollit teknik të rregullt apo të jashtëzakonshëm, ose për të cilin mjet nuk është vazhduar vlefshmëria e certifikatës së regjistrimit të mjetit.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitën e këtij neni.
3. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, edhe personi juridik ose institucioni publik në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 254

Konfiskimi i targave

1. Polici do t'ia marrë përkohësisht targat e regjistrimit mjetit të cilin e ka larguar nga trafiku.
2. Polici i cili i ka marrë përkohësisht targat, e ka për detyrë t'ia kthejë ato shoferit kur të eliminohen shkaqet për shkak të të cilave janë marrë.
3. Në qoftë se shoferi në afat prej tridhjetë (30) ditësh nuk i mënjanon shkaqet për shkak të të cilave mjeti është larguar nga trafiku dhe nuk i merr targat, ato i dërgohen organit i cili i ka lëshuar.
4. Polici i cili i ka marrë përkohësisht targat, ose fletëzën e tahografit, ose certifikatën, ose dokumente të tjera të parapara me ligj, e ka për detyrë që shoferit t'i lëshojë vërtetim me të dhënat përkatëse.
5. Polici, në pamundësi të zhvendosjes së mjeteve të rënda, si: kamion, autobus apo të ngjashme, mund t'ia konfiskojë përkohësisht targat atij mjeti, deri në paraqitjen e shoferit apo të pronarit.
6. Ministria përkatëse për punë të brendshme, me qëllim të rritjes së sigurisë në trafikun rrugor, me akt nënligjor nxjerr vendim me anën e të cilit krijohet mekanizëm për inkasim të gjobave dhe çështje të tjera lidhur me to.

Neni 255

Masat e veçanta për kundërvajtje

1. Nëse është shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale, kryesi i kundërvajtjes nga ky ligj dënohet me gjobë të paraparë për atë kundërvajtje, duke e rritur shumë për njëqind (100) euro.
2. Nëse është shkaktuar aksident trafiku me persona të lënduar, kryesi i kundërvajtjes nga ky ligj dënohet me gjobë të paraparë për atë kundërvajtje, duke e rritur shumë për dyqind (200) euro.

3. Pagesa për kundërvajtje do të bëhet sipas ligjeve në fuqi që e rregullojnë këtë çështje.
4. Masa mbrojtëse e marrjes së përkohshme të patentës së shoferit sipas dispozitave të neneve 247 e 248 të këtij ligji do të vlejë deri sa të ndërpriten shkaqet për të cilat është shqiptuar ajo masë.
5. Masa e sigurisë për marrje të përkohshme të patentë shoferit shqiptohet në kohëzgjatje deri në tetë (8) ditë në rastet siç është paraparë me këtë ligj.
6. Kryesi i kundërvajtjes i cili e paguan gjobën në të holla brenda tetë (8) ditësh do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së paraparë për kundërvajtjen e shkaktuar.
7. Nëse kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 5. i këtij neni nuk e paguan gjobën në afatin prej tetë (8) ditësh, fillon procedurë përmbarimore apo kundërvajtëse pranë institucionit përkatës.
8. Nëse shoferi kryen me mjet dy (2) ose më shumë kundërvajtje përnjëherë, atij i shqiptohet vetëm dënimi i cili është i paraparë si dënim më i lartë në atë rast, duke ia përshkruar te gjitha veprimet e kryera.

Neni 256

Evidenca

1. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme e mban evidencën e shoferëve në databazën përkatëse për shqiptim të masës mbrojtëse, për pikët negative dhe për aksidentet e trafikut.
2. Të dhënat nga evidenca e paragrafit 1. të këtij neni mund t'i shfrytëzojnë gjykatat, prokuroritë, Ministria përkatëse për Punë të Brendshme dhe Ministria.
3. Qasjen në evidencën e të dhënave për aksidentet në trafik, për shoferët dhe për mjetet e përcakton Ministria përkatëse për Punë të Brendshme, me akt nënligjor.

Neni 257

Ekzekutimi i masës mbrojtëse

1. Kohëzgjatja e masës mbrojtëse për ndalim të të drejtuarit të mjetit me veprim motorik llogaritet nga data e shqiptimit të masës mbrojtëse në patentë shoferi, gjegjësisht në evidencën e lëshimit të patentë shoferit, në bazë të vendimit të plotfuqishëm të shqiptimit të asaj mase.
2. Koha e mbajtur në vuajtje të dënimit me burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës mbrojtëse nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me akt nënligjor i përcakton dispozitat për mënyrën e evidencës, për përcjelljen dhe evidencimin e të dhënave për kundërvajtje, për masat e sigurisë, për masat mbrojtëse, për pikët negative, për aksidentet e trafikut dhe për çështje të tjera lidhur me to.
4. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me akt nënligjor i rregullojnë procedurat e veprimit nga momenti i kërkesës për fillim të procedurës kundërvajtëse, deri te nxjerrja e vendimit të plotfuqishëm dhe çështje të tjera lidhur me to.

Neni 258

Masa mbrojtëse për patentë shoferi të huaj

1. Shoferi i cili posedon patentë shoferi të një vendi të huaj dhe i cili bën kundërvajtje në trafik, në vend të masës mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik mund t'i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i shfrytëzimit të patentë shoferit të huaj në territorin e Republikën e Kosovës në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh deri në dy (2) vjet.

2. Me qëllim që të sigurohet ekzekutimi i dënimit ose i masës mbrojtëse, gjegjësisht për shkak të sigurisë në procesin e kundërvajtjes, personi i autorizuar mund t'ia marrë shtetasit të huaj përkohësisht pasaportën, gjegjësisht ndonjë dokument tjetër, në kohëzgjatje deri në tri (3) ditë dhe të njëjtit i lëshohet dëshmi për marrjen e dokumentit të udhëtimit.

3. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme krijon databazën për evidencën e personit nga paragrafi 1. të këtij neni.

Neni 259

Gjobat me të holla

Polici i cili e rregullon dhe e mbikëqyr trafikun rrugor, në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes shqipton gjobë me të holla deri në gjashtëdhjetë (60) euro. Kundërvajtjet më gjobë të parapara mbi këtë shumë procedohen në gjykatën kompetente.

KAPITULLI XII

KËSHILLI PËR SIGURI NË TRAFIKUN RRUGOR

Neni 260

Themelimi i Këshillit për siguri në trafikun rrugor

1. Qeveria themelon Këshillin për siguri në trafikun rrugor, me propozim të Ministrisë.

2. Përbërja, funksionimi, mënyra e organizimit dhe financimi i Këshillit për siguri në trafikun rrugor rregullohet me akt të veçantë juridik i cili propozohet nga Ministria, ndërsa miratohet nga Qeveria.

KAPITULLI XIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 261

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat për kundërvajtje dhe masa mbrojtëse sipas këtij ligji nuk e paragjykojnë zbatimin e kodit penal.

2. Në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji zbatohet ligji në fuqi për kundërvajtjet, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Neni 262
Aktet nënligjore

1. Autoritetet kompetente për zbatim të këtij ligji janë përgjegjëse t'i nxjerrin aktet nënligjore brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ministria me akt nënligjor i transponon Direktivat evropiane që kanë të bëjnë me këtë ligj, nëse ato janë të zbatueshme në vendin tonë.

Neni 263
Dispozita shfuqizuese

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen këto nene: prej nenit 4 deri në nenin 228, neni 260, neni 261, neni 269, neni 282, neni 293, neni 294, neni 339, neni 340, neni 341, neni 342, neni 343, neni 344, neni 345, neni 347, neni 348, neni 349, neni 352, neni 353 dhe 355 të Ligjit Nr. 02/L-70 për siguri në komunikacionin rrugor.

Neni 264
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -088
5 gusht 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-034-2016, datë 23.08.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.

